



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 3 DHE 10 TETOR 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 3. i
10. OKTOBRA 2008. GODINE

TETOR –OKTOBAR
2008

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i mocionit për procedimin e ligjeve të pashpallura,
4. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendimin e Ligjit nr. 02/L-119 për Letërnjoftimin.
5. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendimin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit nr. 2003/9 për kooperativat e bujqve,
6. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me gjendjen në parkun nacional “ Malet e Sharrit” dhe në fshatin turistik në Prevallë,
7. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me gjendjen në pyjet e Kosovës.

D n e v n i r e d

1. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Razmatranje Mocije o procesiranju ne-proglašanih zakona,
4. Razmatranje Preporuke o amandamentiranju Zakona br.02/L-119 o ličnim kartama ,
5. Razmatranje Preporuke o amandamentiranju, izmene i dopune Zakona br.2003/9 o poljoprivredničkim zadrugama,
6. Razmatranje Preporuke Komisije za poljoprivredu, šumarstvo, ruralni razvoj, životnu sredinu i prostorno planiranje u vezi sa stanjem u Nacionalnom parku „Malet e Sharrit“ („Šar planine“), i turističkom naselju Prevala,
7. Razmatranje Preporuke Komisije za poljoprivredu, šumarstvo, ruralni razvoj, životnu sredinu i prostorno planiranje u vezi sa stanjem u šumama Kosova.

Agenda

1. Approval of the minutes from the previous session,
2. Time for Parliamentary questions,
3. Review of motion for preceding the non-promulgated laws,
4. Review of recommendation for amendment of the law nr. 02/L-119 on Identity-Card
5. Review of recommendation for amendment of change and supplementation of the Law nr. 2003/9 On Farmer's Cooperatives,
6. Review of recommendation made by Committee on Agriculture, Forestry, Rural Development, Environment and Spatial Planning on conditions of the national park “ Malet e Sharrit” and in tourist village Prevala,
7. Review of recommendation made by Committee on Agriculture, Forestry, Rural Development, Environment and Spatial Planning regarding the conditions in the forests of Kosovo.

Seanca plenare filloi punën në orën 10,00.
Seancën e drejtoi Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari Kryeministër, zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 96 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

A dëshiron ndokush fjalën? Fjalën e ka kërkuar Arsim Rexhepi. Urdhëro, deputet!

ARSIM REXHEPI: Zoti Kryetar,
Para tri-katër dite, në Televizionin e Kosovës, një anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovë është thirrur në emrin tuaj personal dhe të vetin, duke e autorizuar një qytetar sudanez për të bërë politikë lobiste për njohjen e pavarësisë së Kosovës.

Kjo vjen dy-tri ditë pas interpelancës që zoti Ibrahim Gashi, si anëtar i partisë që kishte kërkuar interpelancë me ministrin e Jashtëm, realizoi, do të thotë, një takim me një qytetar, për të cilin ne nuk dimë as kush është, as nga vjen, as çfarë funksioni ka? Vjen nga një shtet që bën gjenocid në një pjesë të madhe të popullsisë së pafajshme në Darfur dhe tenton t'i servohet botës dhe popullit shqiptar si lobist.

A di Qeveria për kanale të tilla dhe pse ju si Kryetar i Kuvendit keni lejuar që të ndodhë një akt i tillë?

KRYETARI: Ju faleminderit! Vazhdojmë me rendin e ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 19 dhe 25 shtator 2008

Ju njoftoj se procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 19 dhe 25 shtator 2008, si dhe transkriptet nga këto seanca u janë shpërndarë deputetëve.
Pyes deputetët, nëse kanë vërejtje në procesverbale?

Fjalën e ka deputeti, Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Ju faleminderit, zoti Kryetar. Unë mendoj që, së paku në kutinë time, nuk kanë ardhur të gjitha ato materiale që thatë. Unë e kam procesverbalin e datës 25 shtator, kurse transkriptin e datës 19 shtator. Do të ishte në rregull që t'i kemi

paralelisht transkriptin edhe procesverbalin e të njëjtës seancë, që të mund t'i krahasojmë këto dhe t'i japim vërejtjet tona. Kjo ishte një çështje. Një çështje tjetër që lidhet me seancën e datës 25 shtator, e kam fjalën për procesverbal dhe, ndoshta, po ta kishim transkriptin, do të kisha vërejtje.

Nga mikrofoni juaj, zoti Kryetar, është dëgjuar një fyerje e rëndë për disa deputetë të Parlamentit të Kosovës, i keni quajtur “idiota”. Kërkoj që kjo të përfshihet në procesverbal dhe transkript. Është çështje e Grupit tuaj Parlamentar- PDK-së a e hap apo jo këtë çështje, është çështje e etikës dhe e Kodit të mirësjelljes, por unë mendoj që një fyerje që i bëhet një deputeti të vetëm, është fyerje për të gjithë deputetët e Parlamentit të Kosovës. Kaq kisha. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fyerja nuk u është bërë deputetëve. Nëse deputetët e opozitës mendojnë se ka qenë e drejtuar ndaj tyre, unë kërkoj falje por, realisht, nuk u është drejtuar atyre. Unë e respektoj, ju e dini, votën edhe “për” edhe “kundër” të opozitës dhe mendoj që s'ka nevojë të ngrihet kjo, sepse nuk ka pasur të bëjë me deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Nëse deputetët mendojnë që u është drejtuar atyre, unë kërkoj falje, por nuk ka qenë e drejtuar, prandaj nuk e shoh të arsyeshme, e më së paku opozita mendoj që duhet të dyshojë në këtë drejtim. Ju faleminderit!

Ju e dini që ne nuk i votojmë transkriptet, i votojmë procesverbalet. Kush ka vërejtje në procesverbale? Nuk ka. Konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancës plenare të mbajtura më 19 dhe 25 shtator.

Unë, kisha për të shkuar me një votim formal në pikën e dytë të rendit të ditës. Ju e dini se disa deputetë kanë një varg pyetjesh që, vërtet, ta vendosim njëfarë rendi dhe njëfarë baraspeshe në mes deputetëve. Ne po shkojmë me nga një pyetje për çdo deputet dhe kështu po e formojmë njëfarë rendi, e jo sipas rendit që e kemi këtu, sepse nganjëherë shumë deputetë po mbesin pa bërë asnjë pyetje. Nëse jeni dakord, do të shkonim kështu me radhë- një deputet, një pyetje.

A jeni dakord?

Kush është “për”? Ju faleminderit shumë! Atëherë, vazhdojmë. Ju njoftoj se në bazë të Rregullës 26 pika 1 të Rregullores të Punës së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta.

Për shkak të numrit të madh të pyetjeve dhe të kohës së kufizuar, lus deputetët që ta respektojnë kohën.

Vazhdojmë me procedimin e pyetjeve.

Deputeti, Hydajet Hyseni, pyetje për ministren e Ministrisë së Energjisë dhe të Minierave, zonjën Justina Pula.

Deputet, Justina nuk është këtu. A doni ta lexoni pyetjen? Ju faleminderit!

Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, mund ta lexoni pyetjen!

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit!

Familjet në Kosovë çdo ditë e më shumë janë më të varfra. 15% të familjeve në Kosovë jetojnë në varfëri të thellë. Kosova është vendi më i varfër në rajon dhe Evropë dhe e fundit për nga zhvillimi ekonomik. Ky problem është shumë i rëndësishëm dhe duhet trajtuar. Prandaj, zoti Kryeministër, a ka hartuar Qeveria e Kosovës strategjinë kombëtare kundër varfërisë?

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Kosova si vend më i varfër dhe me numrin më të madh të të papunëve nuk është rezultat i këtij viti, vitit 2008, është rezultat i një të kaluarë të hidhur e të trashëguar, por ne që nga dita e parë e qeverisjes që e udhëheq unë, jemi të përkushtuar që të fillojmë me reformat më të rëndësishme që do t'i hapin perspektivë zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe uljes së papunësisë.

Natyrisht, është hapur një perspektivë shumë më e madhe tash, pasi që Kosova është shtet i pavarur sovran, demokratik, ka Kushtetutën e vet dhe institucionet e veta legjitime dhe legale që mund të udhëheqin dhe të marrin vendime për të ardhmen e vendit dhe të qytetarëve.

Jemi fokusuar menjëherë për të investuar në edukim, duke qenë të vetëdijshëm se investimi në edukim është investim në zhvillimin ekonomik, është investim në punësim, është investim në modernizim, është investim në Kosovën e evropianizuar.

Gjithashtu, kemi vazhduar edhe me projektet madhore në infrastrukturë dhe këto, sidomos, në infrastrukturën rrugore. Këto projekte tanimë qytetarët i mirëpresin dhe i vlerësojnë, siç i vlerëson edhe politika shtetërore e Republikës së Kosovës, në këtë drejtim do të vazhdohet edhe në të ardhmen.

Gjithashtu, kemi filluar me reformat në energjetikë, janë reforma shumë të rëndësishme, reforma që do të ndikojnë drejtpërdrejt që të fillojë së realizuari projekti madhor për Kosovën që do të ketë rrymë për gjithë vendin, për të gjithë qytetarët dhe që do të ndikojë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të Kosovës, para së gjithash për bizneset.

Të gjitha politikat, prioritetet dhe projektet e Qeverisë, në një mënyrë apo në një tjetër, kanë për qëllim zvogëlimin e varfërisë. Përpjekjet e Qeverisë për...

KRYETARI: Deputete, a keni pyetje shtesë?

GJYLNAZE SYLA: Kryeministër, është e qartë që Qeveria s' ka strategji. Pyetja ime është shumë e qartë: Çka keni bërë për skamnorët? Pyetja shtesë është: Sa për qind do të ulët varfëria për çdo vit, duke filluar nga ky vit?

Dhe, edhe një çështje, duhet të jeni të përgjegjshëm dhe të vini në Kuvend, të mos mungoni kur janë pyetjet parlamentare, siç ka ngjarë në seancat e kaluara. Ju faleminderit!

KRYETARI: Mund ta vazhdoni Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Gjylnaze, të kuptoj se ke dëshirë për të na parë më shpesh këtu dhe do të jem më shpesh kur është e nevojshme. Edhe unë kam dëshirë të shoh si deputete të rregullt qysh je, të vazhdosh që të jesh edhe më e rregullt, por para së gjithash i mirëpres pyetjet.

E para, Qeveria që e udhëheq unë, nuk vepron me logjikën e emergjencave, por me planin e reformave për zhvillimin ekonomik, që do t'i përfshijë të gjithë sektorët institucional shtetëror të Republikës sonë dhe që do të ndikojnë në jetën dhe mirëqenien e çdo qytetari të Kosovës. Pra, do të jesh e bindur se çdo qytetar i vendit do të ndihet krenar për të jetuar në Kosovë, shtet i pavarur dhe sovran.

KRYETARI: Ju faleminderit, Kryeministër!

Deputete, i ke harxhuar pyetjet.

Deputetja Synavere Rysha, pyetje për ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj. Deputete, bëje pyetjen!

Regjia, fjalën deputetes Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë dhe ju anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Pyetja ime i drejtohet ministrit të Arsimit, zotit Enver Hoxhaj.

Edhe një fillim viti me probleme në arsimin kosovar, zoti ministër, dhe atë me fajin e Ministrisë. Për tri javë rresht nuk filloi mësimi për nxënësit e shkollës së mesme, përkatësisht gjimnazit "Kuvendi i Arbrit" në Ferizaj dhe atë për arsye teknike, mungesës së inventarit shkollor, të bankave dhe të karrigeve të shkollës.

Keni trumbetuar me të madhe se po investoni në arsimin kosovar dhe keni shpenzuar buxhet të konsiderueshëm në arsimin kosovar. Si e shpjegoni këtë fakt, zoti ministër?

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën.

ENVER HOXHAI: I nderuari, zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryeministër,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që të them fillimisht që një pyetje e tillë është bërë para disa javësh, por edhe përgjigja ime do të jetë për situatën kur është bërë kjo pyetje, do të thotë se kjo situatë i referohet fillimit të shtatorit.

Dua t'ju informoj që shkolla e mesme "Kuvendi i Arbrit" në Ferizaj është e vërtetë që dy javët e para është ballafaquar me mungesë të inventarit, mirëpo procesi mësimor ka filluar i rregullt. Shkolla ka kërkuar që t'i ketë 430 banka, përderisa në këtë shkollë janë dorëzuar deri më tash 535 banka shkollore. Kjo shkollë ka kërkuar t'i ketë 870 karrige, ndërsa ne i kemi dorëzuar 1230 karrige. Janë kërkuar 28 tabela në klasë, ndërsa ne i kemi dërguar 35 tabela.

Shkolla, si e tillë, është ndër objektet më të rëndësishme jo vetëm për Ferizajn, por edhe për rrethinën e saj. Ka 2.400 nxënës dhe ne do të bëjmë përpjekje maksimale që me investimet tona, jo vetëm në përmirësimin e inventarit dhe të gjendjes së brendshme në shkollë, por gjatë vitit 2009, ku në Ferizaj gjatë këtij viti kemi edhe dy shkolla të reja në ndërtim edhe vërtet ta ulim mbajtjen e procesit mësimor në dy ndërrime që ka qenë

deri më tash, në mënyrë që Ferizaj dhe shkollat tjera në Republikën e Kosovës të mos ballafaqohen me problemin e mungesës së inventarit.

Unë ju falënderoj për pyetjen që e keni shtruar. Pyetja është shtruar me kohë dhe më herët, por kjo situatë, definitivisht, i takon një kohe që mund të jetë mesi i shtatorit, përderisa ne aktualisht jemi në tetor. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!
Deputete Ryshe, a ke pyetje shtesë?

SYNAVERE RYSHA: Zoti ministër, ju thatë se mësimi ka filluar me kohë, unë ju garantoj se mësimi ka filluar tri javë pas fillimit, pas kushteve normale që është dashur të fillohet, domethënë 21 ditë pune janë humbur aty. A keni menduar si do ta kompensoni apo cila është strategjia e juaj për ta kompensuar mësimin e humbur në atë shkollë?

KRYETARI: E keni fjalën, ministër.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Çështja e kompensimit të mësimin në shkollat e Kosovës është më tepër përgjegjësi e vet shkollës dhe e komunave, sesa e Ministrisë së Arsimit.

Më lejoni t'ju informoj se ne do të bëjmë përpjekje që gjatë vitit të ardhshëm në Kuvendin e Kosovës ta sjellim Ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm dhe si Qeveri e Kosovës jemi shumë të interesuar që ky ligj të përcillet me debate të mirëfillta që shkollat tona ta kenë autonominë shkollore, por është detyrë edhe e Kuvendit, është detyrë edhe e çdo shkolle të mendojë se çka nënkupton autonomia shkollore? Autonomia shkollore nënkupton që shpeshherë shkollat tona qofshin fillore, qofshin të mesme, duhet t'i bëjnë edhe plan-programet shtesë se si ta jetësojnë plan-programin.

Ka kaluar koha kur plan-programet thjeshtë janë formuluar në atë formë çfarë është paraparë në plan program, pastaj është zhvilluar edhe si proces mësimor 100%, kështu që Kuvendi Komunal, Drejtoria Komunale në Ferizaj do të jenë organet kompetente së bashku me drejtorin e shkollës sa i përket kompensimit të atyre orëve të cilat janë humbur.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!
Është pyetja e radhës. Deputeti Zafir Berisha, pyetje për ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, zoti Mahir Yagcilar.
Deputet Berisha, parashtroje pyetjen!

ZAFIR BERISHA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,

Në bazë të një takimi që kemi pasur ne deputetët e zonës së Prizrenit me këshilltarët e katër asambleve komunale të regjionit të Prizrenit, është një shqetësim i përbashkët i regjionit të Prizrenit rreth shtratit të lumit Drini i Bardhë. Realisht, edhe ministri vjen nga ajo zonë dhe ne jemi dëshmitarë të eksploatimit të zhavorrit në mënyrë të pakontrolluar, që shpesh rezulton edhe me humbje të jetëve të njerëzve. Faktikisht,

gjendja është tepër e rëndë dhe është moment i fundit për t'u ndërmarrë masa. Pyes ministrin: Çka është duke ndërmarrë, pasi është edhe drejtpërdrejt i njoftuar, pasi vjen nga ajo zonë? Pra, çka është duke ndërmarrë në këtë drejtim që të ndalet nxjerrja e zhavorrit në mënyrë të pakontrolluar, thjesht, edhe dëmtimi i madh që iu bëhet tokave të bukës në komunën e Prizrenit, të Rahovecit, por edhe të Klinës? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari Kryetar,

I nderuari Kryeministër,

Të nderuar deputetë dhe ministra,

Në pyetjen e deputetit Zafir Berisha lidhur me gjendjen e shtratit të lumit Drini i Bardhë, për shkak të eksploatimit të zhavorrit në mënyrë të pakontrolluar, desha t'ju informoj se Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit dhe të Ujërave, duke u bazuar në planet e punës dhe në zbatimin e legjislacionit kryen aktivitete të vazhdueshme të inspektimeve në tërë territorin e Kosovës, ku janë të theksuara aktivitetet e shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit dhe përpunimit të tij nga seperacionet.

Inspektimet e kryera kanë për qëllim ndalimin e shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit nga shtretërit dhe brigjet e lumenjve, si dhe nga brezi në gjerësi deri në 50 metra nga vija e bregut.

Shfrytëzuesit e rërës dhe zhavorrit, që në numër janë mbi 100 sish, sipas evidencës që ka Ministria, nga ky numër janë, apo rreth rrjedhës së lumit Drini i Bardhë, kurse shfrytëzuesit tjerë janë në pjesët tjera të Kosovës.

Degradimet në terren nga eksportuesit e rërës dhe të zhavorrit janë evidente, sidomos janë të theksuara në rrjedhjen e lumit Lumëbardh të Pejës, si dhe përgjatë rrjedhjes së lumit Drini i Bardhë, duke përfshirë komunat: Klinë, Gjakovë, Rahovec dhe Prizren, gjithashtu, më pak edhe një pjesë të komunës së Kamenicës.

Gjatë aktivitetit të zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, Inspektorati ka hasur në vështirësi në terren, duke u ballafaquar me ndërlidhjen e institucioneve tjera si Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve, të cilat kanë lëshuar leje pune dhe licencë për ushtrimin e eksploatimit të rërës dhe të zhavorrit.

E ritheksoj edhe një herë, Ministria e Mjedisit lëshon pëlqimet mjedisore, ndërsa Komisioni i Pavarur i Minierave dhe i Mineraleve lëshon licenca. Deri tash janë kryer 97 kontrollime. Ekziston urdhëresa për t'u pajisur me pëlqim mjedisor dhe leje ujore për 82 kompani ose operatorë ilegalë. Vendime në Gjykatë për ndërprerje të aktivitetit deri sot për pajisje me dokumentin valid për punë janë 23, ndalesa për punë ekziston për 4 operatorë, kështu që, gjithashtu, Komisioni i Pavarur për Minerale, sipas Rregullores së vet, brenda 60 ditësh automatikisht lëshon licencën në qoftë se nuk...

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputet, a ke pyetje shtesë? Urdhëro!

ZAFIR BERISHA: Unë, ndoshta do të kisha rekomanduar, pasi vij nga ajo zonë, megjithatë Ministri bëri konstatime të gjendjes. Gjendja me të vërtetë është kështu qysh është edhe pak më e keqe, mirëpo, realisht, 100 shfrytëzues, ne jemi dëshmitarë,

sidomos deputetët që vijnë nga zona e Prizrenit, çdo mëngjes me dhjetëra, qindra kamionë zhavorr dhe, natyrisht, njerëzit në mënyrë ilegale përfitojnë nga kjo dhe pushteti nuk merr kurrfarë përgjegjësie. A ekziston mundësia e kombinimit të Ministrisë ose të organeve qendrore me ato komunale me qëllim të futjes nën kontroll dhe, thjeshtë, si e parashihni ju si Ministri të merrni masa? Pra, me të vërtetë e tillë është gjendja, ndoshta deputetët nga ajo zonë e përjetojnë, por mendoj edhe si ministër nga Prizreni që më seriozisht të merreni dhe të merrni masa në këtë drejtim, përndryshe, për çdo verë kemi humbje edhe të jetëve të fëmijëve të asaj zone?

KRYETARI: Ministër, mund ta vazhdosh përgjigjen.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Po, sigurisht, ky problem kërkon një qasje më serioze nga organet, si: Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, komuna dhe SHPK-ja, sepse Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është e pamundur të arrijë në çdo kohë dhe në çdo vend, që në të gjitha komunat e Kosovës t'i pengojnë këta operatorë ilegalë në shfrytëzimin e ... në rrjedhjet e lumenjve dhe sipërfaqe të tokave të degraduara përreth tyre. Sigurisht, nevojitet një angazhim i të gjithëve, por gjithashtu, ndoshta, është koha edhe të mendohet edhe për plotësimin ose ndryshimin e ligjit nga kjo fushë, sepse shumë kompetenca, gjithashtu, i ka edhe Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Pyetja e radhës, deputeti Arsim Rexhepi, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputet Rexhepi, mund ta parashtroni pyetjen!

ARSIM REXHEPI: Pyetja ka një paralelitet krejtësisht të arsyeshëm me atë që deputetja Pantina e ka bërë para dy-tri javësh, por edhe kjo pyetje është bërë para një muaji.

I nderuar, zoti Kryeministër, që nga paslufta populli i Kosovës është dëshmitar i një procesi jo pak të kritikuar të privatizimit. Edhe ju vetë, sa keni qenë në opozitë, shpeshherë nuk keni kursyer të shpreheni mohueshëm nda rrjedhave dhe praktikave të procesit të privatizimit.

Ndërkohë, ky proces ka rezultuar të jetë i pasuksesshëm edhe në fazën e pas privatizimit. Ka shumë syresh nga firmat që jo vetëm që kanë ndërruar natyrën e origjinës së mëparshme, por të thuash se në asnjë rast e në asnjë pikë disa nuk i kanë përmbushur obligimet e kontratave, si për shembull "Llamkosit" në Vushtri, del se nuk i dihet as pronari i saj. Pyetja është, zoti Kryeministër,...

KRYETARI: Ju faleminderit!

Pyetjen e keni bërë me 22 shtator. Zoti Kryeministër, apo ministër, a keni përgjigje? Urdhëro, ministër Shala!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuari Kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar, Kryeministër, zëvendëskryeministër dhe ministra, Po thuaj se është dhënë përgjigja në këtë pyetje, më duket javën e kaluar. Ne jemi shumë të shqetësuar për çdo rast kur blerësit me rastin e Spinofit Special nuk i kanë përmbushur kushtet në bazë të të cilave kanë qenë të obliguar dhe kemi kërkuar nga AKP-ja tani që të bëjë dhe të veprojë konform ligjit.

Jam i informuar se Bordi i AKP-së ka marrë vendimin për, që i thonë Call Option, pra për marrjen e aksioneve mbrapa kësaj kompanie dhe faktikisht të drejtën e hedhjes në treg apo të formave të tjera të funksionalizimit të kësaj ndërmarrjeje.

Unë besoj se Bordi i Agjencionit të Privatizimit të Kosovës do të veprojë konform kërkesave tuaja edhe të Qeverisë së Kosovës, se për të gjithë ata që nuk i kanë realizuar obligimet konform kontratës që kanë, do të veprojë konform kompetencave dhe ligjit dhe obligimeve që dalin nga vetë kontrata.

Në rastin e Llamkosit, duhet të përsëris, në mbështetje të Qeverisë të Kosovës, Bordi i AKP-së ka marrë vendimin për marrjen e aksioneve prapa. Të gjitha investimet që janë bërë deri më tani do mbesin aty. Paratë të cilat, faktikisht me të cilat i ka blerë, do të shqyrtohen konform dënimeve dhe ngarkesave sipas kontratës.

Nëse më kujtohet saktë, unë e di që për çdo punëtor të papaguar, të papunësuar konform ofertës që ka bërë, çdo blerës është i obliguar të paguajë në vit 3600 euro për çdo mos pagesë dhe 20% dënime nga mos investimi i një vlerës së premtuar të investuar plus 12% kamatë në vlerën e saj. Kështu që, sipas të gjitha gjasave, të gjithë investimi dhe paraja që është bërë do të mbesin në Kosovë, ndërsa AKP-ja ka të drejtë ndaj autorizimit. Unë edhe një herë e thërras në emër të Qeverisë së Kosovës, Bordin e AKP-së që të marrë veprime të shpejta dhe konkrete. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputet Rexhepi, a ke pyetje shtesë? Jo. Ju faleminderit!

Pyetja e radhës, deputeti Driton Tali, pyetje për Kryeministrin Thaçi apo për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala.

Driton, mund ta bësh pyetjen!

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Do t'ia bëja Kryeministrit, se ministri u përgjigj në seancën e kaluar, na e dha edhe një sihariq që, me të vërtetë tash veç po dokumenton se është edhe "gjeni i organizimit të punës", sidoqoftë, po mendoj, edhe "gjeni i privatizimit", tashmë të gjithë e dimë.

Me muajin shkurt Qeveria pati marrë një aksion për t'i nivelizuar pagat në ndërmarrjet publike, kështu patët deklaruar publikisht, dhe patët deklaruar se nuk do të ketë më për menaxhmentin paga prej 2000 euro deri në 3000 euro, sidomos në KEK, por edhe në ndërmarrjet e tjera.

A është realizuar ky premtim, zoti Kryeministër, apo ka qenë edhe ajo një deklaratë e marketingut? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Ministër Shala, me Rregulloren, Kryeministri ka të drejtë t'ua delegojë pyetjen ministrave.

AHMET SHALA: Absolutisht!

Zoti Tali, është vërtet një nga pyetjet që është trajtuar shumë herë dhe mbase me të drejtë është shtruar dilema a duhet anëtarët e menaxhmentit të ndërmarrjeve publike të kenë rroga më të larta se sa funksionarët?

Unë herën e kaluar, në fakt, mbase, duke u bazuar në disa nga kodet e mirësjelljes që do të duhej t'i respektonim, nuk kam dhënë ndonjë shifër të saktë për nivelin e pagave të ndërmarrjeve publike. Jam konsultuar me juristë të ndryshëm dhe kam marrë lejen, praktikisht, që pa emra, por për shkak të transparencës që e kemi obligim, konsideroj, edhe ndaj popullatës, edhe ndaj jush, t'i japim disa nga pagat e trashëguara, nëse mund të them. Kemi dhënë sqarime se ku është synimi ynë.

Niveli menaxhues më i larti në Aeroportin e Prishtinës ka rrogë 2720 euro, në KEK ka 1900 euro, ndërsa në Postë ka 4000 euro. Këto janë paga të cilat i kemi trashëguar nga legjislacioni i kaluar.

Ne, si Qeveri, po i marrim të gjitha masat dhe deri më 15 dhjetor, do t'i zgjedhim anëtarët e rinj të bordeve konform konkursit, ashtu siç është ligji. Të njëjtin veprim jemi duke e marrë dhe, dje, Qeveria e Kosovës ka marrë vendimin për privatizimin e Distribucionit dhe të Furnizimit të KEK-ut. Konsideroj se kjo është zgjidhja më e mirë se sa të ndërhyjmë drejtpërdrejt, nuk jemi shtet etatist dhe nuk duhet ta menaxhojmë ndërmarrjen publike drejtpërdrejt.

Me Aeroportin, ju e dini që jemi duke ecur mjaft mirë në koncesion dhe të njëjtin veprim besoj që do ta bëjmë edhe në ndërmarrjet tjera publike. Kjo është zgjidhja strategjike, ndërsa deri më 15 dhjetor ne do t'i emërojmë anëtarë të Bordit konform ligjit, të cilët do ta kenë të drejtën, ndërsa ne si Qeveri i thërrasim dhe mbështesin çdo përpjekje për racionalizim, natyrisht, duke i përfshirë edhe rrogat e menaxhmentit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!
Deputet, ke pyetje shtesë?

DRITON TALI: Kryetar, unë isha shumë i qartë sa i përket deklaratës së dhënë nga Qeveria. Nuk po hy tash në debat. Me termin etatist, unë nuk di çka është duke kuptuar ministri, sidoqoftë, po e lë për një herë tjetër, e debatojmë atë edhe obligimet e Qeverisë ndaj pronës publike.

Unë isha shumë i qartë. E keni dhënë deklaratën, çka keni bërë deri tash? Kurrë nuk paskeni bërë! Mos jepni deklarata herëve të tjera për marketing, se tashmë ka kaluar muaji i mjalitit, duheni singërisht, atë që e thoni, ta realizoni, se edhe ka filluar t'u bie boja, siç thuhet.

Sidoqoftë, po tregoj edhe një gjë, pasi nuk e tha. Prej 15.000 të të punësuarve, në ndërmarrje publike marrin 100 milionë euro, gjersa 75.000 veta që punojnë në administratën e shtetit, buxhetit i kushtojnë 200 milionë euro. Tash bëje ti matematikën si të duash, të ardhurat mesatare në Aeroport i ke 833 euro për shkak se 500 punëtorë i kushtojnë Aeroportit 5 milionë euro, në PTK prej 2.400 punëtorëve, 28 milionë euro veç paga marrin, gjersa kostoja e stafit në PTK është 30.7 milionë, domethënë rroga mesatare në Postë është 972 euro, në KEK i ke 100 menaxherë që marrin rrogë prej 1.200 deri në 2.900...

KRYETARI: Ky ishte koment. Vazhdojmë me pyetje.
Ju njoftoj se kjo pikë e rendit të ditës ka të bëjë me pyetje dhe përgjigje dhe jo me komente.
Urdhëro ministër, nëse ke përgjigje shtesë!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar Tali, më duket se përgjigjen e more. Konsideroj se është bërë puna, tash në qoftë se ..., ta jap përgjigjen. Përgjigja më se saktë që Qeveria e Kosovës dhe Kryeministri e ka thënë, është se ne jemi duke e zgjidhur mënyrën në model, e jo një nga një, sepse do të humbshim. Ne do t'i zgjidhim të gjitha ato që i kemi premtuar konform strategjive që ne mendojmë që janë më të mira për popullin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Deputetja Nurishahe Hulaj, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi.

Deputete, mund ta bëni pyetjen!

Regjia, fjalën deputetes Nurishahe Hulaj.

NURISHAHE HULAJ: Ju faleminderit, Kryetar i Kuvendit!

Ju faleminderit Kabinet qeveritar!

Çështja: Iso standardet, Ligji për duhanin dhe blerja e tyre përmes Agjencionit për Standarde në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Përdorimi i duhanit është problem global i shëndetit publik. Neni 3, pika 1 e Ligjit për duhanin, thotë: “Ndalohet prodhimi dhe qarkullimi i cigareve të cilat përmbajnë më shumë se 10 miligram katran për një cigare, më shumë se 1 miligram nikotinë për një cigare, më shumë se 10 miligram monoksid të karbonit për një cigare”.

Testimet për katranin, nikotinën dhe monoksidin e karbonit për një cigare do të duhej të bëhen në laboratorët e licencuara nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

Pyetja është: A është bërë kërkesa nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë për blerjen e standardeve përmes Agjencionit për Standarde në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, të cilat standarde do të mundësonin matjen e sasisë së katranit, të nikotinës dhe të monoksidit të karbonit në një cigare? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju faleminderit!

Nuk është e tepërt të përkujtohet se duhani është shumë e dëmshëm. Sa i përket pyetjes konkrete, më lejoni t'iu them që Këshilli profesional për kontrollin e duhanit dhe zbatimin e ligjit, më 20 qershor 2007, me shkresën 10/256, në kuadër të planit të veprimit të zbatimit të ligjit ka zhvilluar takim me Agjencionin për Standarde në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe e ka bërë kërkesën sipas ligjit.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Deputete, ke pyetje shtesë? Ju faleminderit!

Pyetja e radhës:

Deputeti Bahri Hyseni, pyetje për ministrin e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi.

Deputet, mund ta parashtroni pyetjen!

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

E nderuara ministre,

A keni plan për themelimin e Gjykatës së Qarkut në Ferizaj, duke marrë parasysh që Ferizaj bën pjesë në grupin e qyteteve me numër të madh të banorëve dhe duke pasur parasysh që edhe komuna e Kaçanikut, Shtimes, Hanit të Elezit dhe Shtërpçës kryejnë shërbime në këtë gjykatë? Kjo do të ndikonte pozitivisht edhe për Gjykatën e Qarkut në

Prishtinë, të lirohej nga ky numër i madh i lëndëve që janë dhe do të ndikonte pozitivisht edhe për qytetarët e këtij regjioni që t'i kenë më afër këto shërbime të domosdoshme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministre, e keni fjalën!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I kërkoj falje deputetit Bahri Hyseni që nuk po dal në foltore për të mos i çuar këta të tre, por dua të them se Ministria e Drejtësisë nuk themelon gjykata, ajo nuk është në kompetencën e Ministrisë e Drejtësisë. Gjykatat themelohen me ligj, ligji është në përgatitje e sipër dhe do të merret në konsideratë edhe kjo pyetje që e shtruat ju dhe nevoja për një gjykatë të tillë.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministre!

Deputet, a ke pyetje shtesë?

Deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Dua vetëm ta bëjë një qartësim. Nuk kërkoja që Ministria e Drejtësisë ta themelojë gjykatën, mirëpo kërkoja ta di a është në plan në ligjin që ju jeni sponsor, se a është paraparë themelimi i Gjykatës së Qarkut? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministre! Apo përgjigja u dha, konsideroj. Vazhdojmë me pyetjen e radhës. Deputetja Myzejene Selmani, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala.

Deputete Selmani, e keni fjalën!

MYZEJENE SELMANI: Zoti ministër, gjendja momentale sikurse edhe ajo e mëparshme në kompanitë publike edhe pas miratimit të Ligjit për ndërmarrjet publike është e njëjtë. Edhe pas kësaj vazhdon funksionimi i tyre me ushtrues detyre dhe menaxhment joefikas.

A po bëhet shkelja e Ligjit për ndërmarrje publike në këto kompani dhe cilët janë hapat tuaj konkret në këtë drejtim?

KRYETARI: Ju faleminderit! Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: E nderuara deputete, dje e kemi pasur mbledhjen, faktikisht të grupit ndërministror, i cili në bazë të Ligjit ka kompetencë dhe obligim për ta sugjeruar Qeverinë për emërimin e anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike.

Me ligj jemi të obliguar që deri me 15 dhjetor t'i zgjedhim anëtarët e bordeve në bazë të konkursit të hapur dhe ne do ta bëjmë këtë. Besoj që javën e ardhshme do t'i shpallim konkurset për anëtarë të Bordit dhe ne i thërrasim të gjithë ata që janë të interesuar edhe përmes kësaj foltoreje, që t'i paraqesin aplikacionet e tyre.

Jam i sigurt që ne do t'i realizojmë komplet obligimet tona konform politikave që kemi trajtuar bashkërisht në Qeveri dhe konform obligimeve ligjore që na obligojnë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Deputete, a ke pyetje shtesë?

MYZEJENE SELMANI: Kryetar, sa për informacion, Ligji i ndërmarrjeve publike ka hyrë në fuqi diku nga 15 shtatori, kur është dekretuar nga Presidenti. Ligji kërkon që brenda 90 ditëve Qeveria të dalë me strategji dhe pronësi për zhvillimin e ndërmarrjeve publike qendrore, kur zoti ministër deri tash dihet se dy kompanitë më të mëdha PTK-ja dhe KEK-u, udhëhiqen me udhëheqës menaxhues, kur nuk dihen akoma strategjia dhe politikat operacionale të zhvillimit të ndërmarrjeve publike.

Përse nuk respektohet neni 6 i këtij ligji, pra këtu kemi shkeljen e ligjit? Kush do të japë përgjegjësi kur ju jeni personi, i cili menaxhoni me ndërmarrjet publike? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, urdhëro me përgjigje, nëse vërtet i menaxhoni ndërmarrjet publike!

MINISTRI AHMET SHALA: Po t'i lexosh edhe nenet e tjera, jo vetëm atë nen, sigurisht që do të gjesh se me ndërmarrje publike menaxhon Bordi edhe politikat i përcakton Bordi. Ne si Qeveri mbështesim strategjitë, faktikisht sektoriale, e të cilat janë privatizimi ose dhënia me koncesion, veprime të cilat i kemi bërë.

Çështja e drejtorëve menaxhues është, po ashtu, përgjegjësi e bordeve, derisa të gjejnë njerëz të cilët janë adekuat dhe njerëzit të cilët i kanë kompetencat, konform termave të referencës që i ka përcaktuar Bordi.

Unë besoj dhe kemi besim që gjatë procesit të seleksionimit të bordeve permanente, këto janë borde të përkohshme në fazën e tranzicionit deri më 15 dhjetor. Ne, thashë, që deri më 15 dhjetor do të shpallim tenderët për emërimin e anëtarëve të bordeve nëpër secilin ndërmarrje publike dhe nëpër ndërmarrje tjera lokale kemi kërkuar nga pushteti lokal që të iniciojë. Jam i sigurt që anëtarët e Bordit dhe mënyra selektive do të jetë konform kualiteteve që ofron tregu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputetja Luljeta Shehu, pyetje për ministrin e Transportit, zotin Fatmir Limaj. Deputete Shehu, mund ta parashtroni pyetjen!

LJULJETA SHEHU: I nderuar Kryetar,
I nderuari Kryeministër,
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,

Me qenë se janë duke u asfaltuar rrugët, sidomos në zonat rurale, në brendi të fshatrave shpeshherë ndodhin edhe aksidente komunikacioni, ku më së tepërmi pësojnë fëmijët parashkollorë dhe shkollorë. Pyetja është: A keni në konsideratë ndarjen e një pjese të rrugëve të asfaltuara në brendi të fshatrave me një rrugë të ngushtë që është e kufizuar me mbrojtëse nëpër të cilën rrugë mund të kalojnë fëmijët? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI FATMIR LIMAJ: I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryeministër,
Të nderuar kolegë deputetë,

Ju falënderoj për pyetjen! Siç e thatë edhe ju, ne kemi bërë investime këtë vit sikurse edhe viteve të kaluara në shumë zona të thella, fshatra rurale, zona rurale të Kosovës. Normalisht, me asfaltimin e rrugëve shtrohet nevoja edhe e rregullimit të trotuareve, të krijimit të kushteve të sigurisë për fëmijë. Dua t'ju them që vendi ynë, Kosova, ballafaqohet me probleme të natyrave të ndryshme, si me sigurinë në komunikacion ose me infrastrukturën. Para se të flasim për fshatrat, siç themi në zona të thella, ne kemi ende probleme sa u përket rrugëve magjistrale, rrugëve të kategorisë së parë dhe të dytë. Domosdoshmërisht, duhet të krijojnë kushte për sigurinë e fëmijë tanë, krijimin e rrugëve me trotuar ose të nënkalimeve të ndryshme. Ne këtë vit kemi filluar një proces të tillë në vendet të cilat janë të kategorisë së parë, në rrugën magjistrale besoj i keni përcjellë disa nga këto projekte.

Në brendi të fshatrave, siç e dini, Ministria e Transportit është kompetente për rrugët magjistrale dhe regjionale, ndërsa mbikëqyrjen e rrugëve lokale e bëjnë komunat, përkatësisht drejtoritë përkatëse të komunave. Ne do të jemi të gatshëm, me mundësitë dhe kapacitetet tona, që edhe në ato zona t'u ndihmojmë komunave në krijimin e kushteve ose ngritjen e kushteve të sigurisë për fëmijët tanë, sidomos në ato vende që frekuentohen shkollat dhe çerdhet e fëmijëve.

Dua të them që besoj se viti i ardhshëm do të jetë një nga angazhimet tona, duke marrë parasysh edhe Ligjin për sigurinë në komunikacion, duke marrë parasysh edhe investimet që do të bëhen nëpër komuna, së bashku me komunat ne do të jemi të gatshëm për të shtuar investimet, Ministria e Transportit, në pjesën e saj, dhe komunat, në zonat e tyre të thella.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputete, a ke pyetje shtesë? Faleminderit!

Pyetja e radhës. Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj. Deputete Pantina, mund ta parashtroni pyetjen!

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Mosakreditimi i institucioneve private të Arsimit të Lartë ka ndikuar që një numër i madh i maturantëve tanë të aplikojnë nëpër universitetet shtetërore dhe private të shteteve fqinj. Raundi i dytë i akreditimit të institucioneve private të arsimit të lartë pritet të fillojë tani në tetor. Zoti ministër, ju deklaroni se këto institucione duhet t'i plotësojnë standardet dhe kriteret, të cilat janë të specifikuara në Ligjin për arsimin e lartë. Në anën tjetër, institucionet private të arsimit të lartë ankohen se nuk kanë të qarta se çfarë kriteresh duhet t'i plotësojnë në mënyrë që të akreditohen. Zoti ministër, ku qëndron problemi?

KRYETARI: Ministër, mund të përgjigjesh.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti Kryetar,

I nderuari zoti Kryeministër,

Të nderuar kolegë, ministra, deputetë,

Mendoj se kriteret sa i përket procesit të akreditimit janë të qarta nga viti 2003, kur në këtë Kuvend është miratuar Ligji për arsimin e lartë. Më lejoni të them që nëse teknikisht e shpjegojmë se çka nënkupton akreditimi dhe licencimi, ndoshta, mund të përdorim një paralele që vjen prej teknologjisë informative. Akreditimi merret me softuerin, me përmbajtjen, me cilësinë, licencimi merret me harduerin, me parakushtet. Dhe, Ligji për

arsimin e lartë dhe Udhëzimi administrativ i vitit 2004 që e trajton çështjen e licencimit në mënyrë shumë specifike dhe hollësisht tregon se cilat parakushte duhet të plotësohen. Përveç kësaj, ekziston edhe ajo se çfarë thirret si Konventë e Bergenit, e cila është një dokument ndërkombëtar që e rregullon çështjen e akreditimit të universiteteve private. Të qenit universitet nënkupton që duhet të ketë staf akademik, stafi akademik nënkupton që çdo kandidat duhet ta bëjë një karter shkencor, të ketë thirrje akademike, është një shtresim shumë më i hollësishëm, duhet të ketë punë shkencore hulumtuese, duhet të ketë drejtime të studimit që u referohen nevojave të ekonomisë dhe të shoqërisë dhe në përputhje me këto kritere bazike do të duhej të ndodh edhe diçka e tillë.

Më lejoni t'ju informoj që akreditimi ka filluar nga 1 tetori dhe nga 1 tetori çdo bartës privat, duke përfshirë edhe Universitetin e Prishtinës, do të duhej të fillonte procesin e vlerësimit të brendshëm, Në momentin kur dorëzohet raporti i vlerësimit të brendshëm, fillon procesi i vlerësimit të jashtëm, se të dyja proceset nënkuptojnë si një proces të akreditimit. Ne presim që universitetet private dhe Universiteti Publik i Prishtinës, deri në muajin dhjetor ta dorëzojnë raportin e vlerësimit të brendshëm, mandej do të fillojë edhe periudha e vlerësimit të jashtëm.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputete Pantina, a ke pyetje shtesë?

MYRVETE PANTINA: Po. Zoti ministër, a mendoni se është bërë mjaft për sqarimin e kritereve të nevojshme për akreditimin e këtyre institucioneve, meqë në opinion është krijuar përshtypja se ka paqartësi?

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Vërtet, nuk e dëgjova pyetjen mirë, a mund ta përsëritni edhe njëherë!

MYRVETE PANTINA: Zoti ministër, a mendoni se është bërë mjaft për sqarimin e kritereve të nevojshme për akreditimin e këtyre institucioneve, meqë në opinion është krijuar përshtypja se ka paqartësi?

MINISTRI ENVER HOXHAI: Unë mendoj se është bërë mjaft për sqarimin e kritereve jo vetëm sa i përket bartësve të arsimit privat dhe sa i përket opinionit publik. Besoj që akreditimi, si temë, është një temë e cila është pjesë e shtëpive tona dhe çdokush pothuaj se e ka një ide se çka nënkupton. Ndërsa, kur është fjala tek bartësit privatë, ekziston Ligji nga viti 2003 do të thotë që 6 vjet, ekziston një material, i cili u është dërguar të gjitha universiteteve private. Por, përveç kësaj, me qëllim që të mos hidhet argumenti vazhdimisht që nuk janë të informuar, ne, si Ministri e Arsimit, konkretisht, Agjencia e Kosovës për Akreditim, gjatë muajit nëntor do të organizojmë seminare shumë profesionale me ekspertë ndërkombëtarë të cilën formë konkrete do t'ju shpjegojmë këtyre universiteteve se çka duhet të plotësohet. Shqetësimi ynë si Qeveri është që debati ma tepër ka qenë moralizues, ku mbi të gjitha nuk ka pasur përkushtim që të plotësohen kriteret, ndërsa kriteret janë të njoftuar ndërkombëtarisht sa i preket fushës së akreditimit dhe janë të definuar me ligj. Ne shpresojmë që deri në fund të vitit akademik do të përfundojë raundi i dytë i akreditimit dhe nëse kemi parasysh raportin e Këshillit Britanik për Akreditim, tabloja që ofrohet është më e diferencuar, ka punë shumë pozitive ka edhe aspekte të cilat nuk janë edhe të lavdërohen, kështu që besoj që pjesën e sqarimit do ta kryejmë, por do ta kryejmë edhe në rrafshin profesional nga tetori edhe nëntori....

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Pyetja e radhës. Deputetja Rita Hajzeraj, pyetje për ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen!

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti Kryetar! Përshëndetje për të gjithë!

Sot, kur gjuha angleze po bëhet një gjuhë për komunikim global, ndërsa në Kosovë në sistemin arsimor të nivelit fillor, të mesëm, të ulët dhe atij të mesëm të lartë mbi 50% e mësimeve të gjuhës angleze janë të padiplomuar në këtë lëmi dhe përqindja tjetër e mësimeve të gjuhës angleze, për fatin më të mirë, mund t'i kenë mbaruar 2 apo 3 nivele kurseesh të gjuhës angleze. Kjo është shumë dekurajuese për të nesërmen e fëmijëve tanë.

Zoti ministër, cilat janë politikat e Qeverisë, apo konkretisht të Ministrisë suaj për të ndryshuar këtë gjendje? Më konkretisht, a ka Ministria juaj një strategji për të dalë nga kjo gjendje?

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zonja deputete, ju falënderoj shumë për një pyetje të tillë. Më lejoni t'ju them që gjuha angleze nuk është vetëm gjuhë, për Kosovën, gjuha angleze është mjet, është instrument i punës, është shkathtësi. Prandaj, ne si Qeveri e Kosovës, ajo se çfarë kemi bërë gjatë këtij viti është se për herë të parë e kemi dhënë një përgjigje të saktë kush është arsimtar në shkollat e Kosovës. Për herë të parë e dimë që nga 25 mijë arsimtarë, 2.800 arsimtarë janë të pakualifikuar. Në mesin e atyre të cilët janë të pakualifikuar janë sidomos arsimtarët e gjuhës angleze, mjerisht edhe arsimtarët e matematikës dhe të shkencave të fizikës dhe të kimisë.

Prandaj, procesi i licencimit, ku faza e parë veçse ka filluar, nënkupton që çdo arsimtar duhet të ketë përgatitje të nevojshme profesionale. Pra, ne si Qeveri, nga viti 2009 nuk do të ofrojmë programe trajnuese sa për të thënë trajnim, por përgatitja profesionale nënkupton marrjen e një grade universitare në rastin konkret për arsimtarët në përfundimin e fakultetit. Kjo është, do të thotë, çfarë ka ndodhur gjatë vitit 2008. Ajo se çfarë do të ndodhë gjatë vitit 2009 është kjo që ne, si Qeveri, do të dalim me propozimin pas një konsulte me shkollat fillore dhe të mesme që mësimi i gjuhës angleze në shkollat e Kosovës të fillojë nga klasa e parë dhe do të bëjmë përpjekje maksimale që t'i rishikojmë plan-programet, meqë Kosova ka nevojë përmes gjuhës angleze të komunikojë me botën dhe gjuhën angleze do ta promovojmë si gjuhë jashtëzakonisht të rëndësishme. Fjalja ime e fundit është që ata nxënës që zotërojnë gjuhën angleze ose gjuhën shqipe mirë dhe matematikën, në të ardhmen mund t'i ushtrojnë krejt profesionet. Prandaj, edhe përkushtimi ynë, si Ministri e Arsimit, është gjuha, gjuha angleze, matematika dhe mund të ushtrohen në të ardhmen krejt profesionet e mundshme.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputete, a ke pyetje shtesë? Regjia, fjalën deputetes!

RITA HAJZERAJ: Zoti ministër, pyetja ime si duket, ndoshta, edhe e keni keqkuptuar, ishte për kuadrin deficitar të këtyre mësimeve, do të thotë, mungon ky kuadër. Ju, kur keni marrë postin e ministrin të Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë, besoj që e keni pasur të njohur këtë defekt apo, si të themi, këtë mangësi të këtyre kuadrove, apo të

ikjes së këtyre kuadrove nga shkollat në institucionet e tjera. Çka keni bërë ju prej që keni marrë mandatin tuaj, cili plan është hartuar? Çfarë strategjie keni hartuar? Unë jam shumë e vetëdijshme dhe dëgjova shumë me vëmendje që ju tani do të shikoni se cilat janë alternativat? Çka keni bërë konkretisht, cili është hartimi i strategjisë konkrete për kthimin e këtyre kuadrove?

KRYETARI: Ministër, mund të vazhdosh!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Që fjalitë e mia të jenë shumë lineare, çka kemi bërë në vitin 2008? Prej 25 mijë arsimtarëve dimë që 2.800 janë të pakualifikuar në mesin e këtyre 2.800 e dimë saktësisht se sa janë të pakualifikuar në gjuhën angleze. Kjo ka ndodhur gjatë muajit maj, qershor dhe korrik. Ajo se çka do të bëjë gjatë vitit 2009 është që me Universitetin e Prishtinës do të bisedojmë se si këta arsimtarët e gjuhës angleze t'i përfundojnë studimet e gjuhës angleze dhe të kualifikohen.

KRYETARI: Ministër, faleminderit!

(Ndërprerje)

Pyetja e fundit. Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Transportit, zotin Fatmir Limaj. Deputet Smaka, mund ta parashtroni pyetjen!

RIZA SMAKA: Me respekte, auditorit. Konform me dispozitën e nenit 26 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Limaj, me konsiderata ju pyes përkitazi me shkallën, masën dhe cilësinë e aplikimit aktual të dispozitës së nenit 13 të Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor, e cila i referohet vendosjes dhe përfilljes së shenjave të komunikacionit rrugor. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Faleminderit, për pyetjen, profesor!

Siç e thatë edhe ju, iu referuat Ligjit për sigurinë në komunikacion, është një ligj që këtë vit është miratuar. Vërtet, në rrugët e Kosovës në tërësi, në infrastrukturën rrugore në Kosovë gjendja e sinjalizimeve horizontale dhe vertikale në përgjithësi ka qenë jashtëzakonisht e keqe, ka pasur probleme të natyrave të ndryshme. Mungesa e shenjave të domosdoshme të cilat krijojnë, po ashtu është imperativi kryesor për të krijuar parakushte për sigurinë në komunikacion, kanë shtyrë Ministrinë e Transportit që këtë vit parasheh në Buxhetin e saj rritjen e kësaj vije buxhetore, me qëllim që vitin e ardhshëm në sinjalistikën vertikale dhe horizontale rrugët e Kosovës të jenë në nivelin e kënaqshëm në përputhshmëri të plotë edhe me standardet evropiane, por para së gjithash me Ligjin për sigurinë në komunikacion.

E thatë edhe më herët, në pyetjen e deputetes, kjo lidhet drejtpërdrejt me sigurinë e qytetarëve. Tani për tani në Kosovë, ju e dini, në të gjitha rrugët e Kosovës ne nuk kemi asnjë shenjë e cila tregon kilometrin nga qyteti në qytet. Mungojnë ndriçimet rrugore, mungojnë semaforët e domosdoshëm në vendet e caktuara dhe të gjitha këto kanë ndikuar që ne në vitin e ardhshëm të ndërtojmë një infrastrukturë komplet të re sinjalistike dhe t'i kategorizojmë rrugët, sepse edhe kjo është tepër e domosdoshme, të kemi kategorizimin dhe sinjalistikën e rrugëve nga ato magjistrale, regjionale në rrugët lokale. Dua t'ju them po ashtu që, me gjithë mungesën e madhe të këtyre shenjave sinjalizuese në rrugët e Kosovës, fatkeqësisht ne jemi ballafaquar edhe me një fenomen tepër negativ. Me gjithë numrin e vogël, thashë, ne jemi ballafaquar edhe me vjedhjet, vjedhjet e shumta që kanë

ndodhur, fatkeqësisht, në rrugët e ndryshme nëpër Kosovë. Vidhen shenjat e komunikacionit, si në atë hekurudhor, ashtu edhe në atë rrugor dhe, normalisht, po bëjmë përpjekje së bashku me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe me drejtoritë përkatës, me komunat që këtë fenomen ta ndërpresim dhe përfundimisht Kosova ta ketë sinjalizimin e duhur. Ju siguroj që nga tash ju do të shihni shpejt në rrugën Prishtinë - Fushë Kosovë dhe nga ajo rrugë e tutje do të shihni formatin se si do të duket sinjalistika vertikale dhe horizontale në të gjitha rrugët e Kosovës, e sidomos për vitin e ardhshëm.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, a ke pyetje shtesë? Regjia, fjalën deputetit Smaka.

Përgjigja ishte korrekte. Do të isha angazhuar në këtë kontest që Qeveria t'i marrë përsipër njëherësh, krahas sinjalizimit edhe emërtimet në konformitet me patronimet, me homonimet, me hidronimet autoktone, origjinale që kanë mbështetjen në historiografi, në etnografi, në etnokulturë, që janë të pranueshme për popullin edhe të bëhet, sepse ajo është një punë tepër e rëndësishme nga të gjitha sferat e jetës shoqërore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Me këtë koment të deputetit Smaka, ne e përfundojmë pikën -Pyetjet parlamentare dhe përgjigjet.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i mocionit për procedimin e ligjeve të pashpallura

Të nderuar deputetë,

Kryesia e Kuvendit të Kosovës, duke u bazuar në Rregullën 32 dhe 61 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh vendimin e Kuvendit të Kosovës të datës 17 korrik 2008 për procedimin e 17 ligjeve të pashpallura për rishqyrtim në komisionet parlamentare, duke qenë në dijeni për rregullat dhe natyrën e veçantë të rishikimit dhe të amendimit të këtyre ligjeve në një proces të veçantë ligjvënës, i propozon seancës plenare që të marrë vendim për procedimin e ligjeve të pashpallura sipas tekstit të propozuar.

Teksti i mocionit iu është shpërndarë të gjithë deputetëve. Në bazë të rregullave procedurale, në fillim kërkoj deklarinimin e grupeve parlamentare. Kërkoj nga shefi i Grupit Parlament të PDK-së, të prononcohet.

Fjalën e ka deputeti Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti Kryetar,

Unë konsideroj që ky mocion është votuar njëherë në Parlament, megjithatë nuk prish punë që ta bëjmë për së dyti, që ta fuqizojmë këtë gjë, përndryshe më 17 korrik, nëse e mbaj në mend unë, është votuar njëherë, por mund ta rivotojmë sërish dhe ne jemi pro.

KRYETARI: Faleminderit! Sipas radhës, shefi i Grupit Parlament të LDK-së, Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet kërkesën që kjo pako e ligjeve të miratohet me mocion. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, shefi i Grupit të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Jam i vetëdijshëm që ky Kuvend ka votuar njëherë për shmangien nga procedurat përkitazi me këto ligjet e pashpallura, e mbaj po të njëjtin qëndrim si shef i Grupit Parlamentar, që e kam pasur edhe në Kryesinë e Kuvendit, që deputetëve t'u mundësohet së paku në leximin e dytë, sepse nuk do të ketë lexim të parë gjatë ofrimit të amendamenteve nga ana e komisioneve, t'u krijohet mundësi që edhe deputetët të japin fjalën e tyre. Jam shumë i vetëdijshëm se këto ligje kanë kaluar njëherë nëpër këtë Kuvend në një përbërje tjetër. Ne, po ashtu, kemi shmangur procedurat edhe gjatë miratimit të ligjeve që dalin nga Pakoja e Presidentit Ahtisari. Nuk konsideroj se këto ligje janë të ngutshme me të cilat do të mohohej e drejta e deputetëve që të deklarohen edhe për çështjet e tjera që kanë të bëjnë me të. Prandaj, po kërkoj që deputetëve t'u mundësohet në leximin e dytë, kur të ofrohen amendamentet, të japin edhe mendimet e tyre individuale sa i përket kësaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Ligjet kanë kaluar në Parlament, vendimi për t'u rikthyer është i 17 korrikut 2008. Vazhdojmë me radhë. Shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së e ka fjalën. Deputeti, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet mocionin të cilën e kemi para vetes. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë!

Sipas radhës, Grupi Parlamentar i LDD-së. Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe ne, si Grup Parlamentar, e përkrahim që përsheptimi i këtyre ligjeve të pashpallura thjeshtë të shkoj me mocion, jemi dakorduar edhe më 17 korrik dhe e përkrahim këtë mocion.

KRYETARI: Faleminderit, deputet Rugova!

Fjala tani është e Grupit Parlamentar SLS-së, fjalën e ka deputeti Slobodan Petroviq.

Regjia, fjalën deputetit Petroviq. Deputet, a keni kartelë? Faleminderit për pajtim!

Sipas radhës, shefi i Grupit Parlamentar "7+", Sadik Idriz e ka fjalën!

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedniče!

Mi zahtevamo da se ovo što je govorio gospodin Makoli, da se uvrsti u ovu mociju, ove preporuke, odnosno u ovu odluku, jer smatramo da postoji mogućnost da se amandmani koji će biti van redovne procedure, da će verovatno po neki amandman imati neke implikacije ne samo budžetske. Ovde je data mogućnost Komisiji za buxhet da raspravlja i da da svoje mišljenje o amandmanima. Ne radi se ovde o zakonima koji su usvojeni jednom od strane parlamenta, ovde se rati o tome na te zakone funkcionalne komisije daju amandmane, a da mi kao poslanici, kao poslaničke grupe ne možemo uticati na to. Tražim da se u ovu odluku uvrsti da pored Komisije za buxhet, i Komisija za prava i interese zajednica da svoje mišljenje o predloženim amandmanima. Mi imamo već

narednu šestu tačku dnevnog reda, gde ima nešto što nije u skladu sa Ustavom i sa zakonom o upotrebi jezika. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Ju njoftoj se prej sot, shefe e Grupit Parlamentar “7+” është deputetja Myfera Shinik, që e zëvendëson Zylfi Merxhën.

Deklarimi i shefave të grupeve përfundoi. Tash është procedura e votimit. Për fjalë është lajmëruar deputeti, Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Respekt, zoti Kryetar dhe auditor,

Nga kureshtja numrin më të madh të këtyre akteve ligjore i kam lexuar dhe them, me plot kompetencë, se kam hetuar defekte të konsiderueshme, ani pse ato kanë kaluar një procedurë. Ne e dimë fare mirë se edhe ligjet të cilat janë në fuqi, kanë edhe nuk mund të mos kenë defekte. Angazhohem që këto të kalojnë në procedurë edhe ta shfrytëzojmë ne oportunitetin për t'i rishikuar edhe për t'i krehur, si të them, se kurrë nuk do të ishte mjaftë. Kjo është, një. E dyta, procedura për ndryshimin dhe plotësimin e akteve ligjore është relativisht e ndërlikuar edhe e kushtueshme, prandaj do të ishte edhe në aspektin e parimit të ekonomisë në procedurë e favorshme që këto, së paku në etapën e dytë, të diskutohen dhe, në anën tjetër, ne kemi një numër të konsiderueshëm të akteve ligjore, qoftë si akte, qoftë pjesërisht që nuk aplikohen fare. Prandaj, të gjitha rrethanat janë që e justifikojnë arsyeshmërinë e trajtimit të tyre edhe njëherë në këtë Kuvend. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Mahir Yagcilar e ka fjalën.

MAHIR YAGCILAR: Po, faleminderit, zoti Kryetar! Në cilësinë e deputetit edhe unë dëshiroj të mbështes mocionin për amendamentet, t'i lexojmë edhe në leximin e dytë, sepse mund të ndodhë që propozimet ose amendamentet e propozuara të kenë edhe mendimin e deputetëve, por gjithashtu, ndoshta kanë edhe nevojë të kalojnë edhe përmes Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Në këtë aspekt, në propozim vendim ndoshta duhet të jetë leximi i dytë edhe të kalojnë përmes Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ju njoftoj se të gjitha grupet parlamentare në Kryesinë e Parlament janë dyfish të përfaqësuara me anëtar të Kryesisë dhe me shefa të grupeve parlamentare dhe, përveç shefit të Grupit Parlamentar të AKR-së, nuk ka pasur kundërshti. Prandaj, shkojmë në procedurën e votimit. Ju njoftoj se në sallë janë 78 deputetë.

Kush është për mocionin? Kush është kundër? Kush abstenon?

Konstatohet se me 51 vota “për”, 9 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet mocioni.

Ju faleminderit!

Mendoj që është koha për një pauzë prej 15 minutash. Ju faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI IBRAHIM GASHI: Të nderuar deputetë, ju lus që t'i zini vendet.

Të nderuar deputetë, vazhdojmë punën.

Në sallë janë të pranishëm 69 deputetë, që do të thotë se mund të vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Rekomandimit për amendimin e Ligjit Nr. 02 L-119 për letërnjoftimin.

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të datës 17 korrik 2008 dhe të mocionit të miratuar sot për procedim me ligjet e pashpallura, Komisioni përgjegjës raportues – funksional, i përcaktuar me vendimin e Kuvendit të datës 17 korrik 2008, ka rishqyrtuar tekstin e Ligjit për letërnjoftimin dhe në afatin e paraparë Kuvendit i ka parashtruar rekomandimet me amendamentet e propozuara për shqyrtim dhe miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, zotin Rrustem Mustafa, që para deputetëve ta prezantojë raportin. Urdhëroni, zoti Mustafa.

RRUSTEM MUSTAFA: I nderuari kryesues,

Të nderuar deputetë,

Komisioni parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksional për Ligjin për letërnjoftim, ka paraqitur raportin me rekomandime, në të cilin është përshkruar procedura në të cilën ka kaluar ky ligj dhe si të tilla kanë ardhur për secilin deputet, i keni veç e veç.

Përveç amendamenteve të përfshira në këtë raport, kanë ardhur edhe tri amendamente nga sponsori, pra nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Ne, si Komision, i kemi shqyrtuar dhe deklarohemi se i pranojmë këto amendamente.

Ndërkohë, në emër të Komisionit kam edhe një propozim për tërheqjen e amendamentit numër 7 dhe propozimi ynë të hiqet tërësisht nga ai raport dhe të mbetet ashtu siç ka qenë e paraparë me ligj, neni 9, kështu që i thërras të gjithë deputetët ta miratojnë raportin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet! E kemi propozimin e kryesuesit të Komisionit për tërheqjen e amendamentit numër 7 dhe përmbajtja mbetet siç ka qenë në versionin në ligj. Ju lus të deklarohemi për këtë propozim të Komisionit.

Kush është “për”? Faleminderit!

A ka” kundër”?

A ka abstenime? Faleminderit!

Konstatoj se me shumicë votash amendamenti numër 7 hiqet.

Tani vazhdojmë me procedimin sipas amendamenteve të propozuara, përfshirë këtu edhe amendamentet shtesë, aty ku paraqiten në tekstin e Ligjit, e që i prezantoi kryetari i Komisionit.

Lus regjinë dhe deputetët, të bëhen gati për votim.

Në sallë janë 75 deputetë dhe mund të procedojmë me votimin.

Votojmë për amendamentin numër 1.

Regjia, votojmë tash:

Me 74 vota “për” dhe 1 “kundër” konsiderojmë se u aprovua amendamenti numër 1.

Kalojmë në votim të amendamentit 2.

Votojmë tash:

Me 68 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim” – konsiderojmë se u aprovua edhe amendamenti numër 2.

Vazhdojmë me amendamentin numër 3.

Votojmë tash:

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim” aprovohet edhe amendamenti numër 3.

Vazhdojmë me amendamentin numër 4.

Votojmë tash:

Me 71 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim” – aprovohet edhe amendamenti numër 4.

Vazhdojmë me amendamentin numër 5.

Votojmë tash:

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim” – aprovohet edhe amendamenti numër 5.

Vazhdojmë me amendamentin numër 6.

Votojmë tash:

Me 66 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim” – aprovohet edhe amendamenti numër 6.

Vazhdojmë me amendamentin 8 që bëhet numër 7, sepse amendamenti 7 u tërhoq.

Votojmë tash:

Me 71 vota “për”, 1 “kundër” – aprovohet edhe amendamenti numër 7.

Vazhdojmë me amendamentin e radhës numër 8.

Regjia gati! Votojmë tash:

Me 73 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim” – aprovohet edhe amendamenti numër 8.

Dhe brenda këtij amendamenti kemi një amendament shtesë, të cilin, po ashtu, duhet ta votojmë ndaras.

Përgatitemi për votim.

Votojmë tash:

Me 75 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim” – aprovohet edhe amendamenti shtesë numër 1.

Vazhdojmë me amendamentin 9.

Regjia, gati për votim!

Votojmë tash:

Me 61 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim” – aprovohet edhe amendamenti numër 9.

Vazhdojmë me amendamentin numër 10.

Regjia, gati për votim.

Votojmë tash:

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim” – aprovohet edhe amendamenti numër 10.

Vazhdojmë me amendamentin numër 11, që te ju është numër 12, për shkak të heqjes së amendamentit 7.

Regjia, gati për votim.

Votojmë tash:

Me 78 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim” – aprovohet edhe amendamenti numër 12.

Përgatitemi për votim të amendamentit numër 13.

Regjia, votojmë tash:

Me 76 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim” – aprovohet edhe amendamenti numër 13.

Dhe, me këtë rast, votojmë në kuadër të këtij amendamenti, i cili shkruan aty që zëvendësohet me amendamentin shtesë numër 2. Këtë e votuam, pra.

Vazhdojmë me amendamentin 14.

Regjia, gati për votim! Votojmë tash:

Me 76 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim” – aprovohet edhe amendamenti numër 14.

Vazhdojmë me amendamentin numër 15.

Regjia gati për votim. Votojmë tash:

Me 66 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim” – aprovohet edhe amendamenti numër 15.

Procedojmë me amendamentin numër 16.

Regjia, gati për votim!

Votojmë tash:

Me 75 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim”, aprovohet edhe amendamenti 16.

Vazhdojmë me amendamentin numër 17.

Regjia gati!

Votojmë tash:

Me 74 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim”, aprovohet edhe amendamenti numër 17.

Vazhdojmë me amendamentin 18.

Regjia gati për votim!

Votojmë tash:

Me 74 vota “për”, asnjë “kundër” dhe një “abstenim”, aprovohet edhe amendamenti numër 18.

Vazhdojmë me amendamentin numër 19.

Regjia gati!

Votojmë tash:

Me 75 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim”, aprovohet edhe amendamenti i parafundit numër 19.

Dhe, vazhdojmë me amendamentin e fundit numër 20, i cili zëvendësohet me amendamentin shtesë numër 3.

Lus regjinë të bëhet gati për votim.

Votojmë tash:

Me 74 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim”, aprovohet edhe amendamenti numër 20.

Të nderuar deputetë,

Kalojmë në votimin e tekstit të Ligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë të bëhet gati për votim!

Votojmë tash, për Ligjin në tërësi, me këto amendamente.

Në sallë janë 84 deputetë prezentë.

Konstatoj se me 72 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi aprovoi Ligjin për letërnjoftimin me amendamentet që i patëm në shqyrtim.

Faleminderit!

Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i rekomandimit për amendimin, ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 2003/9 për kooperativat e bujqve

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të datës 17 korrik 2008, dhe të mocionit të miratuar sot për procedim me ligjet e pashpallura, Komisioni përgjegjës, pra funksional, i përcaktuar me Vendimin e Kuvendit, të datës 17 korrik 2008, ka rishqyrtuar tekstin e Ligjit për amendimin, ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 2003/9 për kooperativat e bujqve dhe në afatin e paraparë Kuvendit i ka parashtruar rekomandime me amendamentet e propozuara për shqyrtim dhe miratim.

Ftoj, me këtë rast kryetarin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, zotin Lulzim Zeneli, që para deputetëve të prezantojë raportin.

Urdhëroni, zoti deputet Zeneli!

LULZIM ZENELI: Faleminderit, kryesues!

Komisioni parlamentar ka kryer amendimin e Ligjit në fjalë dhe i rekomandon Kuvendit të Kosovës për miratim amendamentet e propozuara. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, vazhdojmë me procedimin sipas amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional. Edhe me këtë rast do t'i votojmë amendamentet veç e veç.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim të amendamenteve.

Amendamenti numër 1.

Votojmë tash:

Me 71 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, konsiderojmë se u aprovua amendamenti 1.

Kalojmë në votim të amendamentit 2.

Votojmë tash:

Me 69 vota “për” dhe asnjë “kundër”, 1 abstenim, aprovohet edhe amendamenti 2, i fundit për këtë ligj.

Tashti votojmë për tekstin e ligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus deputetë dhe regjinë të bëhen gati për votim të ligjit.

Votojmë tash:

Me 76 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, konstatohet se u miratua Ligji për kooperativat e bujqve, bashkë me amendamentet e propozuara.

Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me gjendjen në parkun nacional “Malet e Sharrit” dhe në “Fshatin Turistik” në Prevallë**

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka paraqitur aktivitetet e zhvilluara në Parkun “Malet e Sharrit” dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Me këtë rast, ftoj kryetarin e Komisionit funksional, zotin Lulzim Zeneli që të paraqesë raportin e Komisionit. E keni fjalën, zoti Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Komisioni parlamentar për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, pas marrjes së letrës nga institucioni i Ombudspersonit, me datën 6 qershor 2008, dërguar Kuvendit të Republikës së Kosovës, ia tërheq vërejtjen Kuvendit të Republikës, në bazë të informacioneve që posedon ky institucion, ku kuptohet se në parkun nacional “Malet e Sharrit” mbizotëron një gjendje e papranueshme e karakterizuar me shkatërrime të papranueshme, me shkatërrime ilegale të resurseve natyrore, ndërtimet e gurëthyesve, ndërtimet ilegale të objekteve dhe për të gjitha këto ia tërheq vëmendjen Kuvendit të Republikës së Kosovës se këto shkelje janë aq të mëdha sa bien në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit për parkun nacional “Malet e Sharrit”, të Ligjit për planifikim hapësinor dhe të Ligjit për mbrojtjen e natyrës.

Komisioni parlamentar, duke qenë me kompetencë të plotë politike dhe profesionale, ka trajtuar këtë kërkesë nga institucioni i Ombudspersonit dhe pas dëgjimit parlamentar, me pjesëmarrje nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, gjithashtu të ushtruesit të detyrës së Ombudspersonit, të Kuvendit Komunal të Prizrenit, organizoi vizitë studimore në parkun nacional “Malet e Sharrit” dhe vizitë pune në Kuvendin Komunal të Prizrenit.

Gjatë vizitës që kemi pasur, u njoftuam për së afërmi nga zyrtarët profesionistë të Kuvendit Komunal të Prizrenit për dëmet dhe shkeljet që kanë ndodhur dhe janë duke ndodhur në parkun nacional “Malet e Sharrit”. Pas shqetësimeve të shprehura nga ana e komisionit funksional, citoj vetëm këtë deklaram të kryetarit të Kuvendit Komunal.

“Këtu po ballafaqohemi jo vetëm me ndërtime ilegale të gurthyeseve, por ne po ballafaqohemi sot e shumë kohë më parë me lëvrimet e brigjeve të lumit Drin, të cilat po shfrytëzohen pa kurrfarë mëshire dhe nuk ka kush që i ndalë. Pra, si kuvend komunal”, citoj, gjithnjë, “jemi të pafuqishëm në luftimin e kësaj dukurie”.

Komisioni parlamentar pas analizës së bërë në mbledhjen e vet të datës 2.7.2008, nxori këtë konstatim:

- Aktivitetet e zhvilluara janë në kundërshtim të plotë me Ligjin për mbrojtjen e natyrës, Ligjin për planifikim hapësinor dhe Ligjin për parkun nacional “Malet e Sharrit”.
- Prejjet ilegale të pyjeve jo vetëm që janë rritur në mënyrë drastike viteve të fundit, por asgjë nuk është ndërmarrë në këtë drejtim për të ndaluar një dukuri të tillë. Gjatë kësaj kohe kanë ekzistuar dhe ekzistojnë indikatorë të fuqishëm edhe për implikime të zyrtarëve përgjegjës në këtë fenomen.
- Dëmtimet janë të përmasave të mëdha dhe sidomos në rajonin e Gradancit, të Dellovcit dhe të Rusenicës.
- Shfrytëzimi i kundërligjshëm i gurit në rezervatin e mbrojtur me ligj, në mënyrë strikte, Rusenica, zonë kjo që paraqet, siç thashë një rezervat strikt të mbrojtjes së natyrës, përndryshe për informacion të deputetëve të Kuvendit, ky është një vendbanim i llojit të mbrojtur të Rugebullit, dhe ky eksploatim që po bëhet me minim paraqet kulmin, lirisht mund të them, krimin ndaj natyrës që është e mbrojtur me ligjet vendore dhe me konventat ndërkombëtare.

Për kujtesë, sipas Ligjit për mbrojtjen e natyrës, neni 18, prania e njerëzve në rezervatin strikt është e ndaluar, e merrni me mend, këtu ushtrohet veprimtari ndërtimore. Ky veprim dhe aktivitetet e tilla janë në kundërshtim me interesat zhvillimore dhe nacionale të Kosovës dhe kanë si pasojë të rëndë jo vetëm ekologjike, shkatërrimin e vlerave natyrore, por edhe të atyre ekonomike, pasi buxheti i Kosovës nuk përfiton asgjë, dhe sociale për parkun nacional “Malet e Sharrit” dhe Republikën e Kosovës.

Për njoftim, shfrytëzimi ilegal i gurit në zonën e parkut nacional “Malet e Sharrit” është duke ndodhur edhe në malin Oshlak, rajoni i Mushnikovës. Ndërtimi i ashtuquajtur “Fshati Turistik” në Prevallë paraqet një storje të veçantë në këtë drejtim dhe duhet në mënyrë të veçantë edhe të trajtohet. Dhe, krejt kjo është në kundërshtim të plotë me Ligjin për parkun nacional, nenin 1, 2, 4, 6, 7, 8 dhe 11, Ligjin për mbrojtjen e natyrës, neni 1, 2, 4.1, neni 6, 10, 11, 12, 13.2, 15 dhe neni 16 për të vazhduar me nenin 21, 22, 23, 30, 35.4, në kundërshtim me nenin 36, 37 dhe nenin 41. Është në kundërshtim, po ashtu, me Ligjin për planifikim hapësinor, neni 3 pika a), neni 10, neni 12, 17.1, 17.2, neni 19 dhe neni 21.

Do të shkoqis vetëm disa nga argumentet që janë të mjaftueshme për të kuptuar për çka bëhet fjalë.

Plani rregullativ urban është në kundërshtim të plotë me qëllimet dhe parimet themelore të ligjeve të Kosovës. Plani rregullativ urban “Prevalla” nuk ka mundësi ligjore të hartohet dhe të aprovet pa ekzistimin e planit hapësinor dhe të planit të posaçëm të menaxhimit, të programit për mbrojtjen dhe zhvillimin e parkut nacional, gjithmonë duke cituar Ligjin për parqet nacionale – parkun nacional “Malet e Sharrit”, nenin 2, nenet 5, 6, 7 dhe nenin 11, Ligjin për mbrojtjen e natyrës, nenin 36.2, Ligji për planifikim hapësinor, nenin 10.1, neni 12 dhe neni 17.2.

Komuna, gjegjësisht argument tjetër në këtë rast, Kuvendi Komunal i Prizrenit, nuk ka mundësi ligjore të bëjë plane për territorin e parkut nacional, sepse ky territor, me destinim dhe administrim të veçantë, nuk është kompetencë e komunës, por e Qeverisë dhe e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Citoj: Ligjin për mbrojtjen e natyrës, Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe Ligjin për parkun nacional “Malet e Sharrit”.

Plani rregullativ urban nuk është miratuar nga Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës, që është në kundërshtim të plotë me Ligjin për planifikim hapësinor, nenin 12, përkatësisht nenin 12.6.

Ndërtimi i objekteve bëhet në zonën e dytë të mbrojtjes ku është respektivisht i ndaluar ndërtimi i objekteve të tilla, pasi që paraqet zonë të mbrojtur me ligj.

Ligji për mbrojtjen e natyrës, neni 21, nenet 22, 23, Ligji për planifikim hapësinor, neni 17, neni 17.1, neni 17.2 dhe Ligji për mbrojtjen e mjedisit neni 18.

Në këtë drejtim nuk është bërë vlerësimi i ndikimit në mjedis dhe nuk është dhënë pëlqim mjedisor, që janë të domosdoshme në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës: Ligji për mbrojtjen e natyrës, Ligji për mbrojtjen e mjedisit, Ligji për ndërtim dhe Ligji për planifikim hapësinor, për çdo veprimtari që ushtrohet në natyrë, e në veçanti, ka të bëjë me parkun nacional. Sa për informatë, leja për ndërtim jepet në bazë të pëlqimit nga Institucioni për Mbrojtjen e Natyrës, duke u bazuar në Ligjin për planifikim hapësinor dhe në bazë të Planit zhvillimor për parkun nacional.

KRYESUESI: Zoti deputet, e keni kaluar kohën e lejuar. Regjia, mund t’ia vazhdojë vetëm një minutë.

LULZIM ZENELI: Plani rregullativ urban “Prevalla” bën shkelje të Kodit të përkohshëm penal të Kosovës në shumë aspekte. Nuk do t’i përmend nenet në fjalë. Është në kundërshtim të plotë me konventat ndërkombëtare dhe në bazë të kësaj që u tha, Kuvendit të Republikës së Kosovës i rekomandojmë:

- Të ndërpriten urgjentisht të gjitha aktivitetet në zonën e parkut nacional “Malet e Sharrit”, veprimtaria e gurthyese, aktivitetet ndërtimore në “Fshatin Turistik” në Prevallë, si dhe prerjet ilegale të pyjeve.
- Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të shqyrtojë seriozisht gjendjen e krijuar në parkun Nacional “Malet e Sharrit” dhe të informojë Kuvendin e Republikës së Kosovës lidhur me dëmet e shkaktuara.
- Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda 6 muajve të hartojë planin operacional dhe të ndajë buxhet për sanimin e gjendjes në terren.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zeneli! Deputetët e kanë pasur raportin dhe e kanë qe një kohë të gjatë para veti dhe e dinë për çka do të diskutohet në vazhdim. Unë ftoj që të deklarohen përfaqësuesit e grupeve parlamentare lidhur me raportin. Fillojmë nga Grupi Parlamentar i PDK-së. Fjalën e ka deputeti Berat Luzha, në emër të Grupit të PDK-së.

BERAT LUZHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Me Ligjin për parkun nacional “Malet e Sharrit”, të vitit 1986 është formuar parku nacional në sipërfaqe prej 39.000 hektarë, i vetmi deri tash në Kosovë i cili megjithatë ka filluar të funksionojë vetëm nga viti 1995, afër 9 vjet më vonë.

Meqenëse pas luftës, Drejtoria e parkut në Shtërpcë u uzurpua nga strukturat paralele, të lidhura me Serbinë, në vitin 2002, në kuadër të Ministrisë së Mjedisit u formua drejtoria legale me seli në Prizren. Kështu, parku i ndarë në dysh, tash udhëhiqet nga dy drejtori paralele.

Në vitin 2006, Kuvendi i Komunës së Prizrenit kishte angazhuar një firmë projektuese për të hartuar të ashtuquajturin “Plan i përkohshëm rregullues urban për zonën e Prevallës në parkun nacional “Malet e Sharrit”. Këtë plan, i cili përfshinte 75 ngastra kadastrale, kuvendi i komunës e ka miratuar më 22 qershor 2006, kurse pëlqimin nga Ministria e Mjedisit e ka marrë pas fillimit të ndërtimeve, rreth 2 muaj e gjysmë më vonë, më 4 shtator të atij viti. Pëlqimi i lëshohet komunës me kusht që të respektohen disa nene të cekura nga Ligji për planifikimin hapësinor, nga Ligji për mbrojtjen e mjedisit dhe nga Ligji për mbrojtjen e natyrës. Këto dy dokumente, vendimi i komunës dhe pëlqimi i Ministrisë, janë dokumente të lëshuara pa mbështetje të duhur ligjore, aq më parë kur Ministria ishte pajtuar që në parkun, të cilin me ligj e menaxhonte vetë, lejonte ndërtime nga një subjekt tjetër.

Parku nacional “Malet e Sharrit” as pas 22 vjetëve të ekzistimit, nuk ka plan hapësinor. Në këto kushte, në Prevallë kemi parregullsi të shumta. Nga 360 shtëpi të planifikuara, vetëm 36 sosh janë të pajisura me leje ndërtimi, që edhe ato janë kontestuese. Sipas standardeve të ndërtimit në zona të mbrojtura, kampshtëpizat duhet të ketë sipërfaqe prej 50 deri 70 m², kurse ndërtimi duhet bërë nga druri apo materiali tjetër që i përshtatet mjedisit, kurse këtu ndërtimi i shtëpive është bërë me material të fortë, me hekur e beton, si dhe me përmasa të mëdha dy e tri katëshe, me sipërfaqe bazë deri 300 metra katrorë, njëjtë si ndërtohen shtëpitë çdo kund tjetër. Në parqet nacionale zakonisht ndërtohen qendra turistike, rekreative dhe jo fshatra turistike.

Sipas ligjeve në fuqi, parkun nacional e shpall Kuvendi i Kosovës. Gjithashtu, të gjitha planet rregulluese në parqet nacionale kalojnë nga Ministria në Qeveri dhe nga Qeveria në Kuvend, për miratim. Në pikën 6 të nenit 12 të Ligjit për planifikimin hapësinor, thuhet: “Porsa të jenë finalizuar draftet, Ministria ia dorëzon ato Qeverisë për miratim paraprak dhe Qeveria ia procedon Kuvendit për miratim përfundimtar”. Kjo është rruga e vetme ligjore për shkak se parku nacional menaxhohet nga Ministria përkatëse dhe jo nga komuna, kurse Ministria, në këtë rast ka qenë vetëm një vëzhguese pasive. Çka do të bëhej sikur secila nga katër komunat që përfshihen në këtë park nacional të ndërtonin këso farë fshattrash? Me rastin e ndërtimit të këtij fshati, kemi dëmtim dhe degradim mjedisor. Plani komunal nuk mbështetet në vlerësimet e ndikimit në mjedis dhe as në vlerësimet strategjike mjedisore. Fshatit i mungojnë: infrastruktura komunale, rryma elektrike, uji, kanalizimi, vend parkimet, kurse dendësia e shtëpive, po të ndërtohej tërësisht fshati, do të ishte e patolerueshme. Tashmë në këtë fshat kemi edhe shtëpi të ndërtuara pa leje fare, njëra prej të cilave është në përmasa tepër të mëdha.

Edhe pse zonë e mbrojtur, fshati është përplot bërlllok, veçanërisht gjatë sezonit të pushimeve të verës. Edhe pse park nacional, prerjet ilegale dhe dëmtimet e pyjeve nuk kanë reshtur. Menjëherë, mbi vendbanimin që po ndërtohet, të cilin njëri e quajti “fshat i njerëzve të pasur”, është pylli i pishave që po thahet ngadalë vetëm nga pakujdesia jonë institucionale. Është për të mos u besuar, por brenda kufijve të parkut kemi edhe dy

gurthyes, kurse masat drusore nga ky park kanë ndodhur të dërgohen në Serbi. Kështu e menaxhonte Ministria parkun nacional. Shpresoj se ministri i tashëm do të marrë masa për menaxhim më të mirë dhe më të rregullt të tij.

Duke i parë parregullsitë e shumta, Ministria e Mjedisit sivjet ka kërkuar nga strukturat komunale të Prizrenit raport me shkrim për ndërtime, kurse komuna ka ndërprerë dhënien e lejeve, si dhe ka bërë ndërprerjen e ndërtimeve në këtë zonë. Që nga fundi i prillit të këtij viti, objektet ka filluar t'i mbikëqyrë inspeksioni komunal, por ai nuk ka pasur mundësi të bëhet më shumë se një vëzhgues i thjeshtë i ndërtimeve. Organet komunale kanë vendosur për ndërprerjen e ndërtimeve të reja dhe për ndërprerjen e dhënies së lejeve të ndërtimit. Ato, gjithashtu, kanë kërkuar formimin e një komisioni të Kuvendit të Kosovës për të shikuar urgjentisht gjendjen e krijuar.

Siç shihet edhe nga lista e pronarëve, një person ka dhjetëra shtëpi ndërtimi. Kjo tregon se në Prevallë po bëhet një lloj biznesi i llojit të vet në dëm të zonës së mbrojtur me ligj. Madje, atyre iu janë ofruar projekte të formave e të madhësive të ndryshme për t'i zgjedhur.

Grupi Kuvendor i Partisë Demokratike kërkon që të formohet një Komision Hetimor i Kuvendit, në mënyrë që pas një studimi të thellë të gjendjes, në afat prej 3 muajve, t'i sjellë rekomandimet e duhura. Deri në raportin e Komisionit Hetimor, të ndërpriten të gjitha aktivitetet ndërtimore në këtë lokalitet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Kalojmë te Grupi i dytë parlamentar, LDK. Fjalën e ka deputeti, Lutfi Haziri, kryetar i Grupit.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Shpresoj se herën tjetër, kur të kërkoj fjalën në emër të Grupit Parlamentar do të keni kujdes, sepse tendenca ime ishte që ta ftoj Kryeministrin të jetë prezent në këtë çështje, sepse kemi të bëjmë me një vendim apo me një rekomandim të komisionit funksional, i cili obligon edhe Qeverinë, përveç Parlamentit. Duke çmuar prezencën e dy zëvendëskryeministrave që kanë rol në udhëheqjen e Qeverisë, dhe duke çmuar prezencën tuaj, atëherë pas fjalës së grupeve parlamentare, unë shpresoj se do të jepni pauzë për aq kohë sa të kemi mundësi ta kemi prezencën e Kryeministrit këtu.

Unë po flas në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së e jo në emër të deputetëve që u takojnë grupeve tuaja. Është mirë të ruhet kjo e drejtë dhe këtë privilegj që e ka secili të flasë në emër të dikujt, e më së paku ata që kanë mendim ndryshe.

Për LDK-në, çmohet puna e komisionit funksional. Grupi ynë sigurisht e çmon rolin e çdo komisioni dhe deputeti në monitorimin e ligjit dhe në zbatimin të tij në përgjithësi. Kemi të bëjmë me një rekomandim final, i cili, pas sqarimeve që dha kryetari i Komisionit përkatës, zoti Zeneli, tregon qartë se nuk kemi të bëjmë vetëm me zbatim të ligjit. Nuk kemi të bëjmë vetëm me tendencën dhe rolin e komisionit për ta zbatuar ligjin, por kemi të bëjmë edhe me tendenca tjera të motivuara, të cilat unë do t'i sqaroj në pika të shkurtra.

Për Grupin Parlamentar të LDK-së zbatimi i ligjit është obligim i gjithkujt dhe secili në nivelin e vet dhe kapacitetet e tij duhet ta marrë mbi vete.

Nën 2, ky material, apo ky komision që përfshinë edhe deputetët e LDK-së në atë komision, nuk i ka pasur provat e domosdoshme në dorë për të arritur deri te rekomandimi final. Katër dokumente bazike nuk i servohen Parlamentit dhe deputetëve, por i sjellin dhjetë fotografi me kopje shumë të zbehtë të cilat tregojnë një gjendje se si do të dukej Prevala dhe besoj se shumica prej juve, përveç meje, nuk ka qenë në Prevallë për të parë realisht gjendjen se si duket atje.

Mungesa e katër dokumenteve kryesore në material dhe sjellja e dhjetë fotografive tregon qartë që kemi të bëjmë me mosangazhim apo me tendencë që të jemi më pak të informuar, jo me diçka tjetër, por më pak të informuar.

Vendimi i Ministrisë, i bazuar në nene dhe në cilat ligje, askund në ligj nuk thotë – ndalohet Ministria ta bëjë këtë punë. Tregohet qartë rruga në të cilën do të kalojë. Vendimi i Asamblesë Komunale, po flasim për të drejta të ndara, tash me Kushtetutë. Nuk ka të drejtë as ky Parlament t'i ndërhyjë asamblesë komunale në planifikimin urban dhe rural, e lere më dikush tjetër. Planifikimi urban dhe rural i subordinohet planifikimit hapësinor dhe planifikimi hapësinor, sigurisht, sipas ligjit, i ka pritur asamblatë komunale në procedura dhe në rrugë që kalon për t'i adaptuar këto plane. Vetëm në rast kur dështon asambleja komunale ka të drejtë të ndërhyjë Ministria përkatëse në detyrimin apo zbatimin e këtij plani, duke ia marrë këtë drejtë në ushtrim.

Mungesa e vendimit të Asamblesë Komunale apo ndalesa që ka ardhur nga Asambleja Komunale... Shikoni, vendimin e një asambleje komunale, sipas ligjit, ka të drejtë ta anulojë vetëm asambleja komunale apo institucioni më i lartë që në këtë rast është Kryeministri, pas rekomandimit nga ministri i Pushtetit Lokal. Bordi i drejtorëve në Prizren ka dalë mbi Asamblenë Komunale, duke i ndaluar punimet në Prevallë dhe kemi të bëjmë me një vendim të paligjshëm.

Këtu, zoti Zeneli, nuk e keni paraqitur proceduralisht shkeljen e ligjit edhe në këtë nivel.

Kemi të bëjmë me ligj. Monitorimi i ligjit nuk e njih emrin, mbiemrin apo partinë në atë organizatë, e njih vetëm zbatimin e ligjit. Nëse është konstatuar se është bërë kjo e nuk është konstatuar vendimi i paligjshëm i subjektit tjetër, është motivi që e nxjerr para jush dhe është i qëndrueshëm.

Marrëveshja e qytetarëve, sepse kemi të bëjmë me toka private, nuk ka të bëjmë në rastin konkret me pronë publike, kemi të bëjmë me marrëveshje të pronarëve që kanë hyrë në aranzhuan me Asamblenë Komunale dhe me Ministrinë e Planifikimit Hapësinor. Këtu kemi të bëjmë edhe me fshatra, ai vend është i banuar tradicionalisht, shumë pak metra, larg Prevallës me banorë tjerë.

Ky Kuvend ka debatuar me kërkesën e Grupit Parlamentar, zotit Murati edhe më herët. Në këto dosje nuk i kemi rekomandimet e Komisionit të Legjislacionit të kaluar, ku zoti Zeneli ka qenë, po ashtu, deputet dhe e din mirë qëndrimin e Komisionit përkatës për çështjen e njëjtë, të iniciuar nga një grup parlamentar, që është ndryshe. Mendoj se edhe ky material është i mangët, ka qenë i domosdoshëm që të jetë pjesë e dokumentit dhe pjesë e debatit.

Rekomandimet e Komisionit- Shihet qartë, në çfarë rruge shkojnë këto rekomandime. Nën një, është marrë rekomandimi i Bordit të drejtorëve të Prizrenit, është vendosur këtu dhe që është i paqëndrueshëm, është jo legal. Nëse Asambleja Komunale e Prizrenit e vendos nuk mund ta mohojë askush që nuk është legale, por jo bordi i drejtorëve.

Asambleja komunale në komuna të Kosovës është organ vendimmarrës. Nuk ka autoritet më të lartë në komunë për të vendosur këtu, rekomandimi i parë, bie si i paqëndrueshëm.

Detyrat që ia jep Komisioni Qeverisë, ta sanojë gjendjen, janë detyra që nuk i përkasin Komisionit. Komisioni ka mund ta ketë vetëm një rekomandim. Rekomandimi është: kjo punë duhet të ndodhë dhe Qeveria obligohet t'i këqyrë ligjet vet. Qeveria është sponsor i ligjit, fundi i fundit. Obligohet t'i sheh ligjet vet ku janë këto. 6-7 rekomandime, një pas një, e çojnë motivin që janë harruar gurrthyesit, që duhet të ndalen. Lejen për gurrthyes, e jep Komisioni i pavarur në nivel të Kosovës, i cili komision nuk është dashur ta japë atë leje. Komuna pyetet e jep pëlqimin. Nëse komuna e Prizrenit, thotë: Nuk dua gurrthyes, nuk dua degradim të lumit", nuk mund dhe nuk ka autoritet në Kosovë të japë licenca.

Ky vendim i kushtëzuar është bërë. Në kohën kur është bërë, dikush e ka bërë, por Komisioni i Pavarur për Minerale dhe Miniera duhet të japë llogari: edhe për degradimin e lumit, edhe për gurrthyes, edhe për çështje tjera. Komuna e Prizrenit e ka vetëm një rol, vetëm detyra e tyre ka qenë planifikimi urban dhe rural, dhe është e drejtë komunale.

Në Parkun Nacional, për zonën që po flasim, Ministria e ka një vendim dhe ky vendim, zonja e zotërinj, është kështu.

Ju kisha lutur që kur të shpërndani letra të ambasadorëve që kanë shkuar prej Kosove me detyrë, t'i çoni edhe në gjuhën që me ditë a është përkthimi i mirë, se neve na ka dalë që në përkthim shpeshherë nuk është mirë dhe ajo letër nuk ka qenë pjesë e komisionit më herët, por unë kërkoj nga Sekretaria që edhe katër dokumente t'iu shpërndahen deputetëve që të jetë dosja e kompletuar.

Pjesa tjetër, ku përmendet Kodi penal, është thirrje që nuk i shkon për shtati këtij institucioni të lartë, sepse për Kodin penal përkujdeset dikush tjetër, është gjyqësor, është institucion i pavarur. Ata nuk e pyesin Parlamentin hiq kur e dinë se ka probleme me ligjin dhe ata nuk do të duhej ta pyesin askënd kur ka probleme me ligjin. S'ka nevojë ta presin rekomandimin tonë për të bërë diçka. Ka nevojë ta zbatojë të drejtën kushtetuese dhe ligjore që ia njeh ligji.

Këtë rast, unë ju ftoj të jemi të arsyeshëm. Mos të lejojmë që institucionet, çfarë është Parlamenti, të rrëshqasin në trajtimin e problemeve dhe relacioneve private. Nuk dua ta cilësoj, apo ta kategorizoj, por gjithë ata që donë ta dinë saktë se cila është kjo rrëshqitje që po planifikohet të shkojë dika, ne mund ta diskutojmë. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Haziri! Veç sa për kujtesë, pikat që janë në rend dite procedohen pavarësisht a është Kryeministri këtu apo nuk është, sepse ai ka rendin e ditës dhe këtu ka dy përfaqësues – dy zëvendëskryeministra që unë, konsideroj, e përfaqësojnë në mënyrë të denjë. Më vonë, replikat! Jemi duke i proceduar shefat, Lulzim. Në rregull, një minutë replikë, Lulzim.

LULZIM ZENELI: Faleminderit!

Unë e çmoj angazhimin e zotit Haziri, e kuptoj, por duhet ta keni shumë të qartë një gjë. Në qoftë se Kuvendin e Kosovës e obligon me një letër që e shpreh shqetësimin e vet institucioni i Avokatit të Popullit, nuk ka të bëjë këtu me çështje politike, nuk ka të bëjë me çështje personale. Në qoftë se këtë angazhim të Komisionit parlamentar e mbështet Misioni Monitorues i OSBE-së dhe inkurajon për punën që po bën në monitorimin e zbatimit të ligjshmërisë, atëherë diçka këtu s'është në rregull me ne.

Një gjë duhet ta keni shumë të qartë, këto rekomandime që i ka nxjerrë Komisioni parlamentar, janë më të butat e mundshme. Nëse kjo do të kishte ndodhur në një vend demokratik, besoni se kjo çështje do të alarmohej edhe në përmasa ndërkombëtare. Ajo çka është duke ndodhur në Kosovë, tregon më së miri se sa jemi në të gatshëm ta respektojmë ligjin.

KRYESUESI: Le t'i vazhdohet edhe për një minutë.

LULZIM ZENELI: Kur është fjala për Qeverinë, vetëm edhe një rekomandim shumë të ngushtë, nëse do ta marrë. Nuk krijohet imazhi i Kosovës me veprime ad-hoc. Nuk krijohet imazhi i Kosovës duke lobuar përmes agjencive të caktuara. Imazhi i Kosovës krijohet duke respektuar ligjin dhe ajo çka po ndodh sot në Kosovë, qoftë jo vetëm në Prevallë, por në të gjitha sferat, kjo tregon se Kosova nuk e meriton këtë gjendje. Kjo tregon se Kosova nuk meriton të aspirojë në ato aspirata që i kemi proklamuar deri më tash. Kjo tregon më së miri se ne nuk jemi në gjendje, me këtë qasje çfarë po demonstrojmë, nuk jemi në gjendje dhe nuk jemi të interesuar ta zbatojmë ligjshmërinë. Në emër të Komisionit parlamentar këtë e thashë, asnjëherë si deputet i Grupit Parlamentar. Kaq. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me shefat e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Heset Cakolli.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

Ne sot po debatojmë për gjendjen në parkun nacional "Malet e Sharrit" dhe po e quajmë park nacional në bazë të Ligjit numër 11/86.

Për gjendjen në parkun nacional, Komisioni parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, fillimisht është njoftuar me shkresën nga institucioni i Avokatit të Popullit ku ky institucion shpreh shqetësimin e tij për gjendjen e papranueshme, e cila mbizotëron atje dhe karakterizohet me shkatërrimet masive të resurseve natyrore siç janë: prerjet ilegale të drunjëve, ndërtimi i gurëthyesve në zonën e Parkut Nacional dhe ndërtimet ilegaleve të objekteve turistike.

Në bazë të këtij materiali, Komisioni parlamentar ka organizuar një dëgjim publik, siç e ceku edhe kryetari i Komisionit parlamentar dhe në atë takim është vendosur që Komisioni parlamentar të bëjë një vizitë në terren me qëllim të konstatimit të gjendjes reale atje. Prandaj, Komisioni parlamentar më datën 17.6.2008 fillimisht ka vizituar komunën e Prizrenit, ku janë njoftuar nga kryetari dhe përfaqësuesit e drejtorive përkatëse të komunës së Prizrenit lidhur me gjendjen e përgjithshme në parkun nacional "Malet e Sharrit" e në veçanti për fshatin Prevallë, ku pastaj edhe anëtarët e Komisionit u bindën për shumë parregullsi gjatë vizitës në "Fshatin Turistik" të Prevallës.

Me planin rregullator ka qenë i paraparë ndërtimi i 350 shtëpive turistike në fshatin Prevallë në një hapësirë shumë të vogël, me sipërfaqe 50 deri 70 m² e paraparë sipas projekteve dhe të ndërtuara nga materiali prej drurit, por atje po ndërtohen shtëpi jo turistike me një sipërfaqe diku prej 150 e diku ka edhe deri 300 metra katrorë prej materiali të fortë, që është në kundërshtim me standardet për shtëpitë turistike. Sipas përfaqësuesve të komunës, deri më tani janë dhënë vetëm 38 leje për ndërtim, ku prej tyre

24 janë ndërtuar ose janë në fazën e ndërtimit dhe pothuaj janë ndërtuar duke mos iu përmbajtur projekteve të prezantuara dhe pastaj komuna ka marrë vendim që të mos japë leje tjera për ndërtim deri sa të mos bëhet një plan i ri rregullator, ndërsa atje ishin duke u ndërtuar objekte edhe pa leje ndërtimi, ku komuna e Prizrenit ka marrë masa konkrete për parandalimin e ndërtimeve ilegale. Nga ana tjetër, përfaqësuesi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me rastin e dhënies së pëlqimit për planin rregullues të Prevallës thotë se është mbështetur në kërkesën e kuvendit komunal të Prizrenit, dokumentacionit të ofruar, gjendjes faktike në terren dhe arsyeshmërisë ligjore. Por si duket në mes strukturave udhëheqëse të komunës së Prizrenit dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk ka pasur dhe ende nuk ka një bashkëpunim të duhur lidhur me këtë çështje për të cilën po debatohet sot. Prandaj, unë mendoj se duhet të zbatohet: Ligji për mbrojtjen e natyrës, Ligji për planifikimin hapësinor dhe Ligji për parkun nacional “Malet e Sharrit”, kështu që tani i mbetet Qeverisë për pengimin e të gjitha aktiviteteve të kundërligjshme, nëse ekzistojnë atje ato, në kuadër të hapësirës së parkut nacional.

Dhe, krejt në fund, ne si Grup Parlamentar, pajtohem me propozimet e Komisionit funksional me atë që i janë dërguar katër pika të veçanta Qeverisë. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet Cakolli. Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini, kryetar i Grupit.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zëvendëskryeminsitra, ministra,

Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,

Ne, si Grup Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i kemi disa dilema, të cilat unë do t'i shpalos, dilema që i kam edhe unë dhe aq më tepër e kam një obligim t'i jap disa shpjegime për shkak se vendimet janë marrë në kohën kur unë kam qenë ministër i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, e ka pasur mundësinë të më pyes, nuk e ka shfrytëzuar atë mundësi, pra do ta kishte pasur shumë më të qartë sikur dikush prej nesh t'i kishte treguar se cilat janë arsyet dhe në çfarë rruge ligjore janë marrë vendimet.

Një pjesë të madhe, që pata në plan ta them, e tha zoti Haziri. Nuk do ta përsëris, dhe, do të tentoj të mos e përsëris.

Fillimisht letra është marrë prej Ombduspersonit dhe është “Ombudsperson” e jo “Ombdusperson” që, qe dhjetë vjet, një fjalë duhet mësuar më, fundi i fundit – “Ombudsperson”, zoti Zeneli.

Çështja është kështu. Dikush e përmendi, tha, atje po bëhet biznes. Pse po e përmendni fjalën biznes në pezhorativ. Bëhet biznes gjithkund. Biznes është, është e vërtetë se është biznes dhe i keni nga dhjetë pronarë të njëjtë të tokave për shkak se është tokë e tyre, e cila në bazë të planit është parcializuar dhe ata e shesin tokën. Është shumë e qartë. Është biznes. Realisht, është biznes dhe është mirë që është biznes.

Një çështje tjetër, për të cilën duhet të flasim, është se këtu u përmend ligji shumë shpesh. E përmendi edhe zoti Haziri. Nëse komisioni thotë që është shkelur ligji, pse nuk na ka sjellë vendimin për të cilin po flet. Merreni materialin, të cilin e keni. Shikoni a është vendimi i Ministrisë, i cili vendim thotë në bazë të këtij ligji, të këtij neni 1,2,3 dhe

vazhdon më tutje, pse nuk është ai vendim? Tani, askush nuk po thotë që, ndoshta, mund të gjejë në tjetër dikush, por vetë fakti se nuk është dokumenti për ne, për secilin prej nesh, na bën të dyshojmë se diçka nuk është në rregull me këtë vendim të kësaj çështjeje. Domethënë, këtë e përmenda vetëm për dokumentet. Ka shumë dokumente tjera, të cilat nuk i janë bashkëngjitur të qarta materialit, të cilin e keni marrë ju, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe, në fakt, keni marrë shumë fotografi, të cilat nuk shihen, është joserioze.

Tani, krejt kohën flet për ligjin, kryetari i Komisionit për Bujqësi dhe unë nuk e di a ka folur si kryetar i Komisionit apo si shef i Grupit Parlamentar, sepse për krejt çka ka folur nuk janë në material. Njëqind nene i përmendi, njëqind shkelje të ligjit. Asnjë prej fjalëve që i tha nuk janë në material. Domethënë, ky ka bërë studim, me siguri, si deputet edhe si kryetar i Grupit Parlamentar ka të drejtë të bëjë studim dhe duhet të bëjë studim, por e ka bërë jashtë komisionit, sepse komisioni nuk na ka sjellë me material ato që i ka thënë kryetari i Komisionit. Përmenden fjalë, për shembull “rezervat strikt” dhe në krejt kohën thirret në ligj. Nuk ka kesi termi ligjor. Nuk ka “rezervat strikt”. Le të ma gjejë dikush se çka është rezervati strikt në ligj? A po flasim për ligj. Nëse flasim me ligj, gjene, ju lutem, ta shohim.

Është një letër tjetër, e cila na vjen neve prej shefit të OSBE-së, letër që na vjen sot, prej një shefi që ka shkuar para shumë kohe. Është shumë indikative, është shumë interesante. Dhe, përmendet një takim, për të cilin unë do t’ju flas, sepse kam obligim t’ju flas për atë takim, i cili është mbajtur. Por, para se t’ju flas për atë, në këtë letër thuhet “shpronësim”. Ka problem me shpronësimin. Avokati i Popullit, e ka dërguar një letër për shkak të kërkesave të banorëve vendas, kryesisht të komunitetit goran – boshnjak dhe serb të Sredskës, më poshtë dhe ata janë ankuar për shpronësim. Më vonë është kuptuar se nuk ka shpronësim, sepse pronat janë private. Mirëpo kjo letër përsëritet. Kjo është një letër e cila është përsëritur me shumë pak ndryshime që një vit e gjysmë dhe askund në këtë letër nuk thotë askush cili ligj është shkelur. Vetëm thotë ka dyshime se mund të ketë shkelje të ligjit. Nëse OSBE-së nuk i kanë mjaftuar dy vjet me konstatuar cilat janë ato shkelje të ligjit, pse na vjen këso letrë e panënshkruar, pa asnjë nënshkrim, në emër të ambasadorit Tim Guldman, i cili ka shkuar sot. Kush e ka sjellë këtë letër sot këtu, nëse ka mundësi Administrata e Kuvendit të na tregoj neve? Kush e ka sjellë këtë letër sot këtu? Tani, cili është shpronësimi?

Kjo është rrenë dhe nëse një dokument zyrtar ka rrenë, qysh mund ne t’i besojmë? Qysh mund Kuvendi ta obligojë Qeverinë e Kosovës të marrë këso vendime kur gjysmën e dokumenteve i ka gjysmë fallce?

Çështja tjetër. Mendoj se për goditje të vogla po sillet Kuvendi në pozitë shumë të keqe. Ju thashë se do ta shpjegoj atë bisedë të datës 15 mars. Një zyrtar i lartë i OSBE-së, në atë kohë, i cili nuk është më këtu, ka ardhur te unë në zyrë dhe ka kërkuar që ta suspendoj vendimin. Edhe unë i kam kërkuar që të m’i sjellë argumentet ligjore pse duhet të suspendohet vendimi dhe definitivisht unë e suspendoj vendimin? Ka thënë do t’ju sjellim në të ardhmen, por ju sot suspendoni vendimin. Edhe unë definitivisht i kam thënë jo, nuk do ta suspendoj vendimin. Ka instanca tjera të cilat mund ta suspendojnë vendimin tim, është, shembull ta marrim, në atë kohë – Përfaqësuesi Special. Referojuni Përfaqësuesit Special dhe e anulojmë vendimin. Nuk i janë referuar! A e dini pse? Për shkak se atë ditë më ka thënë, janë ankuar pakicat dhe duhet të ndalen punimet. Unë i kam thënë, a janë konform ligjit? I ngritë krahët! A po ju cenohen të drejtat pakicave? I ngritë krahët! Thotë: po janë ankuar! Edhe unë i them kështu: Shikoni, unë jam ministër i Mjedisit, në atë kohë. Në Kosovë ekzistojnë disa zona malore turistike. Një prej tyre

është Brezovica, për popullatën shumicë, është e mbyllur, po ju tregoj. Një zonë tjetër, është Boga, për shembull, ose Bjeshkët e Nemuna, të cilat ky Kuvend nuk ka pranuar t'i shpallë park nacional, një kohë, ku duhet të kalohet kah Patrikana e Pejës dhe mund t'ju them se seriozisht është e ngushtuar mundësia që dikush të bëjë biznes, të ketë edhe shpi, pse jo, në mal. Nuk jemi ne komunistë! Zona e tretë është, shembull ta marrim Shala e Bajgores, e cila, po ashtu, gjysmë e mbyllur, për shkak të problemeve në Veri. Dhe, zona e katërt, është Prevalla, e cila tani po mbyllet për shkak se dikush është ankuar. Nuk është ndershëm dhe nuk është ferr se dikush mundet të pyes: po a kanë të drejtë shqiptarët ta kenë një shtëpizë pushimi në mal? Ata që kanë, normal se gjithmonë, në gjithë botën ka njerëz që kanë e që s'kanë. Bile edhe në vende komuniste ka pasur asi që kanë e që s'kanë. A kemi të drejtë ne, a nuk kemi? Nëse kemi të drejtë, cili është problemi ynë atëherë. Pse dikush po tenton ta detyrojë Qeverinë e Kosovës t'i anulojë vendimet e ligjshme të Kuvendit Komunal dhe të Ministrisë atëherë, në mënyrë që njerëzit, të cilët në bazë të ligjit kanë ble prona, t'i drejtohen gjykatës dhe të kenë probleme me gjykata, sepse ata njerëz kur kanë ble pronë kanë pyetur a ka plan – ka plan; a jepet leje – jepet leje. Kanë vendosur ta blejnë pronën.

Dhe, e fundit, që është shumë indikative, është pse po bëhen bashkë shumë tema? Shembull ta marrim, në rekomandim thuhet: prerja e pyjeve duhet të ndalet. Shumë në rregull – duhet të ndalet. Pse nuk është ndalur deri tash? Pse s po pyet dikush – pse nuk është ndalë prerja e pyjeve deri tash. Duhet të ndalen gurëthyesit dhe shfrytëzimi i zhavorrit! Absolutisht! Pse nuk po ndalet? Cila është arsyeja që nuk po ndalet? Po në të njëjtën kohë me këto dy veprimtari tërësisht ilegale, plotësisht ilegale, futet edhe një veprimtari e cila është legale. Është plotësisht legale, kamuflohet bashkë me dy ilegale dhe tani çka do të bëjmë ne: të marrim vendim në paket, këto janë gjëra të ndara. Vetë kryetari i Komisionit tha janë çështje e ndryshme. Po janë të ndryshme. Dhe, nëse janë të ndryshme, pse janë bërë bashkë. Pse po bëhen bashkë, nëse janë të ndryshme? Duhet të debatohet dhe është çështje e shijes. Dikujt i pëlqen të ketë kampshtëpiza e dikujt nuk i pëlqen.

Çështja tjetër. Mos të manipulohet me fakte, le të bien dokumentet, se aty thotë cila është zona e parë, cila e dytë, cila e tretë, e mos të na thotë dikush këtu, është në zonën e dytë. Merrni dokumentet ju lutem, merrni hartat se ekzistojnë. Dikur ekspertët ligjorë të Ministrisë së Mjedisit i kanë marrë ato vendime. Ministri nuk i nënshkruan. Ministri e jep vullnetin politik që në atë vend duhet të ndërtohen, se po besoj se duhet. Kuvendi komunal beson se duhet dhe ia jep të drejtën vendit të ndërtojë dhe mendoj se ministri i Mjedisit duhet të tregojë se vetë institucioni, të cilin e udhëheq, i ka marrë këto vendime. Ai institucion, njerëzit që punojnë në atë institucion kanë ardhur deri te vendimet për të cilat diskutojmë sot.

Përfundimisht, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës mendon se këto janë çështje të ndara: prerja ilegale e pyjeve, eksploatimi i zhavorrit dhe i gurëve dhe "Fshati Turistik" në Prevallë janë çështje të ndara. Duhet të diskutohen ndarazi, por mendojmë se Kuvendi i Kosovës, jo vetëm se nuk guxon t'i bëjë bashkë, por duhet të shikojë pak çka ka në komunën e Prizrenit, cilat janë vendimet që janë marrë më parë, të konsultohet pak me ish-kryetarin e komunës së Prizrenit, të konsultohet me ish-ministrin – e të na thirr dhe, përfundimisht, po e përsëris se, është shkelje t'ia bashkëngjes materialit që na ka sjellë të gjitha dokumentet, se edhe në ato dokumente ka nene të cilat thonë në bazë të këtij ligji, në bazë të këtij neni. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit! Unë do të marrë fjalën për disa sqarime.

Të nderuar deputetë, letra që ka ardhur sot dhe e kemi dorëzuar sot, e shefit të shkuar të OSBE-së, ka ardhur para disa ditësh, që unë kam pasur një takim lamtumirës me shefin e shkuar të OSBE-së dhe kërkesa ka qenë që këtë letër t'ua dorëzojmë deputetëve. Unë, ndoshta, jam vonuar pak, por e kemi parë të arsyeshme këtë letër ta kenë deputetët dhe është në origjinal në gjuhën angleze dhe e nënshkruar.

Mendoj se kjo është një çështje e ndërlikuar. Për këtë do t'i them disa çështje. Është duke u përpjekur dikush që kësaj çështjeje t'i japë karakter politik që, mendoj, nuk e ka karakterin politik dhe nuk duhet t'i jepet karakteri politik. Është një çështje thjeshtë tjetër, domethënë mund ta ketë edhe karakterin e biznesit dhe shoqëria në të cilën jemi është shoqëri e tregut të lirë dhe edhe biznesi është i lejuar dhe mund të zhvillohet. Krejt çështja, mendoj, në Kuvend duhet të shtrohet se a janë zhvilluar procedurat e deritashme mbi bazën e ligjeve apo janë të kundërligjshme? Mendoj se i gjithë debati duhet të bëhet për këtë: a janë të ligjshme procedurat apo janë të paligjshme duke hequr pra çështjen politike?

Unë do t'i them edhe vetëm disa fjalë për rekomandimet. Rekomandimet, pesë rekomandimet e para, me rekomandimin e gjashtë bien ndesh dhe ndoshta, kjo çështje për t'u trajtuar më mirë nga Kuvendi, do të ishte mirë të hiqen rekomandimet e para, të mbetet rekomandimi i gjashtë – formimi i Komisionit hetimor për të hetuar dhe hulumtuar çështjen mbi bazën e dokumenteve e të procedurave dhe të vijë me një raport se a janë zhvilluar procedurat mbi bazën e ligjit, a janë të kundërligjshme dhe cilat duhet të jenë masat që duhet ndërmarrë Kuvendi dhe çka duhet Kuvendi t'i rekomandojë Qeverisë?

Unë mendoj se duhet këtë ta reduktojmë në një kërkesë dhe në kërkesën për formimin e Komisionit hetimor. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit! Vazhdojmë me Grupin Kuvendor të LDD-së. Fjalën e ka kërkuar deputeti Naser Rugova.

Të nderuar kolegë

Kabinet qeveritar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar me vëmendje edhe punën, por edhe rekomandimet e bëra nga Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Gjithsesi, Kryetari i Kuvendit e sqaroi që shkresa e ardhur nga shefi i Misionit të OSBE-së ka ardhur me kohë, do të thotë, para dy javësh pothuaj se dhe është proceduar sot. Ky është faji i administratës, do të thotë në këtë kontekst, Komisioni parlamentar dhe kryetari i Komisionit kanë proceduar konform Rregullores së Punës të Kuvendit dhe këtu dilema nuk ka.

Gjithsesi, u fol shumë për ligjshmërinë dhe a po zbatohet ligjshmëria - a po respektohen procedurat? Ju lutem, në qoftë se i lexojmë me vëmendje Ligjin për mbrojtjen e natyrës, për Planifikimin hapësinor dhe legjisllacionin tjetër në fuqi aktual, realisht – shihet se ka shkelje flagrante të këtij legjisllacioni në fuqi dhe është fat që të gjithë deputetët dinë të lexojnë dhe të kuptojnë dhe është e qartë, përkundër që dikush me arsye apo edhe pa arsye po tenton që këtij Parlamenti dhe qytetarëve t'i shesë mjegull. Por, të gjitha këto dhe në fuqizim të kësaj që unë po e them në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së

shkon edhe shkresa e Ombudspesonit. Vetëm një citat. Dispozita e nenit 23.2 të Ligjit për mbrojtjen e natyrës, në pjesën përkatëse, thotë: “Parku Nacional shpallet nga Kuvendi i Kosovës”. Më tutje, në neni 36.2 të këtij ligji, është paraparë se “pas nxjerrjes së aktit për shpalljen e zonës së mbrojtur të natyrës, nxirret plani i posaçëm i menaxhimit për secilën zonë nga organi që e ka vënë nën mbrojtje.”. Dhe, asnjë të drejtë ligjore nuk e ka pasur Kuvendi Komunal i Prizrenit në atë kohë që, thjesht, të fillojë hapa të planit urbanistik pa ekzistuar plani i rregullimit hapësinor. Në këtë kuptim, materiali që na ka ardhur tani nga Komisioni parlamentar, thjesht nuk është siç po pretendohet këtu – material i një grupi parlamentar apo nuk ka kurrfarë tendence. Ka tendencë të monitorimit të zbatimit të ligjshmërisë apo, pse jo, të shkeljes dhe moszbatimit të kësaj ligjshmërie. Është fat që ai Komision nuk përbëhet nga një deputet, as nga një grup parlamentar, por përbëhet nga të gjitha grupet parlamentare këtu dhe në një transkript të një takimi të mbajtur të një dëgjimi publik, me përfaqësues edhe të Kuvendit Komunal të Prizrenit, këtu kishin diskutuar edhe deputetët nga partia që ngritën shqetësim që kjo çështje të shtyhet. Ka ardhur në procedurë të rregullt, e ka miratuar Kryesia e Kuvendit dhe ne jemi tani duke e diskutuar dhe duhet thjesht t’i njoftojmë qytetarët për një problem që është ngritur tani e disa vite në Kosovë.

Në këtë kuptim, edhe letra e shefit të Misionit të OSBE-së është në përputhje të plotë me vërejtjet e Ombudspersonit. Shkas për letrën e Ombudspersonit nuk ka qenë as Kuvendi Komunal i Prizrenit dhe as njerëz të tjerë – palët në konflikt nëse mund t’i quajmë, por ka qenë ankesa e punëtorëve të Parkut Nacional Malet e Sharrit, të cilët kanë shprehur zhgënjimin e tyre me degradimin masiv të një nga perlat e pasurive natyrore të Republikës së Kosovës. Dhe, kjo nuk do koment.

Raporti i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor të Komunës së Prizrenit vë në pah shkelje flagrante edhe të ligjeve, edhe të procedurave, edhe të lejeve të ndërtimit, edhe të planit urbanistik. Dihet kush ka qenë në atë kohë kryetar i Prizrenit, kush e ka menaxhuar, kush i ka lejuar ato procedura dhe kush i ka bërë shkeljet e tri ligjeve që i ceka më parë? Përgjegjësitë janë të adresuara, kanë emër e mbiemër dhe nëse e shikojmë tani dokumentin tjetër, lejet e ndërtimit të objekteve në pushimore domethënë, në zonën e Prevallës, të parkut nacional “Malet e Sharrit”, shohim se i pari, lejen e ka marrë Sahit Ukaj, ish- drejtor komunal në kohën kur kryetar i komunës së Prizrenit ka qenë një anëtar i Kryesisë të Parlamentit të Republikës së Kosovës, pastaj 8 prona- 8 leje ndërtimi i ka Hasan Kabashi, që deputetët e Prizrenit dhe plot njerëz të tjerë e njohin, është mik i ish-kryetarit të Kuvendit Komunal të Prizrenit, pastaj janë edhe dy-tri grupe tjera të lejeve ku në një emër janë 7 ose 8 leje ndërtimi. Dhe, ju lutem, këtë nuk e ka bërë Grupi Parlamentar i LDD-së, as nuk e ka bërë një iniciativë qytetare as një OJQ, por është dokument zyrtar i Drejtoratit për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor të Komunës së Prizrenit, që tani udhëhiqet nga PDK-ja, nga partneri i koalicionit të ish-kryetarit të Prizrenit. Dhe, këtu çdo gjë, po besoj, është e qartë.

Duke i marrë parasysh të gjitha këto, zoti ministër Jagcillar, ju si një qytetar i Prizrenit, si një njeri që keni kontribuar këto vite të pasluftës edhe si deputet, po edhe si politikan, ju e dini fare mirë se kush i ka fajet dhe çfarë masash duhet të ndërmerreni dhe besoj që edhe të gjithë deputetët këtu po edhe Kabineti qeveritar e kanë të qartë.

Edhe pse dikush përmendi edhe terminologji, që mbase nuk i takojnë nga lëmia ose s’i kupton, e kemi vetëm gjysmë faqe të programit qeveritar për mjedis dhe planifikim hapësinor. Kaq do të thotë, edhe pse bota po shkon kah globalizmi dhe po investon mjete të konsiderueshme për mbrojtjen e mjedisit jetësor, për mbrojtjen e ambientit, Qeveria

jonë në prag të përfundimit të dekadës së parë të shekullit 21, ka paraparë që një gjysmë fate që merret me këtë gjë. Qeveria do të përgatis, po citoj: “kornizën ligjore dhe në rrafshin implementues do t’i inkorporojë dhe zbatojë normat ndërkombëtare”. Këtu, po i shkelin vetë qeveritarët, edhe ligjet aktuale, por edhe normat ndërkombëtare. Do të thotë, partnerët e koalicionit qeverisës, në këtë rast, janë duke e bërë të kundërtën. Po citoj pjesë të programit të Qeverisë: “Qeveria do të inkurajoj zhvillimin e fushatave të ndërgjegjësimit me qëllim të mbrojtjes së mjedisit”. Po shihet mirë se si zyrtarë të lartë të partnerëve të koalicionit qeveritar po e bëjnë ndërgjegjësimin dhe çfarë shembulli po iu japin qytetarëve që, në fund të fundit, edhe i kanë sjell në këtë Parlament.

“Ruajtja dhe menaxhimi efikas i zonave të mbrojtura, me vlera të larta të biodiversitetit, rezervatet strikte, parqet kombëtare e të tjera.”. Kështu shkruan në programin e Qeverisë së Kosovës, i cili kishte ardhur pas nja 4 muajve në këtë Parlament.

Në vend se t’i kryejnë detyrat dhe obligimet e tyre kushtetuese, zyrtarë dhe anëtarë të Qeverisë janë akterë të shkatërrimit të pasurive me vlera të larta kombëtare, duke shkelur ligjet dhe duke bërë dëmtimet direkte për përfitime personale dhe këto po i tregojnë faktet dhe letrat, dokumentacioni që e kemi përpara.

Të gjitha aktivitetet që janë zhvilluar dhe po zhvillohen në parkun nacional “Malet e Sharrit”, janë në kundërshtim të plotë me legjislacionin aktual në fuqi që, fatkeqësisht, këto ligje janë shkelur dhe po shkelen edhe sot dhe po tentohet edhe sot që të vazhdohet mos ligjshmëria dhe shkelja e ligjeve. Kjo është porosi e keqe për qytetarët, po edhe për investitorët potencial, sepse u përmend këtu shumë për biznesin. Sigurisht se nga parqet nacionale, nga pikat turistike dhe nga pasuritë tjera kombëtare të garantuara edhe me ligje edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës duhet të përfitojë edhe buxheti komunal, por edhe buxheti i shtetit të Kosovës.

Shembulli më i keq i degradimit të mjedisit dhe të shkatërrimit të pasurive natyrore në parkun nacional “Malet e Sharrit”, është “Fshati Turistik” në Prevallë. Dihet kushtet, kriteret dhe specifikat edhe pse të një plani urbanistik të paligjshëm. Fatkeqësisht, ato janë shkelur nga vetë zyrtarët që ndodhen në këtë Parlament. Mos të harrojmë se është degraduar dhe Prevallë është shndërruar në një kantier të ndërtimeve të ndërtimtarisë së vrazhdët, e kanë përfshirë ujërat e zeza dhe është shndërruar në një deponi mbeturinash. Pra, dikush është përgjegjës, dihen përgjegjësit, kanë adresë edhe të subjekteve politike, po kanë edhe emër e mbiemër.

Me ato 38 leje ndërtimi që janë dhënë në “Fshatin Turistik” në Prevallë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Besoj se ju të LDD-së e keni shfrytëzuar kohën mirë sot. Regjia, vazhdojani edhe një minutë.

NASER RUGOVA: Në fshatin turistik, në ato vila luksoze me nga 150 deri 300 m², me gurë, beton dhe hekur, janë dy anëtarë të Kryesisë të Parlamentit që kanë vilë atje, duke filluar prej kreut të shtetit të kamufluar në emra të biznesmenëve atje dhe këtë qytetarë e Kosovës e dinë. Kur u pat djegur ndërtesa e Kuvendit Komunal në Prizren, rastësisht, si për ironi, u pat djegur vetëm pjesa e Drejtoratit për Kadastër dhe Pronë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sipas radhës e ka fjalën shefi i Grupit të SLS-së. A është lajmëruar Bojan Stojanoviqi? Fjalën e ka deputeti Bojan Stojanoviq.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, poštovani predsjedavajući!

Vladin kabinetu,

Poštovane kolege poslanici,

Samostalna liberalna stranka je razmatrala preporuke Komisije i Samostalna liberalna stranka će svakako podržati preporuke Komisije. I što više slušam priču onih koji smatraju da nije dobro da se trenutno preduzmu mere vezano za nacionalni park, sve sam ubedjeniji da je to potrebno što hitnije uraditi. Naravno, 6 meseci ili 9 meseci, koliko ovde stoji da se preduzmu određene mere, jesu jedan dugoročan period možda za nekog tamo ko gradi. Medjutim, uništenjem prirode dobićemo jednu sliku da više niko neće moći u budućim generacijama da pravi niti vile niti vikendice ni u šumama niti bilo gde drugo. Naravno, čuli smo puno objašnjenja. Ne bih jako puno da dužim, obraćamo se građanima i građani ovo sve slušaju, i svi oni koji su prošli tamo pored Prevalca ili uopšte bili u nacionalnom parku vide da to nije dobro, jer svi ti ljudi imaju oči i znaju da prepoznaju o čemu se radi. Možda ćemo izgubiti neki period, možda će neko izgubiti lični interes, ali ja mislim da lični interesi ne mogu da budu iznad interesa svih. Još jednom ponavljam, mi ćemo podržati ovaj predlog i glasati da se usvoje ove mere. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Sipas radhës, e ka fjalën shefi i Grupit Parlamentar, ose në emër të Grupit Parlamentar ”7+” deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Gospodine predsedniči!

Gospodo zamenici premijera, minsitri,

Kolege,

Evo, ja ću onu opasku malopredjašnju predsednika Skupštine, da unapred shvati da ne želim, ako se mislilo da neko i politizira sa ovim problemom, ja evo unapred kažem da ne želim da politiziram nimalo i nijednog momenta neću pomenuti ime manjina, jer sam ravnopravan građanin, pripadam zajednici koja je ravnopravan u ovoj državi i predstavnik sam u Parlamentu u tri mandata i nikada nisam osetio da sam na neki način obespravljen.

Hoću da kažem da krenem od jedne opaske. Izgleda da je jedan od prethodnih diskutanata pitao, - pa gde ćemo mi predstavnici većinske zajednice da pravimo ili gde možemo da napravimo jednu kućicu za odmor? Ja samo ovde dodajem drugu opasku, može da se napravi kućica za odmor u okviru nacionalnog parka ali samo zavisi od kakvog materijala. Ovde je u pitanje koji je materijal upotrebljen da bi se sagradile sve te kućice.

Nego, da krenem ja sa mojom diskusijom, da je nakon poduže vremena i procedure evo ova, ja bih rekao, vruća tema Prevalac, ponovo je došla na skupštinsku debatu i da je kosovska javnost sigurno sa velikim interesovanjem prati ovo naše izlaganje i mislim da zrelost ovog zakonodavnog organa polažemo danas i u vremenu koje je iza nas i ja zahvaljujem i Komisiji za poljoprivredu i Ombudspersonu koji su inicirali i doprineli da do ove debate dodje.

Donošenjem odluke o izgradnji „Turističkog sela“ na Prevalcu, gospodo, prekršen je niz zakona koji uređuju ovu oblast, kao i međunarodnih konvencija, kao što su Zakon o nacionalnom parku „Šar Planina“, Zakon o zaštiti prirode i sredine, Zakon o prostornom planiranju, Zakon protiv korupcije, Zakon o krivičnom postupku, i da ne pominjem

konvencije. Ako smo zakonodavno društvo, ako jesmo država zakonodavna, ne treba da preskačemo ove zakone.

Ja ne upirem prst ni u koga danas ovde. Mi moramo da priznamo da je napravljena greška, možda nije bilo namere u tome, zle namere, i treba neko nekada danas da kaže, možda smo napravili greške i kako da se iz njih izvučemo. Gospodo, ovaj projekat je izradjen od strane Skupštine opštine Prizren 2006.godine, a njegova implementacija je počela 2007.godine. On predviđa izgradnju 360 objekata. Potpuno, time se stiže do potpunog uništenja prirode na 17 hektara, što odgovara površini od 24 fudbalska stadiona. Za malo Kosovo, po površini, ovo nije mala površina, gospodo.

Ja ću, takodje, ovom prilikom reći da se ovim planom uništava i flora i fauna, ali i prirodna ravnoteža i šumski eko-sistemi. Mi živimo u godinama kada čitav svet diže ili povlači crvenu crtu i pali crveno svetlo za zaštitu svoje sredine. Ako mislimo da živimo na ovim prostorima, mi moramo da se suočimo sa ovim čemu sami doprinosimo. Gospodo, pravo na eksproprijaciju zemljišta, koje je i javne i privatne svojine, jeste isključivo u kompetenciji Skupštine Republike Kosova i Vlade Republike Kosova, pogotovo što nacionalni park „Šar Planina“ prostire na više opština. Ne može jedna opština ispred drugih opština nešto da radi. Tu su Vlada i Skupština Kosova, koje mogu samo ovakve..., prema Parlamentarnoj grupi „7+“ i prema Koaliciji Vakati koji smo analizirali sve ovo. Nacionalni park, dakle, nije lokalno, nego centralno pitanje i takvim ga danas smatramo.

Gradjani regije Župe, gde se i sam Prevalac nalazi, su od početka izražavali svoje nezadovoljstvo, ali nisu imali snage da zaustave proces realizacije ovog projekta, gospodo.

Ja ću vam reći, gospodo, da dolazim iz sredine gde se nalazi regija Prevalac. Iako smo od samog početka realizacije ovog projekta dali podršku gradjanima, delili njihovu zabrinutost, obavestili i više institucije, nismo mogli da skinemo sa sebe i odgovornost i etikete koje su nam gradjani upućivali da i sami učestvujemo u svemu ovome. Mi smo morali i na prošloj debati da se branimo i da ja ovde izjavljujem kada je gospodin Berisha bio predsednik, da ja nemam plac niti moje kolege iz Grupe „7+“ nemamo placeve i ne želimo da ih imamo na Prevalcu. Ja sam morao ovu govornicu da iskoristim, jer ne mogu doći u svojoj sredini, pružaju prst u mene i ti učestvuješ u ovome, i ti, i ti... Ja, evo ponovo ponavljam, mi ne učestvujemo ovde iz ove grupacije. Ne učestvujemo u izgradnji ovoga i to ponovo ponavljam, mislim da će biti dovoljno za našu sredinu. Ja ću vam takodje ovde reći da smo naišli na odobravanje prethodnog ministra koji je u dva navrata posetio sredinu u kojoj živimo. I sada pominjati gradjane koji se nisu žalili, ja ću vam reći da je to ruralna sredina i da tu nema eksperata pravnih advokata i tako dalje. Svakome kome mu donesete papir sa pečatom, ukoliko se suprostavi, on misli da vrši neku radnju protiv zakona i tako dalje. Mi spadamo u integrisani deo zajednice Kosova i mi ovo ne politizujemo, nego ove tražimo da svi shvatimo da je to deo Kosova i da svi treba da zaštitimo tu blagodat u drugom gradu po veličini na Kosovu koje je bilo omiljeno izletišta a što danas više nije. Mi možemo danas da se pravdamo, možemo da se branimo kako ko može i zna, ali niko ne može da kaže i da dokaže da tamo nije nastalo ruglo. Gospodo, nastalo je ruglo i tamo u ovoj sredini žive i Srbi, u najmanjem broju, i Albanci, i u najvećem broju Bošnjaci, ne Goranci. Mislim ovo ne želim da...

E sad, šta na kraju još da kažem. Mi, gospodo, ćemo sve ovo, podržavajući preporuke Komisije, podržaćemo sve ali i očekujemo od Vlade i od Skupštine da svi zajedno

shvatimo ozbiljnost ovoga. Ovde je zaista jedan veliki test ozbiljnosti, zrelosti i zakonodavne zrelosti države Kosova, i ja apelujem na sve da samo tako shvate ovaj problem. Hala vam ljepa!

KRYETARI: Faleminderit! Shefat e grupeve parlamentare, mendoj që i kryen fjalët e tyre. Kërkesa është për pauzë. Atëherë, shkojmë në pauzë deri në orën 15,30, e pastaj vazhdojmë debatin.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI I KUVENDIT: Po vazhdojmë debatin. Fjalën e ka kërkuar ministri i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari, Kryetar!

I nderuari, Kryeministër dhe ministra,

Të nderuar deputetë,

Më 2 korrik 2008, në adresë të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, janë dërguar rekomandimet lidhur me shkresën e Avokatit të Popullit të Kosovës, numër 211/2008, të datës 6 qershor 2008.

Në këtë aspekt, ndoshta, do të duhej dhënë një përgjigje ose për një analizë aktivitetesh në zonën e Parkut Nacional Malet e Sharrit, mund të them se në periferi të Parkut, sepse ende nuk ekzistojnë saktë kufijtë e Parkut Nacional. Ne jemi në vazhdë e sipër për realizimin e Planit hapësinor ku do të caktohen saktë edhe kufijtë e Parkut Nacional, ushtrojnë aktivitetet dy gurëthyes në fshatin Mushitisht, komuna e Suharekës – Ndërmarrja “Vëllezërit e bashkuar”, e cila është e pajisur me pëlqim mjedisor, lëshuar nga Ministria, dhe në Mushnikovë, ndërmarrja “Dilo” ose “Demo-Kompani”, komuna e Prizrenit, e cila nuk ka pëlqim mjedisor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ose në vitin 2004 ishte tërhequr vendimi për operimin e kësaj firme, për të cilën është dashur, gjithashtu, edhe komuna të marrë masa për punimet jo legale.

Aktivitetet ndërtimore në “Fshatin Turistik” në Prevallë janë se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor më datën 4 shtator 2006 ka marrë vendim me të cilin ishte aprovuar kërkesa e Kuvendit Komunal të Prizrenit për pëlqim për planin rregullativ të Prevallës. Pëlqimi jepet me kushte të cilat janë të parapara me Ligjin për planifikimin hapësinor, nenet 12, 15, 17, 24, Ligjin e mjedisit, nenet 8 dhe 9 dhe Ligjin për mbrojtjen e natyrës, neni 10.

Duke u bazuar në këtë pëlqim, Kuvendi Komunal i Prizrenit, ka lëshuar lejen ndërtimore për ndërtimin e objekteve pushimore në zonën e Prevallës ose në parkun nacional “Malet e Sharrit”.

Kuvendi Komunal ka lëshuar 38 leje ndërtimore, prej të cilave 24 janë ndërtuar ose janë në ndërtim e sipër. Nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është formuar një Grup punues për vlerësimin e gjendjes në Prevallë dhe kanë dorëzuar një raport në të cilin shpjegohet gjendja faktike në terren. Në këtë raport thuhet se ndërtimet e bëra deri më tani posedojnë leje ndërtimi, mirëpo, gjatë ndërtimit nuk janë respektuar kriteret e dhëna me leje dhe me plan rregullues. Në këtë rast nuk janë respektuar vija rregullative,

gavariti, etazhiteti dhe materiali ashtu sikur që janë paraparë me plan rregullues. Përkohësisht ishte ndërprerë dhënia e lejeve për ndërtim.

Më 25 qershor 2008, Drejtoria e Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor të Prizrenit, me një kërkesë iu ka drejtuar Ministrisë për revidimin e planit të përkohshëm rregullues urban të zonës së Prevallës. Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, respektivisht Departamenti për Planifikim Hapësinor dhe Instituti i Planifikimit Hapësinor janë duke punuar në hartimin e planit hapësinor për zonën e veçantë Parku Nacional Malet e Sharrit, kështu që deri sa ta përfundojë punën, Grupi për hartimin e planit hapësinor nuk do të marrë kurrfarë vendimi. Në Bordin e drejtorëve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit është marrë vendim për rishikimin apo revidimin e planit rregullues ekzistues dhe ndërrimin e emërimit të fshatit turistik dhe ky vendim pritet të miratohet në Asamblenë komunale.

Arsyet për revidimin e këtij plani janë koeficienti i lartë i ndërtimit dhe numri i madh i shtëpive të parapara me planin ekzistues, që rezulton se është jashtë rregullave dhe kritereve që i përkasin një zone të shpallur park nacional.

Prandaj, do të formohet grupi punues i përbërë nga ekspertët e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Kuvendit Komunal të Prizrenit për të shqyrtuar mundësinë për marrjen e një vendimi të përbashkët për revidim të projektit, si dhe do të shqyrtohen të gjitha modalitetet e mundshme, duke iu referuar dispozitave që dalin nga ligjet ekzistuese.

Lidhur me kampingun verior, ky ishte një projekt i përkohshëm, i cili aktualisht menaxhohet ose administrohet nga Kompania private IS-Compani nga Prizreni, e cila ka fituar tenderin për të administruar këtë kamping në shtator të vitit të kaluar. Konsiderojmë se koncentrimi i kampshtëpizave në një vend të caktuar dhe i menaxhuar është një zgjidhje pak sa më e mirë krahasuar me vitet e kaluara, ku këto kampshtëpiza ishin të shpërndara dhe banorët e tyre degradonin mjedisin përreth në të gjitha format. Pastaj, të gjithë banorët ishin të kyçur ilegalisht në rrjetin elektrik, keqpërdornin burimet ujore, kurse tani së paku paguajnë për këto shërbime elementare përmes kësaj kompanie.

Mirëpo, duhet kuptuar se kjo ishte një zgjidhje e përkohshme deri sa nuk dalim me një qëndrim ose vendim përfundimtar, të cilin do ta nxjerrim gjithashtu me përkrahjen e anëtarëve ose ekspertëve nga Grupi punues.

Gjithashtu, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është në vllugun e punëve për hartimin e planit hapësinor të parkut nacional “Malet e Sharrit”. Planifikohet që deri në fund të tetorit të përfundojë drafti i parë i planit hapësinor, i cili pastaj do të jetë objekt debati në debatet publike me qytetarët dhe me komunitetet, dhe plotësimi e korrigjimi, para se të dërgohet në Kuvend për miratim, sepse kërkohet sipas ligjit.

Me definimin e kufirit të parkut nacional “Malet e Sharrit”, krijohen kushte për ndalimin e veprimtarive të cilat nuk lejohen të ushtrohen në parqet nacionale. Deri më tani, në Parkun Malet e Sharrit ishte duke u bërë zonimi i cili në mënyrë decitive rregullohen format e aktiviteteve të cilat janë të parapara me ligj. Zonat, sipas ligjit janë:

- Zona e parë, ndalohet çdo aktivitet përveç hulumtimeve shkencore;
- zona e dytë, në të cilën lejohen aktivitete rekreative, sportive dhe pushim aktiv i popullsisë;

- zona e tretë, në të cilën lejohen edhe aktivitete tjera të kufizuara ekonomike, punimi i tokës, ndërtimi i objekteve rekreative, sportive, turistike, hoteliere e tjera.

Për prerjen e pyjeve, ekziston përzierje e kompetencave me Agjencinë e Pyjeve të Kosovës, që ka qenë edhe temë e diskutimit edhe në mandatin e kaluar dhe besoj që së shpejti përmes dy ministrive do të përfundohet edhe kjo mosmarrëveshje, ashtu të themi.

Duke pasur parasysh të gjitha këto aktivitete në vazhdim, të cilat janë duke u ndërmarrë nga Ministria, respektivisht nga Instituti i Planifikimit Hapësinor, që është duke e hartuar planin hapësinor për këtë zonë të veçantë, Drejtoria e parkut nacional “Malet e Sharrit”, e cila merret me menaxhimin e Parkut dhe pengimin e dëmtimeve nga individë të papërgjegjshëm dhe synimi i Ministrisë për hartimin e planit menaxhues për parkun nacional, i cili plan ka një kosto shumë të lartë. Mirëpo, duke shpresuar që edhe përmes buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe përmes donacioneve, kjo punë besojmë do të realizohet.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka parasysh dhe ishte duke u marrë seriozisht edhe me rekomandimet, të cilat do të dalin prej Parlamentit dhe besojmë se bashkërisht do ta zgjidhim këtë problem në mënyrën më të mirë të mundshme.

Në fund, dëshiroj të rikujtoj se parku nacional shtrihet në katër komuna, në Komunën e Prizrenit, të Suharekës, të Kaçanikut dhe të Shtërpçës. Ekziston harmonizimi i qëndrimeve përmes këtyre komunave, por ende kemi probleme me komunën e Shtërpçës, që është për ndonjë debat tjetër.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Fjalën e ka kërkuar deputeti Xhavit Haliti.

XHAVIT HALITI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

I nderuar Kryeministër, ministra,

Shqetësimi për çështjen e ngritur nuk është i sotëm. Ai ka qenë permanent, ka qenë edhe në të kaluarën kur është miratuar Ligji i famshëm i vitit 1986 dhe nuk po e kuptoj pse këtë ligj të kemi nevojë që ta mbrojmë kaq me fanatizëm në vitin 2008. Për vetë faktin se edhe popullata e Kosovës është rritur dhe nevoja për t'i ndryshuar pozitat, t'i quaj, të ndërtuara strategjikisht me një politikë të caktuar, janë domosdoshmëri e kohës. Prandaj, unë nuk do të futem në procedurat e dhënies së lejeve, sepse ato janë kompetencë e pushtetit lokal dhe në qoftë se këtu ka shkelje të ligjit, në qoftë se ka korrupsion, në qoftë se dikush ka të dhëna për këtë, atëherë është mirë që të korruptuarit dhe ata që kanë keqpërdorur dhe kanë shkelur ligjin, dosjet e tyre të përgatiten dhe t'i jepen Prokurorisë dhe jo që Parlamenti të merret kaq gjatë me këtë çështje dhe prapëseprapë nuk e ka fuqinë ligjore dhe s'e ka të ofruar asistencën specialistike, do ta quaja, për të vepruar në këtë drejtim.

Unë konsideroj se jo vetëm zona e Prevallës, por të gjitha zonat dhe në të gjitha qytetet e Kosovës ka shkelje të mëdha ligjore në ndërtim. Bile-bile, këtu po harrojmë ta përmendim që edhe në Brezovicë ka shkelje të mëdha ligjore, ka rritje të shtëpive, ka ndërtime të shtëpive pa leje dhe edhe Brezovica është një zonë e ndaluar ose zonë e mbrojtur ose park nacional, si po e quajmë ne.

Unë jam i shqetësuar për shumëçka, sepse konsideroj që Kosova, si shumë vende të tjera, për shkak se ka bjeshkë shumë, mund të ofrojë turizmin malor dhe mendoj që me një politikë të përkushtuar ne do të krijojmë shumë zona, jo vetëm me Prevallën, të cilat do t'ua ofronim turistëve, jo vetëm vendor, hapësirë për t'i shfrytëzuar bjeshkët e Kosovës – Alpet e Kosovës, dhe mos t'i numërojmë radhazi.

Dhe, pa dashur të futem në sende tjera, prapë po them, nuk e di kush ka shkelur ligjin në Prevallë, por dëgjova që akuza në drejtim të anëtarëve të Kryesisë dhe kreut të shtetit, që nuk më erdhi mirë, jo pse ka akuza, por dihet që kur të flitet me këtë gjuhë, duhet të përmenden emrat kush e ka shkelur ligjin në Pervallë, kush e ka shkelur ligjin në Brezovicë, kush ka shkelur ligjin në Prishtinë dhe kush ka shkelur ligjin, në fund të fundit, në zonën më të afërt të gjelbër të Prishtinës në Gërmi?

Unë, mendoj që Qeveria duhet të mendojë sinqerisht për të shpallur një tender ndërkombëtar për ta bërë urbanizimin e përshtatshëm edhe të Prevallës, edhe të zonave të tjera të Bjeshkëve të Nemuna, të cilat janë shumë të përshtatshme për turizëm malor, me qëllim që t'i krijojmë mundësi edhe atyre që kanë mundësi të investojnë në këto zona dhe donë ta zhvillojnë turizmin, por edhe që ta frenojnë ndërtimin e egër, i cili, përveç se në Prevallë, po ndodh në të gjitha bjeshkët e mira dhe të buta, t'i quajmë ashtu, të Kosovës, tokat e të cilave nuk janë të definuara pronë e kujt janë, sepse palët që po e keqpërdorin po thonë se janë tonat dhe në pronësi- në hipoteka figuron krejt ndryshe.

Prandaj, përveç se dëshiroja t'ju përkujtoja që parqe nacionale janë edhe Davosi në Zvicër, edhe Simeringu në Austri, edhe Cermati në mesin e kufirit Zvicër-Austri edhe Kranji në Slloveni, edhe Mavrova në Maqedoni, edhe Kodra e Diellit ose Popova Shapka në Maqedoni dhe të gjitha janë njëkohësisht edhe zona turistike edhe qendra skijimi. Prandaj, nuk ka diçka të keqe në qoftë se ne mendojmë ta ndërtojmë një qendër të tillë ose të ndërtojmë shumë qendra të tilla.

Shqetësimet për ndërtimet dhe prerjet e pyjeve, guroret pa leje janë me vend, por për mua është shqetësuese edhe gjuetia pa leje dhe gjuetia e cila po i dëmton pasuritë natyrore, kafshët e egra të cilat janë të rralla, por fati ynë është që këto zona të mbrojtura në vendet e Amerikës Latine, në Afrikë, janë kryesisht për luajë, elefantë, tigra, majmunë të racave të ndryshme, dhe ne nuk kemi të tillë në Kosovë, kemi dhi të egra, lepuj, arinj dhe ujë.

Prandaj, në këtë mes unë do të zgjidhja, në vend të zonave të mbrojtura vetëm për arinj, të krijojmë zona të mbrojtura edhe për njerëz, edhe zona të urbanizuara për njerëz. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Sipas radhës fjalën e ka deputeti Emrush Xhamajli .

EMRUSH XHEMAJLI: Ju faleminderit!

I nderuari, zoti Kryetar i Kuvendit,

I nderuari zoti Kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë dhe të pranishëm,

Kërkesa për shërim dhe pushim në parkun nacional “Malet e Sharrit” dhe veçmas në Prevallë e Brezovicë, janë në rritje të shpejtë. Si rrjedhim ka nevojë, e konform Ligjit për vende për rehabilitim, për rekreacion, për shëndet dhe për ndërtime turistike.

Natyrish, ka nevojë atje për një disiplinim të ndërtimeve për ndërhyrje të shpejtë, do të thosha, nëse nuk sanohet shpejt gjendja dhe ndërtimet në gjithë zonën e Parkut Nacional Malet e Sharrit, situata mund të dalë jashtë kontrollit urbanistik dhe jashtë kontrollit ligjor.

Me vërejtjet që u dhanë këtu, mendoj se duhet sa më parë të krijohet dhe të fillojë të veprojë Komisioni Parlamentar që e propozoi kryetari i Kuvendit dhe të dalë me raport dhe rekomandime për Kuvendin e Kosovës në një afat sa më të shkurtër, mundësisht tremujor.

Ajo për të cilën dëshiroj ta vë theksin është objekti i punës së Komisionit. Komisioni, pos Prevallës, objekt të punës duhet ta ketë gjithë parkun nacional “Malet e Sharrit”, pa e anashkaluar, sikurse Raporti i Avokatit të Popullit edhe Raporti i Komisionit funksional e ka anashkaluar edhe shkresat tjera përcjellëse e kanë anashkaluar, pra pa i anashkaluar: Brezovicën, Shterpcën, Firajën, bëhet fjalë për të njëjtin park nacional, nuk bëhet fjalë për katër-pesë parqe.

Ne, këtu po flasim pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës të 15 qershorit, nuk jemi duke folur për gjendjen paraprake, për të cilën foli deputeti Berat Luzha.

Ju lutem shumë, të kemi vëmendjen, gjatë shqyrtimit të Avokatit të Popullit edhe të Komisionit Funksional, sipas shkresave që dalin këtu, është shqyrtuar puna deri në Dollc edhe në Mushitisht, ju e dini ajo gati në hyrje të Suharekës, ndërsa shkresat nuk i përfshijnë në shqyrtim vetë pjesën qendrore të parkut, domethënë rajonin që është ngjitur me Prevallën aty Brezovicën dhe pjesët tjera përreth.

Andaj me të drejtë duhet të kërkohet një hetim i hollësishëm.

Atje zona është shumë e ngarkuar me parregullsi, përveç atyre që i përmendi edhe parafolësi, domethënë prerja, dëmtimi, i pyjeve e pa kurrfarë kriteri, gjithashtu, nuk janë të trajtuara si duhet ujërat e zeza, e kam fjalën për kanalizime, të cilat një pjesë e madhe e tyre derdhen në lumin Lepenc, ne e dimë çfarë lumi i kthjellët është ai edhe është mëkat i madh që të ndotet në atë formë.

Në Brezovicë, gjithashtu, u tha edhe këtu ka ndërtime pa leje. Lejet sa për dijeni, me siguri dikush e din, aktualisht jepen nga grupe ilegale qytetarësh, gjobiten apo më mirë të thuhet plaçkiten ata që e dërgojnë ndonjë send, ndonjë material ndërtimi ose orendi, çka po di, ormanë, televizorë për vendbanimet atje. Atje, gjithashtu, mbledhet taksë në mënyrë të paligjshme në Qendrën e Skijimit. Edhe këto nuk mund të arsyetohen me pasigurinë, komuna e Shterpcës, megjithatë, funksionon. Ju e dini janë kthyer edhe punëtorët e administratës, prej dje apo pardjeshmit kanë filluar të punojnë. Edhe Agjencioni i Pyjeve dhe gjithë Inspektorati duhet të punojnë normalisht si komunal si këta të qendrës edhe nuk ka arsyetim që me një vend, diku të punohet ndryshe, ndërkaq diku ndryshe. Por bëhet fjalë për gjithë Parkun Nacional, për një park të tërë edhe kjo duhet të trajtohet si tërësi edhe komisioni që krijohet, dëshirojmë të mos ketë një raport të tillë të njëanshëm pas qershorit. Një pjesë e shkresave, ju e keni parë e kanë datën e korrikut. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Sipas radhës është Naim Rrustemi, le të përgatitet Numan Baliq

NAIM RRUSTEMI: I nderuari Kryetar,

Të nderuar të pranishëm,

Unë personalisht mendoj se Raporti është i punuar mjaft mirë. Meqenëse në 6 pikat që janë dhënë, disa janë kontradiktore njëra me tjetrën dhe e mbështes propozimin e Kryetarit të Kuvendit që të shkohet me pikën e 6 dhe unë do ta shtoja edhe pikën e parë, që mos të bëhet gabim edhe më i madh.

Po shihet qartë nga dokumentet që na janë ofruar që kemi të bëjmë me mosrespektim të ligjit edhe të gjitha diskutimet ngadalë po rrëshqasin drejt diskutimeve që personazh kryesor po paraqitet kryetari i atëhershëm i Kuvendit komunal të Prizrenit, anëtar i tanishëm i Kryesisë, Eqrem Kryeziu.

Unë do t'ia rikujtoj Kuvendit të Kosovës se ne e kemi miratuar një ligj që ka të bëjë me parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Ky ligj veç sa ka kaluar në këtë Kuvend dhe aty është qartë e definuar se kush janë zyrtarë dhe ne deputetët dhe Kryetari i Kosovës, Kryetari i Kuvendit, të gjithë jemi zyrtarë publik dhe gjatë diskutimeve iu ndalohet të ndikojnë të marrin pjesë në vendimmarrje të organeve legislative, duke shfrytëzuar pozitën e atij zyrtari me qëllim të përfitimit personal. Në dokumentet unë që i kam në tavolinë edhe ju i keni, shihet se Eqrem Kryeziu është përfitues i drejtpërdrejtë në Prevallë, kështu që, sido që të jetë, ligjin jam duke e cituar, sido që të jetë, do të ishte e ndershme, politike, që të mos marrë pjesë në diskutim edhe të gjithë ata që në mënyrë drejtpërdrejt apo tërthorazi janë të ndërlidhur për përfitime personale në parkun e Prevallës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka Numan Baliq, le të përgatitet Zafir Berisha.

NUMAN BALIĆ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Očigledno je da ne postoje jako izražene zarlike u tumačenju samog problema, koliko postoje razlike u pristupu ovom pitanju, gde vrlo često taj pristup motiviran ličnim interesima ili grupnim interesima, a ponekad i partijskim i tako dalje.

Na nama je glavni zadatak da ovo pitanje konačno riješimo i da se ono više ne odugovlači. Ja mislim da je suština priče u svemu ovome. Ako bi smo samo formirali još jednu komisiju, onda bi to bilo novo odugovlačenje. Govorim u tom smislu da bi bio što pragmatičniji. Ja mislim da trebamo se ohrabriti i odlučiti se za riješenje ovog pitanja, naravno da ono bude pravedno i pošteno i da vodi računa o institucijama, o odgovarajućem ministarstvu, opštini i naravno o lokalnim zajednicama koje tamo žive, jer je ova zemlja njenih gradjana i ona mora voditi računa o svim zajednicama koje ovdje žive. Tako da bi u tom smislu konkretno podržao prijedlog Komisije, koji se tiče toga da treba hitno obustaviti sve aktivnosti s obzirom da je očigledno, od zadnjeg govornika smo čuli ono što smo mnogi već znali, da je bilo i personalnih motivacija, uključenja, a bogami bilo je i raznih stvari za koje znamo, iako nisu javno dokazane, da je bilo nepravilnosti, kršenja zakona.

Ne mislim na kršenje zakona u ustavnom smislu, zato što kod tumačenja zakona uglavnom se povodimo time da smo na onoj strani koja opravdava ovo, ili na onoj strani koji je protiv toga.

Zatim, nema odgovora u preporuci koja je data od strane Komisije, nema odgovora za mišljenje Ombudspresona koje se tiče da bi Vlada trebala da poništi odluku

Ministarstva. U stvari, tu je suština ovog problema. Čitava ova igra vodi se između opštine i ministarstva.

Opština je donjela odluku, a Ministarstvo je potvrdilo tu odluku. Problem nije segmentaran, problem je nacionalan. Ako pridjemo tom stanovništvu da je problem cijelog Kosova i da je Šar planina nacionalni rezervat, u tom smislu onda to pitanje pripada krovnim institucijama, Vladi i Parlamentu. Dobro je da je Parlament konačno počeo da se bavi pitanjem nadgledanja i kontrole rada institucija, i Parlament ima puno pravo. Razumjeo sam da postoje, moram tako da kažem, i lažne bojaznosti nekih ljudi da možda nema dokaza o kršenju zakona i tako dalje, i tako dalje, i šta onda može uraditi Parlament. Pa, Parlament je vrhovno zakonodavno tijelo u ovoj zemlji. On može promijeniti zakone ako treba, može i amandamentirati. Pa zar nismo danas usvojili toliko amandmana, i mnogo puta! Dakle, parlament i te kako ima i razloga i zakonskog opravdanja i mogućnosti i obaveza, ako hoćete, da reaguje.

Ovo pitanje, da počnem polako da privedem kraju, se mora konačno riješiti. Ja mislim da bi svi faktori kojki su ovde uključeni, i prošla Vlada, i ova Vlada, da bi trebale konačno ovo da riješe. Smatram takodje da bi Vlada trebala poništiti odluku Ministarstva, jer nije bila dobra i takodje opština koja je razmatrala ovo pitanje, da napomenem ono što je vrlo važno, na osnovu naših podataka i na osnovu toga što sam i osobno kao poslanik i kao čovjek mnogo puta tamo boravio, na osnovu izjava svih građana koji tamo žive, građani lokalnog stanovništva su bili ignorisani u najmanju ruku oko donošenja ovih odluka. Oni nisu bili uopšte pitani, u najmanju ruku su bili ignorisamni. Molim vas, ako su građani ove zemlje, oni su trebali biti pitani kod donošenja bilo koje odluke koji se tiče, a da ne govorimo oko toga da taj nacionalni park nije samo pitanje Prizrena, nego je pitanje, kao što smo rekli, četiri opština, da ne ponavljam sve to.

Dakle, lokalno stanovništvo je ignorisano, opština je radila na svoju ruku, odluka nije dobra, Ministarstvo je požurilo, nije uradio ono što je trebalo da radi i mislim da bi Vlada konačno trebala ovo pitanje da razmotri i da prelomi, pa ako hoćemo da gradimo, onda neka grade brate dva miliona ljudi, zašto da grade 34 čovjeka. Molim vas, ja pitam i vas i javnog čovjeka, po čemu to 34 čovjeka sa Kosova u nacionalnom parku cijelog Kosova mogu da grade kuće sa betonom i gvoždjem, a ne mogu ostali građani. Ako hoćemo da gradimo, onda da se da mogućnost svim građanima Kosova jer Prevalac treba da pripada svima nama, a ako će biti Nacionalni park, neka se gradi u skladu sa zakonom i neka se to konačno rasčisti.

Naravno, jasno nam je da postoji praktični problemi, da ljudi koji su prodali istina je, mi smo razgovarali tim ljudima, mislimo da je bilo uzurpacija. Međutim, činjenica je da je jedan broj ljudi prodao svoje imanje i oni su dobili pare i potrošili pare, i bilo im je lijepo i to je tačno. Dakle, ti ljudi su prodali svoje imanje, uzeli pare, a oni koji su platili napravili su svoje kuće, ne one koje su u skladu sa načinom gradnje u nacionalnim parkovima, nego su udarili temelje brate, beton i armaturu, a neki zidaju hotele i tako dalje. Dakle, jedan potpuni, potpuni nered koji je tamo zavladao i jedan dio koji, zaista, uopšte nije na pohvalu cijelom Kosovu a kamo li tom regijonu.

Na kraju, da završim, predložio bih da se ovo usvoji i da se naravno uzmu u obzir i ovi prijedlozi Ombudspersona koji se tiču donošenja izjašnjenja Vlade Kosova o poništenju ovog pitanja i, naravno, ako se tako utvrdi, da se razjasni, te kuće ako nisu sagrađane, a očigledno da nisu u skladu sa pravilima koje su vezane za nacionalne

parkove, onda te kuće treba rušiti. To su važne odluke koje se trebaju donjeti, suprotno su toga, svega je, pružiti mogućnost svim građanima Kosova, hajmo svi da gradimo na Prevali i napravićemo tamo još jedan divlji grad ili još jednu novu koloniju i mislim da niko neće biti ... Toliko, hvala vam ljepa!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Zafir Berisha, le të përgatitet Edita Tahiri.

ZAFIR BERISHA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër,

Kabinet qeveritar, kolegë deputetë,

Konsideroj se jam në mesin e atyre që e njohin mirë këtë problematikë dhe, natyrisht, edhe si deputet i asaj zone, e ndiej edhe një obligim të kyçem në këtë debat po, më duket, edhe më shumë për t' i dhënë disa sqarime që fatkeqësisht nuk janë dhënë.

Realisht, këtu nuk po preket gjeneza e problemit. Ne e kuptojmë ish-kryetarin e kuvendit komunal, se është profesor i letërsisë, nuk i njeh mirë ligjet dhe e ka bërë një kërkesë për t' ia lejuar, por tash shtrohet pyetja se a është dashur ministri Gjini për ta lejuar, domethënë që Asambleja komunale e Prizrenit ta marrë një vendim të tillë. Unë po mendoj se, realisht, ministri i atëhershëm Gjini e ka bërë një shkelje të rëndë që i ka lejuar Asamblesë të marrë një vendim, të bëjë një plan rregullativ, që plani në dukje, për të cilin nuk u fol, nuk është bash krejt kështu, siç po flitet nga disa deputetë, por ai plan, përpos disa kamp shtëpizave, aty ka edhe objekte hoteliere që e bëjnë me të vërtetë atë qendër atraktive.

Këtu tash mendoj se Parlamenti dhe institucionet, e veçanërisht Qeveria, përfundimisht këtë aferë të krijuar rreth Prevallës, duhet ta përmbyllin.

Çështja e Komisionit funksional është se Komisioni nuk është marrë në hollësi me parkun nacional, sepse parku nacional nuk është veç Prevala, dhe realisht, unë si shef i opozitës atëherë kam qenë i informuar hollësisht në Prizren se çka është duke ndodhur me parkun nacional, pastaj normal në kuadër të parkut edhe me Prevallën.

Unë mendoj se vendimin që e ka lëshuar atëherë Ministria, që unë e kam me veti, që fatkeqësisht deputetët, po më duket, nuk e kanë. Luta me të drejtë kërkoi që disa dokumente është dashur t' i kenë deputetët, thjeshtë implikojnë ministrin, domethënë me një shkelje që do ta bëjë pastaj asambleja komunale dhe faktikisht këshilltarët e asamblesë komunale do të dalin para aktit të kryer, duke menduar se natyrisht që rreth Prizrenit krijohet një qendër turistike që do të jetë interes edhe për qytetin e Prizrenit pse jo edhe për Kosovën. Në kuadër të kësaj, unë edhe kur është diskutuar gjashtëmujori rishikimi i buxhetit për gjashtëmujorin e dytë, unë jam inkuadruar dhe kam kërkuar atëherë që megjithatë Qeveria duhet të mendojë për disa pika turistike për ta shfrytëzuar natyrën e Kosovës në aspektin e zhvillimit të turizmit.

Realisht, derisa kjo çështje u ngritë në Parlament, këtu ka shumë shkelje. Unë nuk e kam idenë se në cilën vijë do të zgjidhet dhe kush do të jep përgjegjësi, mirëpo problemi qëndron se njerëzit kompetent duhet të kërkojnë përgjegjësi nga ata që e kanë nisur problemin. Unë nuk dua ta arsyetoj asnjërin, mirëpo, realisht, nga kryetarët e grupeve dhe nga parafolësit e mi, përpos Xhavitit, që me njëfarë forme u mundua me simbolika, me shembuj ta arsyetojë, asnjëri nuk e pat qasjen e drejtë rreth këtij problemi. Përndryshe, mendoj se kjo çështje duhet të përmbyllet dhe natyrisht Kuvendit Komunal

të Prizrenit, që atëherë ka qenë opozitë e tash është pozitë, t'i hapen dyert për të vepruar më tutje. Nuk qëndron ashtu siç tha kryetari i Grupit të LDK-së, zotëri Lutfi Haziri, se Bordi ka bërë një shkelje që e ka ndërprerë, Bordi nuk ka mund ta vazhdojë punën e paqartë që është rreth Prevallës. E kam fjalën për bordin aktual të Prizrenit, sepse ju e dini se kjo është një çështje që diskutohet tri-katër vjet dhe natyrisht Bordi i drejtorëve në Prizren ka qenë i vetëdijshëm që kjo çështje duhet të zgjidhet dhe organet qendrore, Parlamenti, Qeveria duhet të japin dritën e gjelbër si të veprojmë më tutje, përndryshe është një pezullim i përkohshëm dhe nuk është anulim i vendimit të Asamblesë Komunale, sepse ne jemi të gjithë të vetëdijshëm se organ vendimmarrës në nivelin komunal është Asambleja dhe Bordi i zbaton vendimet.

Prandaj, unë u inkuadrova me qëllim që të jap disa sqarime në këtë drejtim dhe, natyrisht, të orientohemi te thelbi i problemit në rast se është problem edhe si shkelje ligjore për të cilin, edhe njëherë po e përsëris me keqardhje, që ministri Gjini atëherë, një profesorit të letërsisë, që edhe një herë po them me gjithë konsideratën se, ndoshta, nuk i lexon shumë ligjet, por realisht ministri nuk është dashur të bjerë pre e kërkesave të profesorit Kryeziu, sepse unë po mendoj se probleme e kësaj natyre ka shumë në Kosovë, dhe realisht nëse duhet të trajtohet si problematikë e veçantë si kjo sot, është edhe çështja e Hadës, ku rreth 20 milion euro ende nuk dihet dhe mendoj që Ministria ose ministri i atëhershëm i Planifikimit, megjithatë, duhet ta japë një sqarim se konsideroj se edhe aty ka pasur shkelje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Për replikë, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Do të jem shumë i shpejtë, t'i përsëris disa gjëra që i thashë më përpara, me gjasë kolegu nuk i ka dëgjuar.

Nuk jam penduar për atë çka kam bërë, e kam bërë me bindje në atë kohë, e kam konsultuar ligjin. Janë njerëzit ligjor në Ministri të cilët vendosin se a është diçka konform ligjit apo jo, jo ministri. Nuk vendosin ministrat se a është diçka konform ligjit, ministrat japin vendime politike për bindjet e veta edhe të organizatës së cilës i takojnë.

Mendoj se një diskutim i këtillë le shije të keqe të ndryshimeve me ndryshim të pushtetit, do të thotë, profesorin të cilin e quan kolegu profesor, atëherë ka qenë kryetar i komunës dhe unë kërkesën e kam marrë prej kryetarit të komunës dhe unë, sa për të qenë i saktë, nuk ka qenë profesor për mua.

Çështja tjetër është bërë një gjë për zhvillim ekonomik, nuk është bërë një gjë për ndryshim diçka tjetër të keqe. Edhe e fundit është për Haden, unë nuk bëj hetime, le t'i bëjnë hetimet kush të dojë për t'i bërë, nëse donë të më pyesin...

KRYETARI: Fjalën e ka Edita Tahiri, le të përgatitet Naim Maloku. Replikë.

Mirë, urdhëro deputet, replikë.

Fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Meqë m'u përmend emri nga deputeti Berisha, dëshiroj veç të konfirmoj se ai kurrëgjë tjetër nuk tha pos e konfirmoi atë që unë në emër të Grupit Parlamentar të LDK-

së, e thashë, mungesë dokumentacioni nga ana e Komisionit të Bujqësisë për motive që i sqarova më herët.

Edhe një dokument po na mungon - vendimi i Bordit të drejtorëve që është i suspenduar, e jo i anuluar vendimi. Sikur ta kishim këtë dokument me veti në dosje, sikur fotografitë e kamp shtëpizave, që nuk shihen a janë kamp shtëpiza a çka janë, do të dinim për ta sqaruar, do të dinim të marrim pozicion të qartë.

Komisioni për Bujqësi, në mënyrë selektive dhe i motivuar politikisht ka bërë dosje dhe dëshiron në emër të dy letrave që është Avokati i Popullit si ushtrues i detyrës, tash edhe këtu ka probleme, edhe drejtori i OSBE-së që është larguar...

KRYETARI: Ju faleminderit! Replikë Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Unë sa për ish-ministrin Gjini dua vetëm për këtë dokument të them se mendoj që ministri është më kompetent për vendimet që merr Ministria, tash kush kanë qenë këshilltarët apo zyrtarët vartës, nuk e di, por megjithatë për atë emërohet ministër për të menaxhuar me Ministrinë.

Zoti Lutfi Haziri, realisht, është një pezullim. Unë u mundova për ta sqaruar, nuk është as anulim as asgjë, mirëpo ne në të gjithë këtë avari që është ngritur rreth Prevallës, unë po mendoj asnjë, cilido bord që do të kishte qenë, nuk kishte mundur të vazhdojë pa u bërë sqarimet. Thjeshtë, në fund të fundit, u potencua edhe nga ministri, atje nuk është duke u respektuar edhe ai vendim që është marrë i asamblesë dhe aty janë tri-katër lloje të ndërtesave që duhet të bëhen sipas vendimit të asamblesë dhe ajo nuk është duke u respektuar dhe, natyrisht, pushteti lokal është për ta menaxhuar këtë dhe...

KRYETARI: Ju faleminderit!
Lulzim Zeneli, për replikë.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, Kryetar!

U përmend Komisioni Parlamentar se kinse edhe aludimet politike dhe kinse ka përgatitur edhe dosje. Ju lutem, këtu nuk bëhet fjalë as për vendimet e kuvendit komunal, të Bordit të kuvendit komunal për anulimin e këtij projekti, këtu bëhet fjalë për shkeljet e ligjeve në fjalë, bëhet fjalë për park nacional që vetëm ky Kuvend ka autoritetin për të vendosur për çfarëdo veprimi apo çfarëdo projekti që donë të realizohet në park nacional, nën një. Dhe, nën dy, në qoftë se Qeveria e Kosovës është e mendimit të realizojë projekte ekonomike në kuadër të parkut nacional, atëherë patjetër prapë duhet të merret vendim nga ky Kuvend, kështu thotë ligji.

Nëse doni të anashkalohet ligji, kjo është diçka tjetër. Ligji për parkun nacional, Ligji për planifikim hapësinor...

KRYETARI: Ju faleminderit!
Urdhëro, Lutfi!

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Ne nuk po flasim për ligje, zoti Kryetar, as për Kushtetutë të Kosovës. Sikur të ishte thirr Komisioni në Kushtetutë dhe në ligje, në dokumente e kishte kompletuar dosjen për deputetët, por po thirret në dy letra të dy organizatave ndërkombëtare që ani pse janë,

mirë që janë këtu. Nuk kam kurrfarë problemi, por nuk do me thënë që Avokati i Popullit e ka fjalën e fundit, jo institucioni i Kosovës dhe nuk do me thënë që drejtori i OSBE-së, i cili ka shkuar për motive politike nga misioni, për motive politike është larguar nga misioni, e ka drejt. Këtu është argumenti që kryetari i Komisionit e zgjedh, e jo Kushtetuta dhe ligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem, ju lutem, keni kujdes. Ne nuk e dimë pse ka shkuar, ne e dimë se një ka shkuar, e tjetri ka ardhur, por nuk e dimë pse. Prandaj, nuk është çështje... Lulzim Zeneli, urdhëro!

LULZIM ZENELI: Plotësisht pajtohem me fjalën e fundit të Kryetarit të Kuvendit. Këtu kemi të bëjmë me punën e Komisionit parlamentar dhe tash me vendimin e seancës plenare.

Këtu nuk bëhet fjalë për letra, të cilat kanë qarkulluar me qindra dhe mijëra në adresë të këtyre problematikave, tash bëhet fjalë për rekomandimet dhe shqetësimet e Komisionit për shkeljen e ligjeve, bëhet fjalë për monitorimin e zbatimit të ligjshmërisë dhe nuk ka të bëjë këtu fjalë as me letra të institucioneve, qoftë ndërkombëtare, qoftë vendore e tjera jashtë këtij Kuvendi. Ku faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit! Vazhdojmë debatin. Fjalën e ka deputetja Edita Tahiri, le të përgatitet Naim Maloku. Fjala për deputeten Edita Tahiri.

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit. Zoti Kryetar, Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Qeveri e nderuar,

Diskutimin rreth çështjes së parkut nacional, përkatësisht të Prevallës e kuptoj si një përpjekje për të konsoliduar sundimin e ligjit në Kosovë, për të luftuar veprimtarinë korruptuese dhe për të vendosur rregull në Kosovë, që janë prioritetet e kësaj Qeverie, por edhe të këtij Parlamenti.

Çështja e Prevallës është tashmë e njohur edhe do të thosha nuk ka qenë e shtruar vetëm nga institucionet ndërkombëtare apo vendore, por edhe këtu në Parlament, në këtë mandat është shtruar. Unë si deputete e Prizrenit, bazuar në shqetësimet e qytetarëve të Prizrenit, kam bërë një pyetje parlamentare ministrit të Mjedisit, zotit Yagcilar, me përpjekje që të vazhdojmë në këtë çështje dhe po më vjen mirë që sot kemi një raport para nesh, i cili solli fakte të shumta për shkeljet, por edhe dokumentet tjera që e mbështesin këtë dhe unë do të thosha që është për keqardhje që shkeljet e ligjit qoftë ato të Kosovës, konventat ndërkombëtare janë bërë nga aktorë që kanë qenë bartës të institucioneve qoftë në nivelin lokal ashtu edhe në nivelin qendror dhe kjo u jep një shembull të keq qytetarëve të Kosovës, sepse kur të zgjedhurit e tyre e shkelin ligjin, qytetarët marrin një vizë më shumë për ta bërë të njëjtën.

U befasova prej përpjekjeve të disa pushtetarëve të kaluar që të bëjnë një argumentim i cili më tepër kishte një mbrojtje të zbehtë se sa ndoshta, një kundër argumentim të qëndrueshëm sepse do të shohim edhe më tutje çka ka ndodhur në Prevallë. Për shembull, fotot e zbehta, po fotot mund të jenë të zbehta, por realiteti është shumë i qartë në Prevallë, apo tjetra që letra e udhëheqësit të OSBE-së pa nënshkrim.

Ju lutem, është me rëndësi të koncentrohemi në përmbajtje dhe përmbajtja del nga goja e qytetarëve të Prizrenit, që janë shumë të shqetësuar me atë çka po shohin në Prevallë dhe unë për të qenë e shkurtër, dua t'i jap mbështetje rekomandimeve të

Komisionit dhe dua të kërkoj që të shtohet edhe një pikë, e cila ka të bëjë me shfuqizimin e vendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, sepse ai vendim ka qenë i Ministrisë dhe për çështje të karakterit nacional siç janë parqet nacionale e të tjera vendos Kuvendi i Kosovës.

Po ashtu kërkoj që Komisioni hetimor, i cili do të krijohet, të ketë mbështetje të plotë politike, nuk mjafton për t'ia venë barrën Komisionit dhe pastaj për ta lënë të vetmuar në rrugëtimin e kërkesës për sundim të ligjit, si dhe kërkoj nga Komisioni që në raport të përmendet po ashtu që ky shqetësim është përmend edhe nga deputetët e Parlamentit të Kosovës, pra nuk është vetëm kërkesa e Avokatit të Popullit apo e të tjerëve. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputeti Naim Maloku nuk është këtu. Fjala kalon te deputeti Bahri Hyseni, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritet të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë diskutimin tim do ta përqendroj në katër aspekte. Gjendja faktike në Malet e Sharrit, duke filluar prej shtëpive të vikendit në Brezovicë e duke përfunduar në Prevallë, baza legale mbi të cilën është marrë vendimi i Kuvendit Komunal, investitorët apo njerëzit të cilët kanë rindërtuar dhe në fund rekomandimet e Komisionit Parlamentar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Është lehtë të konstatohet gjendja faktike në Parkun Nacional në Malet e Sharrit, apo mali i Sharit dhe në fillim shpreh gatishmërinë që ta përkrah Komisionin Parlamentar për punën që e ka bërë, por jo tërësisht për rekomandimet që i ka bërë dhe unë kam disa vërejtje sa i përket pse në këtë raport nuk i ka përfshirë çështjet të cilat edhe më tepër i konsideroj shkelje legale, shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut dhe nëse është folur komplet për Parkun nacional, ka qenë dashur të përmenden edhe këto çështje.

Sot ata të cilët kalojnë në Brezovicë, e dinë shumë qartë se Asambleja Komunale ka marrë një vendim, një vendim që është në kundërshtim edhe me ligjet në fuqi edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ku ndalohet shitblerja në këtë zonë dhe posaçërisht ndalohet edhe ndërtimi. Këto dy vendime të Asamblesë Komunale janë në kundërshtim me ligjet aktuale në fuqi, bile edhe në kundërshtim me konventat ndërkombëtare, prandaj ka qenë mirë që të potencohet si çështje e parë.

Çështje tjetër me interes është, ta kuptojmë drejtë se sot në këtë zonë ka barrikada të vendosura nga njerëz ilegalë bile që nuk hezitojnë me e legjitimuar njerëz, andaj ka qenë dashur që Komisioni ta ketë parasysh edhe këtë çështje. Nuk mund të kalosh, të shkosh për t'i vizituar shtëpitë e vikendit pa dalë nga katër – pesë njerëz me uniforma të ndryshme për të legjitimuar. Prandaj, mendoj se edhe kjo çështje është e rëndësishme për Komisionin dhe ka qenë dashur të evidencohet, sepse kjo përveç asaj që është në kundërshtim dhe nuk po i lejon njerëzit së paku u drejtohen institucioneve me kërkesa legale, po i kufizon njerëzit edhe për të lëvizur të lirë në këtë pjesë.

Sa i përket gjendjes edhe për Prevallën edhe për zonën e shtëpive të vikendit, nuk do shumë sqarim. Kjo i përngjanë një kampi të refugjatëve që e kemi pasur dhe kemi mund ta shohim në vitet '99. Ky vend që ka qenë një bukuri natyrore, që ia ka dhuruar

natyra është shkatërruar plotësisht nga njerëzit në mënyra të ndryshme dhe përderisa ky vend është përdorur dhe po përdoret si vend ku njerëzit janë shëruar, tash lirisht mund të themi se në këtë vend mund të infektohesh nga kanalizimet, bërlloku dhe gjërat më të pahijshme që i sheh në Prevallë, po i përjashtoj, ndoshta, shtëpitë e vikendit janë pak më mirë.

Është mirë, Komisioni ka qenë dashur të konstatojë se ndërtohen shtëpi mbi degën e lumit Lepenc, dhjetë shtëpi me 5-6 ari vend dhe kjo nuk donë koment, por assesi për ta përjashtuar vendimin kundërligjor që është marrë nga Asambleja Komunale dhe barrikadat që i kemi në rrugë.

Baza legale mbi të cilin është marrë vendimi, nuk do shumë sqarim. Mua më intereson ta kuptoj cili autoritet ka të drejtën për të dhënë pëlqim për të ndërtuar në park nacional. Kjo nuk do sqarim dhe nuk donë shumë i mençur me qenë. Parqet nacionale janë të mbrojtura edhe me konventë, por pse në këtë rast edhe me ligjin e aplikueshëm? Ne në shumtën e rasteve e kemi zbatuar edhe ligjet diskriminuese, në këtë rast nuk është shumë keq me u thirr edhe në Ligjin e aplikueshëm, por edhe ligjet që i kemi nxjerr si Kuvend e tregojnë shumë qartë edhe Ligji për ambientin edhe Ligji për Planifikimin Hapësinor që nuk lejohet të ndërtohet në park nacional.

Për çudi, është rasti Ministria e Ambientit është duke punuar për planin hapësinor dhe shpresoj se për dy –tre muaj do ta kemi edhe në Kuvend për aprovim dhe po me vjen mirë që ministri i mëparshëm e arsyetoi vendimin ligjor, duke u mbështetur në zyrtarë ligjor, jo, jo ministrat nganjëherë dinë të thonë se ne jemi këtu shef të Ministrisë dhe atë e kanë barrën dhe përgjegjësinë kryesore.

Në këtë plan hapësinor shumë qartë dhe në mbështetje të konventave dhe ligjit janë përcaktuar zonat, pra janë tri zona: zona e parë, zona e dytë, zona e tretë që nuk dua t' i përsëris gjërat. Në zonën për të cilën po flasim për Prevallë, nuk lejohet fare ndërtimi dhe këtë nuk kemi nevojë dikush të na arsyetojë e më së paku ata që janë përgjegjës, që kanë lëshuar pëlqime, sepse nuk lejohet fare të lëshohet një pëlqim që të rindërtohet në këto zona, dhe ju e dini mirë që kjo zonë në vitin '99 Oshlaku ka qenë plotësisht i djegur dhe po më vjen keq zotëri Ministër që e keni shkruar 30 hektarë në këtë planin hapësinor, por nuk është fjala për 30 hektarë, por është fjala për 84 hektarë dhe është mirë që të përmirësohet, t'i merrni dokumentacionet.

Nuk po flas për përgjegjësinë, kalojmë te ajo e treta investitorët dhe njerëzit që kanë ndërtuar, ata janë më së paku fajtor, e kanë gjetur pak badihava dhe e kanë blerë, është shumë normale. Pak badihava, sepse çmimi ka qenë aq i lirë sa që me një shtëpi të vikendit tash mund të fitojë një 10 herë më shumë, nëse e shet, por ato vendime që i kanë, janë vendime legale, sepse janë lëshuar prej institucioneve të Kosovës, por ne duhet të ndalemi edhe ato leje që i kanë prej organeve, a janë respektuar dhe nëse e sheh ti një dokumentacion të Drejtorisë së Urbanizmit, tregon se 95% e të gjitha shtëpive që kanë leje, janë ndërtuar pa u mbështetur në planet të cilat i kanë marrë, e kanë tejkaluar. Në qoftë se e kanë pasur me material montazh, e kanë shndërruar në material të fortë, nëse kanë pasur dy etazhe, e kanë qar në tre etazhe, e nuk di çka më tepër, dhe krejt në fund rekomandimet e Komisionit duhet përkrahur, por jo në të gjitha pikat.

Konsideroj që pika 3, nuk ka nevojë. Qeveria nuk mund të marrë obligim, sepse mendoj që edhe nuk ka mjete të mjaftueshme financiare dhe nuk ka edhe ndonjë bazë ligjore për t'i rrënuar këto shtëpi, nuk ka bazë ligjore sepse ekzistojnë lejet që janë marrë prej institucioneve, ato nuk i kanë lëshuar vetë.

Çështja tjetër, është shumë pak kontestuese dhe a mund të marrë Qeveria vendime për një vendim që është marrë në bazë joligjore nga Qeveria e mëparshme, atëherë do të duhej që Qeveritë, secila Qeveri që vjen me u marrë vetëm me vendimet e qeverive paraprake, dhe çështja e tretë ku është paraparë fati nëntëmujor për planin hapësinor, unë konsideroj që ky plan veç është i gatshëm dhe së shpejti do të jetë, sepse debati i fundit është bërë në qershor të këtij viti, dhe shpresoj se për dy-tre muaj do ta kemi në Kuvend, dhe kjo pika e pestë nuk ka nevojë të jetë me rekomandim, sepse plani në njëfarë mënyre është i gatshëm drafti dhe mbështesë pikën fundit të Komisionit, që për këtë çështje të formohet një panel apo një organ hetimor, i cili do të merr parasysh të gjitha dokumentacionet...

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet! Fjalën e ka Riza Smaka, le të përgatitet Naim Maloku.

RIZA SMAKA: I nderuar, zoti Kryetar!
Zoti zëvendëskryeministër,
Ministra dhe deputetë të nderuar,

KRYETARI: Urdhëro, Ardian, veç shumë herë po të bie të flasësh.
Ardian Gjini e ka fjalën!

RIZA SMAKA: Me leje, a ma dhatë mua fjalën?

KRYETARI: Deputet, një replikë, një minutë e ka.
Regjia, fjalën Ardian Gjinit.

ARDIAN GJINI: Shumë shkurt, ndoshta, edhe më pak se një minutë. Kolegu deputet tha në park nacional nuk bën të ndërtohet. Kushdo që i ka thënë, e ka rrejt. Nuk ka park nacional në botë ku nuk ndërtohet, ndërtohet bile edhe shumë, ndërtohen qendra të skijimit, ndërtohen fshatra turistike, krejt në parqe nacionale janë. Një koleg i juaj i partisë pak më përpara ju numëroi disa vetëm në rajon, mund t'ju numëroj edhe në botë sa të doni dhe gjithkund ndërtohet park nacional edhe krejt çka është bërë është bërë konform ligjit. Mund të thoni çka doni, këto tash po shndërrohen në çështje politike, çka ka bë ish..., çka ka bë tash. Konform ligjit është bërë, mund ta vërtetoni ligjshmërinë, ndryshe jo vetëm me fjalë, pa i ditur ligjet, pa i pas lexuar kurrë dhe lexoni krejt nenet në ligj, mos i lexoni veç dy kur t'i lexoni.

KRYETARI: Faleminderit!
Urdhëro Bahri Hyseni, replikë.

BAHRI HYSENI: Të them të vërtetën, nuk është në etikën time të replikoj, por ligji është shumë i qartë. Pjesa ku ka dhënë pëlqimin zotëriu, është Oshlaku. Kjo pjesë është e djegur dhe bën pjesë në kategorinë e dytë, ku ndalohet me ligj dhënia e lejes për çfarëdo ndërtimi, përveç rekreacioneve dhe qendrave tjera për pushim, por kurrsesi për shtëpi private dhe për çështje të tjera. Kjo është e qartë, s'kemi nevojë të lexojmë më tepër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Riza Smaka. E ke të drejtën edhe me Rregullore, Ardian. Fjalën deputetit Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit! Replika është e drejtë demokratike, s'ka të bëjë me etikën ose me pa etikën, është e rregullt të replikosh, krejt bota replikon. Prapë tha diçka që është e pavërtetë. Nuk është e vërtetë që në atë zonë nuk guxon të jepet leja për ndërtim, në fund të fundit, a është ndërtuar rruga, a është ndërtuar rruga në zonë të parë? Është rruga që 50 vjet atje dhe ndërtimet janë në skaje të rrugës e jo në zonë të djegur, po këqyrni hartat mirë!

KRYETARI: Urdhëro, Bahri, shfrytëzoje të drejtën tënde që e ke, me Rregullore e keni.

BAHRI HYSENI: Hiq, po, po i tregoj deputetit në fjalë që ky s'ka pasur të drejtë fare ta japë leje, sepse për këtë nuk ka vendosur Kuvendi i Kosovës dhe nuk ka ende plan hapësinor për këtë zonë. Aktualisht, është park nacional dhe Kuvendi i Kosovës ende s'ka marrë vendim për ta ndryshuar destinacionin, nëse duhet drejt dhe qartë.

KRYETARI: Mirë, faleminderit!
Deputeti Smaka e ka fjalën.

(Ndërprerje)

RIZA SMAKA: Zoti Kryetar,
Auditorium i respektuar,

Është fjala, duam apo s'duam, që e ka komponentën e vullntares, duam, s'duam. Unë angazhohem për atë duhet, nolens - volens, vili – nili. Ju lutem, ne duhet, medoemos, me të gjitha energjitë e forcat tona pozitive të angazhohemi për zbatimin e ligjit, kjo është çështja esenciale. Ishte një diskurs i pasur dhe thuajse s'ka kush të thotë diçka të re pos atyre që u thanë, mirëpo, meqenëse u thanë nga pozicionet pro et contra, që do të thotë unë do të isha angazhuar për aq sa mundem që të jem neutral, indiferent, porse në konformitet me normat të cilat për ne janë imperativ.

Objekti i këtij debati është, ju lutem, Sharri, parku nacional. Parku nacional është Res Publika, ani pse ndodhet në Sharr, është çështje e krejt Kosovës, prandaj për aq është çështje e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Organet e tjera i kanë ingerencat, i kanë prerogativat, i kanë kompetencat ligjore, por kur vjen çështja te nuditeti, atëherë Kuvendi është institucioni më i lartë edhe si konkluzione dalin këto, sipas meje:

Një, ligji aplikativ nuk aplikohet. Ligji aplikativ aplikohet në konformitet me interesat individuale – grupe, aq më keq, sidomos kur është fjala për përgjegjës, për personat e autorizuar. Unë, për fat edhe s'e di, s'i di emrat, po u tha në mënyrë botore se janë këtu dhe me siguri do të identifikohen.

Unë e kam pas ngritur një pyetje kuvendore edhe më herët referuar po kësaj tematike, por nuk kam pas marrë përgjigje. Ambienti në Kosovë terrorizohet, kemi sot terror ekologjik, ambienti devastohet dhe degradohet tmerrësisht. Kjo është e paparë, e padëgjuar edhe e patoleruar me çka do qoftë.

Thuajse me qëllim nuk bëhet planifikimi urbanistik gjeneral, përkatësisht detal. Pse? Bëhen ndërtime sipas forcave politike, ekonomike e financiare, më pastaj bëhen legalizimet e atyre që nuk janë legale - abinicio, çdo gjë që nuk është legale në fillim, asnjëherë nuk mund legalizohet.

Unë do të isha angazhuar që, parimisht, me disa modifikime të pranohet raporti i Komisionit. E ka bërë një punë të mirë, serioze, dhe të ngrihet komision kuvendor hetues, që t'i japim edhe objektivat, përafërsisht. Ta verifikojë gjendjen e fakteve, saktësisht, edhe gjendjen juridike dhe të shohim aty diskrepancën ku është, nëse ka, të mos prejudikoj. Të japë propozime pa limitime, propozime dhe askush nuk mundet apriori t'ia limitojë autorizimet Komisionit, i cili do të ngrihej, sepse ka autorizime çfarë i vlerëson sipas diskrecionit. Kolegë, nuk mund të thotë ministri që këshilltarët, e tjera. Ministri, unë kur kam dashur ta kuptoj mirë ç'është ministri, kështu ia kam definuar vetvetes. Ministri është një farë, virtualisht, drejtori gjeneral, e tash i një, po e zëmë, departamenti, i një distrikti, i një fushë veprimtarie dhe, u mor vesh, të gjitha çka dalin nga një Ministri për të mirë, i atribuohen ministrit, por edhe defektet, natyrisht. Ministri përgjigjet direkt i pari politikisht dhe juridikisht për sferën të cilën e mbulon si ministër. Ju lutem, ekzistojnë, ndër të tjera, dy tipe të vendimeve, ka shumë, të abroguara dhe nule. I abroguar -ekstum, nul eksnum- e kundërta, që do të thotë, në qoftë se do të konstatohej se është fjala për vendime nule, ato do të nulloheshin ekstum, ju lutem, dhe më pastaj do të hapeshin çështje të tjera. Kjo është çështje juridikisht e rregullt, s'ka kurrfarë pengese. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet Smaka!

Radhën e ka deputeti Naim Maloku. Le të përgatitet deputeti Eqrem Kryeziu.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Kjo pikë e rendit të ditës, si duket, do të marrë shumë kohë. Unë, fillimisht dua të çmoj punën e Komisionit parlamentar, mirëpo nuk ka sjellë dokumentacionin e duhur që kjo temë që ka marrë këto përmasa, kjo pikë e rendit të ditës të diskutimit të ketë edhe bazën të mbështetur në dokumentet relevante që janë kërkuar këtu dhe që kanë qenë të nevojshme, që janë pjesë përcjellëse e këtij raporti. E kam fjalën për dokumentet prej vendimit të Ministrisë e deri te vendimet tjera që janë marrë edhe nga Kuvendi Komunal i Prizrenit në mandatin e kaluar dhe lejet që janë lëshuar për ndërtime në atë lokacion për të cilin po debatohet sot.

Zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni t'ju rikujtoj se Ministria për Planifikim Hapësinor, projektin për parkun, për fshatin turistik të Sharrit në Prevallë, fshatin turistik Prevalla ia ka kthye një vit e gjysmë kuvendit komunal derisa nuk është sjellë projekti detal për trajtimin e ujërave të zeza nga ky lokacion. Pra, është punuar në bazë të ligjeve. Ku janë bërë devijime? Devijimet janë bërë në implementimin e lejeve të ndërtimit që janë marrë. Qytetarët, pra njerëzit që i kanë marrë ato leje, i kanë marrë në mënyrë ligjore dhe legale. Gjatë implementimit dhe mbikëqyrjes së implementimit të atyre lejeve, nuk ka funksionuar, nuk kanë funksionuar inspektorët komunalë, të cilët është dashur që të mbikëqyrin të gjithë ndërtuesit apo iu përmbahen parametrave dhe kushteve që janë përcaktuar për secilin ndërtim dhe për secilën leje. Pra, janë bërë tejkallime individuale.

Më lejoji të them edhe një tejkallim tjetër. Janë dy çështje atje: fshati turistik Prevalla dhe kampi turistik, i quajtur atje, që janë qindra kampshtëpiza, e ka marrë tenderin e quajtura Is Kompani, e cila nuk iu ka përmbajtur fare kushteve të cilat kanë qenë të parapara dhe të parashtruara në tender, çdo qytetarë atje që e ka kampshtëpizën, paguan 365 euro taksë vjetore, që mund t'ju them se është shumë më e lartë se sa në kampet identike në shtetet perëndimore. Nuk kanë ofruar kushte të parapara me tender para se të merret ai tender dhe nuk ka pasur, pra, mbikëqyrje nga kuvendi komunal edhe mbi atë kompani, e cila e ka marrë në realizim kampin në Prevallë.

Kur i shohim rekomandimet, të nderuar deputet, zoti Kryetar, në pikën e parë, rekomandimin e parë, duhet të ndahen veprimtaria e gurthyesve dhe prerjet ilegale të pyjeve nga aktivitetet ndërtimore në “Fshatin Turistik” në Prevallë. Unë propozoj që pas këtij debati të mos votohen rekomandimet, por shëfat e grupeve parlamentare, duke u mbështetur në debatin, t’i sjellin rekomandimet të ndryshuara para Kuvendit dhe ato pastaj të qiten në votim, se nuk mund të qiten, sipas mendimit tim, në votim këto rekomandime të cilat janë këtu para nesh edhe për shkak se, siç thanë parafolësit, pesë pikat e para vinë në kundërshtim me të gjashtë, ku kërkohet si rekomandim i Komisionit parlamentar që të formohet Komisioni Hetimor.

Dua edhe diçka, zoti Kryetar, personale të them. Ndërprerja e ndërtimeve në fshatin turistik në fjalë ka për të shkaktuar dëme më të mëdha se sa të mbyllet dhe të përfundohet ndërtimi. Pse? Sepse kanë mbetur të pa trajtuara ujërat e zeza, kanë mbetur të pa sistemuara të gjitha ato shtëpi, kanë mbetur, do të thotë, edhe infrastruktura tjetër që ka qenë e paraparë me plan ndërtimi të atij fshati, ka mbetur krejt infrastruktura e pa përfunduar dhe gjendja është shumë më e keqe se sa do të kishte qenë sikur të ishte kryer ai projekt deri në fund. Pra, ka mundësi të reduktimeve aty, duhet lënë në kompetencat e Kuvendit komunal, por duhet projekti të kryhet. Pajtohem me parafolësin tim që e pati fjalën për mundësinë e rrënimave që kishte për të qenë e pamundur për shkak se ato leje janë marrë në mënyrë legale. Pra, jam për atë që rekomandimet të rishikohen, të harmonizohen në mes të grupeve parlamentare, të vijin rekomandime të tjera në Kuvend dhe ato pastaj t’i nënshtrohen votimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, për kontributin e dhënë!
Fjalën e ka deputeti Eqrem Kryeziu, le të përgatitet Zef Morina.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Më lejoni t’i përshëndes zëvendëskryeministrat, ministrat e Qeverisë, Më lejoni t’ju falënderoj edhe juve që na dhatë një pauzë, se unë e ndjeva veten të rrezikuar, të them të drejtën. Tash u inkriminua edhe prona private këtu, megjithëse po më duket Kushtetuta e Republikës së Kosovës këtë çështje e ka sqaruar, por në qoftë se dëshirojmë të bëjmë debate të tilla për t’i dhënë një kahe tjetër shoqërisë tonë, ajo tjetër çështje. Besa edhe ... e lirë e jem, diqysh e ndjeva veten si në ankth po, sidoqoftë, ju falënderoj edhe njëherë për atë 2 orë e gjysmë që na dhatë pauzë edhe e mora veten pak.

Megjithëse unë nuk do të përgjigjem në, si të them, sulmet që nuk i konsideroj fort parimore, sidoqoftë do ta falënderoj zotin Naim Rrustemin për vërejtjen që e dha me vend dhe unë do të jem i kujdesshëm që të flas këtu si dëshmitar i këtij procesi. Se unë i kam unë 3 ari vend, unë e kam pranuar publikisht shumë moti këtë, 3 ari pronë timen, e kam pranuar shumë moti publikisht, po sidoqoftë po them, do të kem kujdes që të mos rrëshqas në mbrojtjen e asaj prone, e cila pronë edhe mund të zhduket me lehtësinë më të madhe pa e pasur asnjë brengë se, të paktën, luftën që e përjetuam na ka mësuar këtë leksion që nuk është me rëndësi fare që dashurohet njeriu. ku ta dijë se sa. pas pronave materiale. Por, më lejoni t’ju them, ju lutem, gjenezën e presionit të ligjshëm që ka ekzistuar në Prevallë mbi organet e pushtetit lokal dhe për pasojë të pushtetit lokal mbi Ministrinë dhe Qeverinë e asaj kohe, presion jashtëzakonisht i ligjshëm. Në qoftë se dikush e quan kaos dhe një farë lloji kampi refugjatësh, po harrojnë se çfarë ka qenë para se të bëhet ky projekt zhvillimor. Ai ka qenë një turp publik i shoqërisë kosovare. Unë e përgëzoj ministrin Yagcilar që ishte shumë i balancuar. E vetmja gjë që unë do ta kontestoj ishte se komuna nuk ka bërë sa duhet për gurthyesit. Jo, ndoshta s’i ka

njohuritë e veta, se komuna është rrahur prej atyre gurthyesve dhe s'kemi mundur t' i ndalim, jo që s'kanë leje fare, por s'kemi mundur t' i ndalim. Mund ta verifikoni kush u ka dhënë lejen e pse, policinë e...., do të thotë, përpos këtij elementi, këto të tjerat unë i përgëzoj se ishte një fjalim i balancuar. Dhe, tash, çka ndodhi nën atë presion të ligjshëm dhe në ndërkohë afër 18 shtëpi ne, si pushtet i votës së lirë, i kemi rrënuar atje në Prevallë, pa plan. Në qoftë se nuk do të jepeshim një alternativë të planit rregullativ, nuk ka pasur pushtet në Kosovë që do ta ndalonte pushtimin e Prevallës dhe shndërrimin e saj në një farë lloj paralagje të San Paulos. Po të mos ishte vendosmëria e pushtetit komunal të asaj kohe për t' i rrënuar ato 18 ndërtesa ilegale, jo ekzistueset, ato që mbijnë në ndërkohë derisa ne ishim aty. Unë po them që askush prej nesh sot nuk do të bisedonte më për Pervallën, sikurse askush prej nesh s'po bisedon më çka po ndodh në Brezovicë, çka bo ndodh gjëkund.

Unë kam frikën, zoti Kryetar, dhe po i kërkoj falje Naimit, ndoshta jam subjektiv, por këtu nuk e kemi të qartë a jemi për kaosi a jemi për rend. A kemi bërë mirë, a keq, a qysh, 4 vjet ka zgjatur procedura për ta marrë unë lejen, unë si kryetar i asamblesë komunale, prej Ministrisë së Ambientit, 4 vjet. Së këndejmi, nuk ka projekt më transparent në Kosovë deri tash, sepse prej 8 vjetëve pusht popullor të votës së lirë, 4 kanë shkuar atje duke i pritur, me durimin më të madh, nuk ka pas kurrfarë lidhje miqësore, hajde ngute, përkundrazi.

Dhe, kur e kemi marrë atë leje, natyrisht që i kemi hyrë punës. Nuk është e vërtetë, që tha zoti Luzha, se kanë filluar ndërtimet para se të vendosë asambleja. E falënderoj zotin Xhezairin që than jo një vjet më vonë kanë filluar. Por, edhe nuk është mirë të dëgjojmë tonalitete, more burë, po ne e dimë që në kohën e Rankoviqit nga 3 herë i kemi paguar tokat ne shqiptarët dhe nuk është mirë në emër të acarimit që të qojë dikush gishtin e të thotë, korrupsioni këtu është në pyetje. Po si është korrupsioni në pyetje, kur asnjë para publike nuk shpenzohet në atë projekt. Ky është shembulli i parë ku pushteti e dikton projektin e miratuar, ndërkaq e realizon kapitali privat. Asnjë cent i buxhetit publik nuk shkon dhe tash të kërcënohesh edhe me këtë, korrupsion, shiko mua po më vjen keq, ne të vjetrit, se mua më akuzojnë shumëkush se jam i vjetër, e kemi këtë përparësi që i mbajmë disa procese në mend.

T'i kthehem tash letrës së ambasadorit Guldiman. Problemi ishte a ka nënshkruar a se ka nënshkruar? Zonja Edita, nga aspekti i vet, natyrisht, e përmendi çka ka thonë esenca. Shikoni çka thotë esenca e Guldimanit, thotë: OSEB-ja ka vënë re që atje kishte një mungesë totale të një konsultimi të duhur publik për miratimin e planit urban, urban në përputhje me Ligjin për planifikim hapësinor. Shikoni, në qoftë se 4 vjet janë mungesë totale e informimit publik që të paktën ish- ministri dhe unë më se 10 herë në media kemi dalë. A kemi bërë mirë, a kemi bërë keq, zotërinj, këto janë Dhe, shikoni çka thotë më tutje: Shqetësimet tona lidhen me mungesën e përputhshmërisë me Ligjin për planifikim hapësinor. Kjo është e vërtetë, po prandaj komuna ka marrë leje për këtë zonë të veçantë, zona e tretë ku lejohen ndërtimet, si tha zotëri Yagcilari, ka marrë leje prej Ministrisë, nuk e ka bërë vetë këtë projekt, se vetë e kemi bërë ne në komunë planin zhvillimor, sikurse çdo komunë tjetër që e ka bërë pa qenë në përputhje me planin hapësinor të Kosovës. Në qoftë se kjo do të duhej të vlejë, të anulohet ky plan, për këtë arsye të gjitha projektet zhvillimore do të duhej të anulohen anë e mbanë Kosovës

Dhe, shikoni, e treta çka po thotë dhe e fundit, e ambasadorit të nderuar, që edhe unë nuk po di përse ka shkuar? Nëse doni edhe po e shpreh keqardhjen që ka shkuar. Shikoni, çka thotë: Për më tepër, procedura e shpronësimi prek pronarët e tokës brenda zonës dhe ngre

shqetësime sa i përket mbrojtjes së drejtave individuale të pronës, veçanërisht për personat e zhvendosur. Unë po ju siguroj, zonja dhe zotërinj, ja këtu e kam dokumentin ku deri edhe serbët pronarë atje e kanë përfaqësuesin legal, jo vetëm boshnjakët, me të cilët kemi pas raporte shumë të mira dhe, t'ju them të drejtën, krejt kjo ide përpos presionit legjitim për të bërë diçka atje, ka qenë edhe një ndjenje miqësie, bashkëpunimi dhe e kemi nisur këtë ide para 6 vjetësh kur UNMIK-u ka qenë kryesori nëpër komuna, ne s'kemi qenë kurrgjë, por në emër të bashkëpunimit dhe të atij integrimi që ka ekzistuar, ne kemi nisur. Dhe, është interesant, vetëm pasi ka dal tenderi, tenderin e kanë zgjedhur pronarët e tokave, jo komuna, ata japin paratë, ata kanë... Vetëm pasi është përmbyllur për herë të dytë, është zgjedhur tenderi, atëherë kanë filluar ecejaket dhe ashpërsimet dhe instrumentalizimet. Kam frikë se janë politike. Pse nuk pati, përkundrazi, përkundrazi kanë qenë mirënjohës që erdhi koha që të hyjnë në këtë sistem dhe nuk ka asnjë problem pronësor atje, absolutisht asnjë problem pronësor.

Ju përkujtoj, zonja dhe zotërinj, se vetëm 60 vila janë paraparë në tokë publike, por ato nuk kanë titullar, ajo varet prej Qeverisë apo prej kujt të jetë, a komuna. Të gjitha janë në tokat private të njerëzve ku i kanë ndërtuar vilat. Për të qenë korrekt, është e vërtetë që tha zoti Luzha se ka tejkalime. Të paktën, jo më shumë se 10% ka tejkalime prej lejes së marrë, ka tejkalime edhe në përdorimin e materialit ndërtimor, që është diktuar totalisht prej dheut jashtëzakonisht rrëshqitës, deri fidanët e shokut Tito nuk kanë zënë aty vend, merre me mend. Ja, kjo është e vërteta, askush nuk është i dashuruar në beton, ta kemi të qartë këtë, po...

KRYETARI: Faleminderit!

Ramë Buja e ka kërkuar fjalën, urdhëro Ramë. Replikë, po më duket.

RAMË BUJA: Zoti Kryetar,
I nderuari zoti Kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,

Më besoni, nëse më pyet dikush, pas këtij debati, kah do të votosh dhe si do të votosh, unë jam në mjegull fare. Dhe, diçka që dua të propozoj konkretisht. Këtu, unë me sa dëgjova, me aq vëmendje sa pata mundësi, përmenden 5 dokumente që unë nuk i besoj që i kanë 90% të deputetëve këtu, 5 dokumente për të cilat unë nuk di. Me qenë se edhe 11 folës janë, kisha propozuar që ky debat të vazhdojë në javën që vjen, por me plotësimin, me dokumentet e domosdoshme në mënyrë që të informohen të gjithë deputetët këtu. Përndryshe, unë sinjerisht po ju them, jam në mjegullnajë, nuk di se çfarë të bëjë. Është propozimi për ta vazhduar seancën një ditë të javës së ardhshme, por me plotësimin e 5 dokumenteve, që unë nuk e di për të cilat flitet, kishte qenë më logjike, besoj. Faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Mirë faleminderit!

E kemi një mocion dhe duhet të prononcohen shefat e grupeve parlamentare.
Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Lutfi Haziri

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar,
Kryeministër,

Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet qëndrimin e shefit të Grupit Parlamentar të PDK-së, janë 4 dokumente që unë i kam përmendur në fjalën time hyrëse, si mungesë e dosjes së paraqitur nga ana e Komisionit, dokumenti i 5-të ka të bëjë me dokumentin që u përmend nga deputeti Berisha lidhur me vendimin e Bordit të drejtorëve për suspendimin

dhe këto dokumente janë të domosdoshme për ta qartësuar votimin e çdo deputeti. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Sipas radhës, shefi i Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah kërkesën që të shtyhet ky debat, sepse edhe ashtu ka shumë folës, deri në fund që janë paraqitur. Edhe ashtu kjo temë, besoj, do të shtyhet për seancën tjetër ose për pjesën tjetër, kështu që pajtohemi që kjo pikë e rendit të ditës të vazhdojë në javën e ardhshme në një seancë të rregullt që do ta kemi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Sipas radhës shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën. E kemi kërkesën, jemi të obliguar që kërkesën, mocionin e shefit të grupit Parlamentar të Partisë Demokratike ta qesim në votim. Po, njëherë prononcohen, ju lutem, njëherë prononcohen shefat e grupeve. Shikoni Rregulloren. Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

E mbështesim por, po ashtu, me ato që i tha edhe zoti Buja edhe zoti Haziri që të plotësohet dokumentacioni i deputetëve me dokumentet të cilat nuk i kemi marrë prej Komisionit Parlamentar. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka shefi i LDD-së Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, Kryetar!

Unë e kuptoj se është vështirë edhe një grup parlamentar t'i përmbahet presionit të tillë. Prandaj, e kuptoj se kemi këso prononcimesh edhe këso qëndrimesh në fund të debatit, prej krejt asaj çka kemi deklaruar dhe kemi debatuar deri më tash. Por një gjë duhet ta kemi të qartë, kjo seancë plenare mund të marrë çfarëdo vendimi, por kjo asnjëherë nuk mund ta justifikojë shkeljen e tri ligjeve themelore sa i përket kësaj natyre, nën një.

Dhe, tjetra, çka është shumë me rëndësi, Qeveria e Kosovës, së bashku me partnerët e koalicionit duhet ta mbajnë përgjegjësinë, për krejt këtë çka ka ndodhur dhe po ndodh. Mos harroni, edhe sot kur po debatojmë, gurthyesit atje po punojnë, po punojnë gurthyesit në vendin që është rezervat strikt i mbrojtur. Nëse dikush prej jush don ta dijë çka është rezervati strikt, atëherë mund të vijë në Komisionin Parlamentar dhe të njoftohet. Po, ana tjetër çka mund t'ju them, mbajmë përgjegjësinë ne si Komision Parlamentar, por edhe tash si Grup Parlamentar kemi kryer një punë- ju vazhdoni me një ritëm të tillë. Kryetarin e Kuvendit e falënderojmë për gatishmërinë që ka shprehur vazhdimisht për ta vënë në rend të ditës dhe gjithmonë dhe Kryesia e Kuvendit në momentin e fundit ka treguar vullnetin e mirë që të debatohet kjo. Mirëpo, e dini se nuk mund të justifikohen shkelëbërësit, nuk mund të justifikohen gjitha këto dëme që po i bëhen vendit tonë dhe, nëse mendoni se me këso veprimesh krijojmë imazh pozitiv Kosovës, atëherë kjo qenka rruga, kjo qenka vizioni dhe strategjia e Qeverisë së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Radhën e ka “7+”, fjalën e ka kërkuar deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedniče!

Parlamentarna Grupa „7+“ ne može promeniti ovo što se namerava, ali želim kazati u ime grupe dve rečenice. Slike koje danas imamo na Prevalcu su užasne i ne daju nikakav argument da ćemo dugom pričom i odlaganjem nešto popraviti.

Drugo, sve mi se čini da, na kraju današnje debate, i ova Skupština liči na Prevalac. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Slobodan Petroviqi, nga SLS-ja. Fjalën e ka deputeti Slobodan Petrović.

Të nderuar deputetë, rregulla 30, mocionet procedurale, paragrafi 1, pika a, Mocioni për ta shtyrë debatin, do të thotë ka të drejtë. Pastaj, pika 2, për mocionin për ta shtyrë debatin për një datë të caktuar, një debat të ardhshëm dhe për mocionin për ta shtyrë seancën, menjëherë bëhet votimi pa debat.

Pika 7, mocioni për ta shtyrë debatin, për ta shtyrë seancën, për të kaluar një çështje në Komision ose për të mbyllur debatin, duhet të ketë mbështetjen së paku të një grupi parlamentar para se të debatohet. Të gjitha këto, ju lutem, janë në Rregullore dhe ne po punojmë në bazë të kësaj rregulloreje. Shefat e grupeve parlamentare u prononcuan, tani nuk kemi debat, kemi votim.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, për ta shtyrë debatin.

Dëgjoni, propozimi ka qenë për ta shtyrë debatin, për ta kompletuar materialin për deputetët dhe për të vazhduar seanca. Pra, për këtë mund të vendosim sot, nëse doni të mërkurën, ose të enjten. Po, atë që e tha, e dëgjuat shefin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Lus deputetë dhe regjinë, të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatoj se me 57 vota “për”, 16 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet mocioni i shefit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Seanca do të vazhdohet javën e ardhshme. Për seancën e ardhshme mbetet edhe pika e 7 e rendit të ditës.

Vazhdimi i sencës, më 10.10 2008, në orën 10:00

KRYETARI JAPKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,
I nderuari zëvendëskryeministër,
Ministra të Kabinetit të Qeverisë,

Më lejoni që në emrin tuaj, pra në emër të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve të cilët i përfaqësojmë, t’i përshëndesim dy njohjet e fundit, se vërtetë kanë një domethënie të veçantë, njohjen që ardhur nga Republika e Malit të Zi, nga Parlamenti dhe Qeveria e tij, dhe njohja që ka ardhur nga Maqedonia, nga Parlamenti dhe Qeveria e Maqedonisë për njohjen e shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës.

(Duartrokitje)

Natyrish, dëshirojmë që edhe vendet e tjera të rajonit ta ndjekin shembullin e këtyre dy vendeve fqinje. Ju faleminderit!

Për fjalë është lajmëruar deputetja Gjylnaze Syla, Urdhëro, Gjylnaze!

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!

I nderuari zoti Kryetar,
Të nderuar ministra,
Deputetë të nderuar,

Dje është zhvilluar një ngjarje e rëndësishme për Kosovën dhe të ardhmen e saj, sidomos për proceset integruese, miratimi i Rezolutës Serbe në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Kjo ka një rëndësi të madhe për Kosovën dhe do të shkaktojë një dëm në rrjedhat e mëtejshme. Prandaj, zoti Kryetar, konform Rregullës 29.1 që ka të bëjë me çështjet urgjente, kërkoj që Kuvendi i Kosovës të nxjerrë Rezolutën për hapat e mëtejshme që institucionet e Kosovës duhet t'i ndërmarrin. Ftoj deputetët që ta përkrahin këtë propozim, sepse është çështje e rëndësishme për Kosovën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete Syla!

Edhe unë po e shfrytëzoj Rregullën 29.1, që vërtet kjo nuk është pikë as e ngutshme, as për Kuvendin e Kosovës, për faktin se Rezoluta nuk ka pasur efekte, se në vigjiljen e saj Kosova është njohur si shtet i pavarur dhe sovran nga Portugalia dhe dje Republika e Kosovës ka pasur për mysafir Komisionerin, zotin Oli Ren, dhe dy njohje të reja, kështu që Rezoluta, si po duket, Rezoluta e Serbisë që ka kaluar në Asamblenë në Përgjithshme, nuk po jep efektet e saja, mendoj që efektet do të jenë më shumë pozitive. Ju faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, zoti Lutfi Haziri. Urdhëro, deputet!

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Faleminderit, i bashkëngjitem edhe unë urimit tuaj për njohjet e djeshme që janë të rëndësishme për shkak të dy shteteve fqinje. Me konsideratën më të madhe, mendoj se ne duhet ta përmendim emrin zyrtar të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Ka qenë pjesë e debatit dhe për Kosovën zyrtarisht ai shtet është me emër që njihet.

Ju lutem, unë në emër të Grupit Parlamentar paraqes mocion për shtyrje të vazhdimit të debatit sotshëm të rekomandimeve të Komisionit për Bujqësi. Edhe në seancën e rregullt i kam paraqitur arsyet, edhe sot i paraqes arsyet, se pushojnë të gjitha nevojat që për këtë çështje të debatohet. Sekretari ka proceduar dy dokumente të rëndësishme për deputetët, por mungojnë edhe një numër i madh i dokumenteve që përfshijnë edhe Planin e përkohshëm rregullativ, që përfshijnë edhe vendime të tjera që e kanë përcjellë këtë problematikë deri në këtë fazë.

Unë kërkoj që për motive, kryesisht të harmonizimeve më të mira dhe të plotësimit ta çojmë debatin një ditë tjetër, e cila sigurisht do të tregojë qartë që do të pushojnë të gjitha arsyet që ato rekomandime të jenë të votuara nga shumica e deputetëve dhe praktikisht ta krijojmë mundësinë sa më shpejtë që zhvillimi i asaj pjese, sipas vendimit të asamblesë

komunale, dhe mbështetjet nga Qeveria të vazhdojnë sa më shpejtë dhe ky është një prej problemeve.

Duke dashur të përmbledh mocionin në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, unë kërkoj mbështetjen tuaj, zoti Kryetar, dhe të grupeve parlamentare, në mënyrë që kjo çështje të shkojë në përmbyllje sa më shpejt, por në mënyrën më të mirë, më të drejtë, duke vlerësuar se do të pushojnë të gjitha nevojat që të ngrihet puna atje. Ne po kërkojmë të kundërtën, që të funksionalizohet dhe të zhvillohet sa më shpejt ai regjion, në përputhje me ligjin në fuqi dhe në përputhje me rregullat rigoroze që pyjet tona të ruhen ashtu siç kërkon ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Për fjalë është paraqitur deputeti Ramadan Gashi.

RAMADAN GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në emër të Komisionit ad-hoc propozoj që në rend të ditës të futet Projektligji për pensionet e pjesëtarëve të Trupave të Mbrojtjes së Kosovës, pasi që ky Komision dje, në pajtim me rregullën e hartuar për punën e këtij Komisioni, e ka shqyrtuar në parim këtë Projektligj dhe jemi të obliguar që brenda 24 orëve ta procedojmë edhe në këtë seancë. Mendoj që janë pjekur kushtet që të shqyrtohet në lexim të parë.

KRYETARI: Faleminderit!

Kemi dy mocione, një nga shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Lutfi Haziri, dhe dy, kemi propozimin e zëvendëskryetarit të Komisionit ad-hoc, zotit Ramadan Gashi, që ta bëjmë leximin e parë të Ligjit, do të thotë, të futet në rend të ditës, besoj që jeni dakord për këtë, por ne po shkojmë sipas rregullës, të bëjmë prononcimin e shefave të grupeve parlamentare.

Fjalën do t'ia jepja shefit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zotit Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuari zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Zotëri ministra, zëvendëskryeministra,

Unë po i bashkëngjitem urimit për dy njohje të reja që janë shumë domethënëse për ne, natyrisht edhe falënderim për këto dy shtete që kanë pasur një ndikim të jashtëzakonshëm dhe të veçantë për këto rrethana. Dhe, ajo që dua ta them për mocionin e kolegut tim të nderuar, zotin Lutfi Haziri, është diçka që vërtet është shumë e arsyeshme për faktin që kërkesën që kemi bërë për shtyrje në seancën seancën e kaluar dhe kemi kërkuar që 5 dokumente, së paku, të jenë ato që janë përfolur dhe përmendur dhe që t'i kemi ne të gjithë për ta pasur të qartë pasqyrën e gjendjes në atë, po e them, mal të telasheve, nuk janë plotësuar, andaj konsideroj që është shumë e nevojshme që kjo të shtyhet për t'u plotësuar këto dokumente dhe për ta pasur secili deputet pasqyrën reale të kësaj gjendjeje dhe pastaj mund të debatojmë shumë më logjikshëm.

Ndërsa, mocionin tjetër, të ofruar, për të mos e marrë fjalën dy herë, të zëvendëskryetarit të Komisionit ad-hoc, ne si Grup Parlamentar e mbështesim, sepse është një çështje që do të duhej ta bëjmë sa më shpejtë të kryer. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Sipas radhës, fjalën duhet ta marrë kryetari i Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Është praktikë tashmë që t'iu bashkëngjitemi përshëndetjeve për njohjen e Kosovës nga dy shtetet fqinje, që konsiderojmë se paraqet njohjet më të rëndësishme që nga fillimi i këtij procesi.

Sa u përket dy mocioneve, Grupi Parlamentar i AKR-së nuk e mbështet mocionin për shtyrjen e debatit në pikën që ka mbetur për këtë seancë, ndërkaq, sa i përket pikës së dytë ose mocionit të dytë për futje në rend të ditës të Ligjit ose të Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështet këtë mocion për pensionimin e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse dhe do të jemi në favor të futjes në rend të ditës të kësaj pike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë!

Sipas radhës, fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Nuk është aspak e tepërt edhe një herë të thuhet që Kuvendi e mbështet shumë fuqishëm, në fakt shpreh miradije të fuqishme për njohjet që i kemi marrë prej dy fqinjëve tanë të parë, por mendoj se duhet të lëshojmë deklaratë dhe t'i falënderojmë për shkak se kanë trasuar rrugë për marrëdhënie shumë të mira në të ardhmen në mes vendeve të regjionit.

Sa për dy mocionet, edhe ne i mbështesim, unë do t'i jap dy sqarime të mundshme. Dokumentet që i kemi marrë deri me tani, janë Raporti i Komisionit, letra e Ombudspersonit, Letra e shefit të OSBE-së, Lista e pronave të tokës të Komunës së Prizrenit, Raporti i komunës, i fundit prej datës 4.06.2008, do të thotë, pas suspendimit dhe disa fotografi, që nuk shihen, ndërsa dje ose pardje, në të fundit, e kemi marrë letrën e ish ministrit drejtuar kryetarit të komunës, që është letër përcjellëse, por jo materie të cilës ajo letër i është bashkëngjitur, kemi marrë letrën përcjellëse të sekretarit, por prapë jo materien të cilës ju ka bashkëngjitur ajo letër përcjellëse, dhe vendimin e Kuvendit Komunal të Prizrenit, të kaluar, por dokumentet të cilat nuk i kemi marrë janë: Plani, dokumenti më i rëndësishëm. Cili është plani? Për çka po flasim? Ai plan duhet të jetë, kushtet për të cilat flet letra përcjellëse. Cilat janë kushtet që i ka dhënë Ministria, kërkesën Komunës së Prizrenit, me arsyetim, procedurat e ofruara nga Ministria, të cilat janë shumë rregullisht të përcjella, shpalljet për diskutim publik, procesverbalet e diskutimeve publike, procesverbalet nga mbledhja e Kuvendit Komunal, kur është marrë vendimi. Aktvendimet për toka, letrat e komunikimit në mes zyrtarëve në vazhdimësi, dhe udhëzimet konform nenit 24 të Ligjit për planifikim hapësinor. Për këtë arsye, edhe ne e mbështesim mocionin për shtyrjen e këtij diskutimi.

Mocionin e dytë, i cili vjen nga nënkryetari i Komisionit ad-hoc, po ashtu e mbështesim. Mendojmë se sa më shpejt të jetë e mundshme duhet ta kalojmë ligjin në fjalë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, Kryetar!

Në emër të Grupit, konsideroj se mirënjohja dhe falënderimi që e shprehu Kryetari i Kuvendit është e mjaftueshme dhe Kryetari i Kuvendit ka autoritetin e plotë të përfaqësojë këtë Kuvend, prandaj nuk e konsideroj të tepërt që ta përsërisim atë që e thanë kolegët parafolës.

E përkrahim, si Grup Parlamentar, propozimin e deputetit Ramadan Gashi, që të vendoset si pikë e rendit të ditës dhe japim mbështetje të plotë, ndërsa sa i përket propozimit që doli prej Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, Lidhjes Demokratike të Kosovës, jo vetëm që e kundërshtojmë, por e cilësojmë si diçka që nuk ka sens as të jetë pjesë e debatit, as e diskutimit, për arsye se nuk posedon asnjë argument të mjaftueshëm që sot Seanca plenare të mos vazhdojë diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Sa i përket asaj, konsiderojmë që, nëse kjo tejkalohet sot dhe ndërpritet ky debat, anashkalohen procedurat të cilat ky Kuvendi i Kosovës i ka shumë mirë të njohura në procesin e monitorimit të zbatimit të ligjeve, atëherë e konsiderojmë si diçka që po i bëhet një dëm i madh ligjshmërisë, një diçka që Kuvendi i Kosovës po e justifikon keqbërjen, po i justifikon shkelësit e ligjit dhe Kuvendi i Kosovës përfundimisht është vënë në shërbim të procedurave ilegale dhe është vënë në shërbim të asaj që ne, me gojën plotë, po e kundërshtojmë në vazhdimësi, shkeljen e ligjit dhe manipulimet të cilat po ndodhin dita ditës.

Prandaj, po e konsiderojmë edhe një gjë dhe kërkoj nga Kryetari i Kuvendit që mos të bie pre e këtyre provokimeve dhe mos të bie pre e elementeve të cilët kanë për qëllim vetëm ta thellojnë keqbërjen, ta thellojnë shkeljen e ligjit dhe të demonstrojnë se Kosova me të vërtetë po hyn në një binar që nuk ka kthim mbrapa dhe ajo është që, në qoftë se Kuvendi i Kosovës sot përkrah diçka që është në kundërshtim me ligjin, diçka që është në kundërshtim me procedurat ligjore, atëherë definitivisht këtu nuk kemi çka të bisedojmë më shumë.

Edhe njëherë po e them, në qoftë se kolegët nga Lidhja Demokratike e Kosovës kërkojnë argumente shtesë, ne jemi këtu të ofrojmë argumente shtesë, si komision funksional i Kuvendit të Kosovës. Mirëpo, të kërkohet diçka që është kompetencë e Kuvendit Komunal të Prizrenit, atëherë ne t'i diskutojmë vendimet e kuvendit komunal, kjo konsiderohet diçka që nuk është as e logjikshme, as nuk përkon me procedurat dhe ligjet në fuqi. Prandaj, ne kemi kërkuar si Komision Parlamentar, që e mbështet Grupi Parlamentar i LDD-së, që të respektohen ligjet dhe t'i lihet hapësirë dhe mundësi Kuvendit të Kosovës të monitorojë zbatimin e ligjshmërisë në territorin e Kosovës.

Nëse ne këtë nuk e bëjmë sot, atëherë dikur do të jetë vonë dhe nuk di cili do të jetë objekti i debatit dhe objekti i punës së këtij Kuvendi, në qoftë se ne nuk monitorojmë zbatimin e ligjshmërisë. Këtë po e them në formën më të butë, këtë po e them në formën që të gjithë ta vrasim ndërgjegjen tonë dhe të bisedojmë për diçka që është jetike, e jetike është zbatimi i ligjshmërisë.

Kuvendi i Kosovës nuk ka gjetur kurajë deri me tash që të bisedojë për diçka që është fundamentale në jetën parlamentare, që është fundamentale për një sistem demokratik dhe tash jemi në një procedurë kur dalin propozime që kanë vetëm një qëllim - të

anashkalohet ligji, të thellohet keqbërja, të thellohet veprimtaria e shkelësit të ligjit, dhe çka më tutje, çka mëton?

Në takimin fundit, në seancën e fundit, Qeveria e Kosovës ka marrë përsipër, ka marrë ky Kuvend përsipër që kjo çështje të trajtohet me seriozitet. Në qoftë se ne si Kuvend i Kosovës sillemi me kaq modesti ndaj shkeljeve të ligjeve, atëherë unë nuk di cili është objekti që më tutje Kuvendi i Kosovës ta ruaj autoritetin dhe ta ruaj funksionalitetin e vet.

Prandaj, zoti Kryetar, si Kryetar i Kuvendit, autoriteti më i lartë i këtij Kuvendi, ju kisha lutur të mos biem pre e këtyre provokimeve dhe të mos biem pre e iniciativave të cilat e dëmtojnë punën e Kuvendit të Kosovës dhe e dëmtojnë ligjshmërinë në vend. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Sa i përket rolit tim, unë ia përkujtoj Kuvendit edhe njëherë, unë punoj mbi bazën e Rregullores së Punës së Kuvendit.

Rregulla 30, pika 2,(unë po e lexoj) e Rregullores së Kuvendit, thotë: “Për mocionin për ta shtyrë debatin për një datë të caktuar në një debat të ardhshëm dhe për mocionin për ta shtyrë seancën, menjëherë bëhet votim pa debat”.

Pika 7 e Rregullës 30: “Mocioni për ta shtytë debatin, për ta shtyrë seancën, për ta kaluar një çështje në komision ose për ta mbyllur debatin, duhet të ketë mbështetjen e së paku të një grupi parlamentar, para se të debatohet”

Këtë rast e kemi dhe nuk ka nevojë, do të thotë, e dëgjuam prononcimin e shefave të grupeve parlamentare, kemi edhe dy grupe parlamentare që duhet të prononcohen. Fjalën ia kisha dhënë Grupit Parlamentar “7+”, deputetit Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedniče!

Mi smo protiv oba ova predloga, znači protiv smo odlaganja ove tačke dnevnog reda, prve, protiv smo takodje uvodjenja ove druge tačke po hitnom postupku.

Prvo, mislimo da je ovo kupovina vremena i neće doprineti da se stanje popravi u Nacionalnom parku, koji gradjani sve više zovu nacionalna sramota. Ako se ovo odloži, ja ne znam koliko će biti u stanju poslanici da se bave problematikom koja je sa mnogim novim dokumentima, u tom slučaju treba ova Skupština da formira Anketni odbor koji bi se bavio i koji bi doneo zaključke ako smatramo da Komisija za poljoprivredu sa svojim preporukama nije odradila dovoljno svoj posao.

Ako ovo prodje, a mislim da će proći, da se odloži, isto predlažem da se svakom poslaniku od strane Skupštine obezbedi po jedan pravnik kako bi mogli da se bavi ovom problematikom, jer zaista će biti toliko materijala da neće imati vremena.

Zašto za to da se ne uvrsti u dnevni red ova druga tačka, razlog je što smo mi taj materijal, odnosno taj Nacrt zakona dobili jutros, možda je on dostavljen pre dva dana, ali mi smo ga dobili jutros, i niko ga od nas nije pročitao. Ja sam predsednik Komisije za zdravlje, rad i socijalu, ovaj se Zakon tiče ove Komisije. Planirali smo da pre prvog čitanja razmatra Komisija ovaj Zakon i mislim, da ako to bude za par dana, nedelju dana, da neće biti na gubiku nego na dobitku i Parlament i Komisija. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Por, duhet ta keni parasysh, pika që shtohet për rend të ditës, bëhet sipas mocionit për procedurë të përshpejtuar dhe kisha pasur dëshirë që ta përcillni më mirë këtë çështje dhe, vërtet, prononcimi i shefave të grupeve parlamentare të jetë pak më i shkurtër, se edhe me Rregullore është e përcaktuar.

Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Uvaženi ministri i poštovane kolege poslanici,

Parlamentarna grupa Samostalne liberlane stranke će biti uzdržana po pitanju predloga da se sa dnevnog reda povuče predlog Parlamentarne grupe LDK-a, iz jednog prostog razloga zato što ne vidimo da će to nešto dobro doneti, i sdruge strane nismo dovoljno upoznati sa celom problematikom, da li to stvarno može nešto da donese napredak. Ja i dalje smatram da bi trebalo da se raspravlja o tome i da bi trebalo da se uvedu neke mere, jer ćemo tako imati manju štetu dok se sve to istraži i dok dobijemo materijal.

Po pitanju drugog predloga, ja poznajem poroceduru usvajanja zakona iz paketa gopsodina Ahtisarija i član sam ad-hoc komisije, ali kad me neko obavesti sat vremena pre početka komisije, ja imam druge obaveze, ne mogu da dođem, materijal smo dobili danas, tako da ćemo i po tom pitanju biti uzdržani, jer taj ceo proces sa tim zakonom treba da se završi do 12 juna 99-te godine. Ja mislim da do tada ipak ima dovoljno vremena da se na narednoj ili na nekoj od narednih sednica da se uvrsti u dnevni red. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Materiali për Ligjin, do të thotë për Projektligjin për pensionimin e parakohshëm të anëtarëve të Trupave të Mbrojtëse të Kosovës është shpërndarë sipas Rregullores, dje para dite, jo sot. Ju i dëgjuat mocionet, do të thotë edhe me rregull nuk kemi, nuk zhvillojmë debat. Votojmë.

Lus deputetët dhe regjinë, së pari të votojmë mocionin e kërkuar nga shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Lutfi Haziri, pra të përmyllet debati për pikën e 7-të të rendit të ditës.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Ju faleminderit, konstatoj se me 45 vota “për”, 23 “kundër” dhe 6 abstenime, votohet mocioni i shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Në radhë kemi kërkesën për pikën shtesë, të bërë me kërkesën e kryetarit të Komisionit ad-hoc për Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatoj se me 65 vota “për”, 6 “kundër” dhe 8 abstenime, miratohet do të thotë mocioni për ta shqyrtuar në lexim të parë Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Ju faleminderit!

Vazhdojmë sipas rendit të ditës, pika e shtatë:

7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim, Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me gjendjen në pyjet e Kosovës

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim, Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka shqyrtuar gjendjen aktuale në pyjet e Kosovës dhe Kuvendit i ka parashtruar Raportin me rekomandime.

Ftoj Kryetarin e komisionit funksional, zotëri Lulzim Zenelin, që të parqet Raportin e Komisionit. Ju njoftoj se në sallë kemi 78 deputetë.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim, Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në kuadër të përgjegjësiave dhe të kompetencave të veta, pas pranimi të ankesave të njëpasnjëshme dhe të shqetësimeve lidhur me gjendjen e rëndë në pyjet e Kosovës, këtë çështje e ka trajtuar me seriozitetin më të madh duke iu qasur seriozisht procedurës së mbikëqyrjes apo të kontrollit të implementimit të ligjeve në fuqi, sa i përket kësaj fushe, dhe pas vizitave në terren të realizuara në Kuvendin Komunal të Deçanit, në një takim të përbashkët me përfaqësues nga kuvendi komunal, Shërbimi Policor i Kosovës, Trupat e Mbrotjtjes së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur të datës 21.07.2009, shqyrtoi dhe analizoi gjendjen e krijuar në pyjet e Kosovës, e në veçanti në Komunën e Deçanit dhe nxori këtë konstatim: “Se gjendja e pyjeve në vend, në veçanti në Komunën e Deçanit, është tejte e rëndë, duke shkuar drejt një degradimi masiv, si rezultat i prerjes ilegale të drunjve, prandaj i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës, të miratojë këtë:

1. Qeveria e Republikës së Kosovës me vendim të ndërpres përkohësisht të gjitha aktivitetet legale që ndërlidhen me prerjen e pyjeve në Kosovë, veçanërisht në Komunën e Deçanit. Këtu përfshihet edhe anulimi i tenderëve për prerje të drunjve,

2. Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural urgjentisht të përgatisë planin menaxhues afatgjatë për pyjet e Kosovës,

3. Qeveria e Republikës së Kosovës të fillojë procedurën për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve: Ligjit për pyje, të Ligjit nr. 2003/3, në pajtim me politikat e Qeverisë së Kosovës,

4. Qeveria e Republikës së Kosovës të iniciojë procedurën e ristrukturimit të njësishë –Rojet e pyjeve, në përputhje me nevojën dhe gjendjen e krijuar në Kosovë,

Këto ishin, të nderuar deputetë, katër rekomandimet dhe konstatimi i Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim, Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, të cilat ia rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që t'i miratojë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputeti Xhavit Haliti.

XHAVIT HALITI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Unë dua ta përshëndes Komisionin për çështjen e ngritur dhe dua t'i jap disa nga sugjerimet dhe vërejtjet e mia, të cilat i kam parë nga vendi.

Nuk është dhe nuk janë vetëm bjeshkët e Deçanit që janë duke u prerë. Gjithë brezi halor i bjeshkëve të Kosovës dhe gjithë malet me gështenja, aq të domosdoshme për frymëmarrjen dhe mushkëritë e qytetarëve, për bukuritë e Kosovës dhe për zhvillimin e mundshëm dhe të vetëm të mundshëm të turizmit në Kosovë, siç është turizmi malor, janë duke e shkatërruar njerëzit e papërgjegjshëm dhe janë duke e shkatërruar për shkak të pamundësisë për t'u mbrojtur ato. Prandaj, unë po them, sepse e kam parë me sytë e mi, që nga Mokna, Lugu i Butë, Sejnova, Rosulija, Bjeshkët e Rugovës, Bjeshkët e Isniqit, Bjeshkët e Prilepit dhe krejt ajo zonë janë duke u dëmtuar pamëshirshëm dhe janë të pambrojtura në tërësi.

Dua t'ju përkujtoj që dy vendet të cilat nuk kanë det, Austria dhe Zvicra, kanë më shumë fitim nga turizmi malor se sa Spanja që fiton nga deti brenda vitit kalendarik për faktin se turizmi malor funksionon gjatë 12 muajve, ndërsa turizmi në det është 3 – 4 muaj më së shumti.

Prandaj, me këtë rast do t'i sugjeroja që Qeveria të marrë një vendim konkret, që përkohësisht të mbrojë me tre rrathë mbrojtjeje malet e Kosovës, prerjen dhe shkatërrimin e tyre. Dhe, cila është ajo? Unë kam vërejtur që në pika të kontrollit, të ashtuquajtura të vendosura nga Drejtoria e Pylltarisë, qëndron vetëm një njeri që e ka ngritur një tra për të kaluar apo mos të kaluar kamionët.

Unë kam asistuar gjatë tërë natës për të parë se çfarë po ndodhë. Gjatë gjithë ditës prehen pyjet, prehet mali dhe fillon në ora 12.00 deri në 1,00 ngarkimi i kamionëve dhe bartja e tyre në drejtim të rrafshit, në drejtim ku shiten ato. Njësoj funksionon gjithkund, prandaj do t'ju sugjeroj, për të mos hyrë në detaje, sepse secila pjesë e bjeshkës i ka specifikat e veta dhe në momentin që lejohet një kamion i cili është i dizajnuar për të bartur lëndë drusore, në momentin që lejohet një eskavator për të shkuar në bjeshkë, dihet destinacioni pse shkon, për të hapur rrugë për ta lehtësuar tërheqjen e lëndëve pyjore nga mali.

Prandaj, unë mendoj që në qoftë se Qeveria vendos që kontrollin ta bëjnë në tre rrathë, do të thotë: Drejtoria e Pylltarisë, Policia dhe, pse jo, edhe Trupat Mbrojtëse ose Forca e Sigurisë së Kosovës, dhe kjo të bëhet me rotacion, mos të lihen të njëjtit njerëz, sepse korrupsioni nuk njeh as uniformë, as ku ta di se çka, por çdo ditë të ndërrohen njerëzit që kanë për të ruajtur aty, të jetë ai i pylltarisë i përhershëm, po polici dhe përfaqësuesi i Forcës së Mbrojtjes së Kosovës, të jetë çdo ditë tjetër në pikat ose në vendet ku qëndron trau i hapur dhe mos të lejohen kamionët të cilët janë të përgatitur për të bartur lëndë pyjore.

Një çështje tjetër që desha ta ngre. Në bjeshkët, po them, të Kosovës, në veçanti ato Bjeshkët e Nemuna dhe Bjeshkët e Deçanit, të Strellcit, të Isniqit, ku ta di unë, me rend andej, është një fenomen ku të gjithë ata që dalin në bjeshkë, e kanë shfrytëzuar bjeshkën për kullosa në të kaluarën. Në të kaluarën kanë qenë pronat e tyre, ka pasur gjithmonë konflikte me pushtetin, me njerëzit që kanë dalë pa leje në bjeshkë. Tani ata e konsiderojnë pronë të vetën bjeshkën, por si pronë nuk janë në gjendje ta mbrojnë malin, andaj edhe Qeveria do të duhej që ta zgjidhte këtë problem me urgjencë, të definohej prona e kujt është bjeshka, është pronë shoqërore, është pronë e atyre që e shfrytëzojnë për kullosa dhe kush do të japë llogari dhe përgjegjësi për shkatërrimin e saj. Në qoftë se ne mendojmë që të ndërtojmë një turizëm malor në Kosovë, mendoj se Qeveria me urgjencë, me buxhetin që e miraton në këtë vit, ta bëjë një projekt, të

paktën, sivjet ta financoj një projekt, i cili do t'i lidhte bjeshkët e Kosovës në përgjithësi në të gjitha anët me një rrugë, e cila do të mundësonte qarkullimin e njerëzve të cilët duan ta shfrytëzojnë edhe për kullosa, edhe për turizëm malor dhe, në anën tjetër, rrugët e hapura për të kaluar maunat dhe eskavatorët të cilët shërbejnë për t'i hapur rrugët e tyre, të bllokohen dhe të mos lejohet që të qarkullojnë lëndë drusore të fortë.

Përndryshe, është tmerr i vërtetë, për ata që e ka ndjesinë për pyjet, çfarë është duke ndodhur, pa e parë në vend, askush nuk e beson. Prandaj, për këtë çështje desha që të kërkoj që ministria përkatëse, Ministria e Bujqësisë, të kërkojë ndihmë ose të vendos raporte konkrete ose të kërkojë një vendim të veçantë në Qeveri lidhur me çështjet që i ngrita. Përndryshe, ka qenë një vendim, dua ta konkretizoj, i Ministrisë së Bujqësisë për pastrimin pyjeve. Ai vendim u është dhënë me tender njerëzve të caktuar dhe njerëzve, dua të them konkretisht, të pandërgjegjshëm, njerëzve të cilët jo vetëm që nuk e kanë pastruar pyllin, por kanë shfrytëzuar këtë favor dhe kanë prerë lëndë drusore më të mirat që i kanë gjetur nëpër pyje dhe i kanë shitur dhe, jo që nuk e kanë pastruar, por edhe prerjen kur e kanë bërë, e kanë bërë shumë të keqe, që për syrin normal të njeriut është tmerr të shihet se çfarë kanë bërë.

Tani po e shtroj një pyetje, konkretisht për Ministrin e Bujqësisë, që është këtu. A ka një raport në Ministrinë e Bujqësisë nga këta njerëz, të cilët kanë marrë tender në Ministrinë e Bujqësisë për ta pastruar pyllin, për t'i pastruar malet e Kosovës, a ka një raport në të cilin është thënë se cilat pyje janë pastruar dhe a ka pasur një kontroll për ta verifikuar atë për çka janë paguar, a e kanë pastruar apo e kanë prerë pyllin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike. Po shkoj sipas radhës. Janë lajmëruar Sanije Alijaj, Armend Zemaj dhe Zef Morina. Kush nga ju e do fjalën në emër të grupit? Fjalën e ka Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar! Me porosi edhe të shefit të Grupit Parlamentar për shkak të obligimeve, po flas edhe në emër të Grupit tani, pavarësisht se kjo çështje, ndoshta, për mendimin tim edhe të gjithë deputetëve, me shumë arsye është edhe e vonuar, pavarësisht se e përshëndesim edhe Komisionin, që më në fund ndoshta e ka marrë një iniciativë të tillë dhe personalisht ka shkuar në vendin e ngjarjes që të njihet me problematikën që ndodhë në pyjet e atyre trevave.

Unë, në muajin e pestë të këtij viti, përmes pyetjes parlamentare jam munduar që ta ngrejë këtë çështje se çka ndodhë me shkatërrimin e këtyre pyjeve në atë trevë, duke përfshirë që nga Bjeshkët e Strellcit, Gryka e Deçanit e deri atje te Zharet përmbi Botushë.

Të nderuar deputetë dhe të gjithë ata qytetarë, Atje më nuk ka çka të mbrohet, atje duhet të shikohet ndoshta që të ketë një riprodhim. Pyjet janë totalisht të shkatërruara me vite që nga paralufta dhe nuk po flas që nga paslufta se nga paslufta pyjet, sidomos të Deçanit, kanë qenë të shndërruara në një biznes fitimprurës, të cilët, ndoshta edhe ata që e kanë bërë, nuk e kanë menduar që do ta shkatërrojnë edhe jetën edhe biodiversitetin e asaj treve. Këtë e them me shumë arsye. Në Deçan, ju lutem, ekzistojnë shumë sharra apo gereta, siç quhen, jo vetëm që nuk janë të regjistruara, punojnë në mënyrë ilegale.

Të nderuar deputetë,

Pronarët e tyre, me përgjegjësi të plotë do të them, janë të lidhur edhe me pushtetin lokal, por edhe me pushtetin qendror, ndërsa ka qenë shumë, shumë problem pengimi i tyre deri më tani. Nuk po flas për njerëzit që shkojnë, sepse në atë trevë, ata që i njohin, pyjet kanë qenë edhe për nevojat personale dhe për jetesë njerëzit i kanë shfrytëzuar. Nuk po flas për ata njerëzit që shkojnë për nevoja, ndërsa e shesin ndonjë metër kub, edhe ata në mënyrë ilegale, por ne sot duhet të debatojmë për njerëzit që me tenderë, të ligjshëm e të paligjshëm, me kamionë të ndryshëm edhe në formë, e në bashkëpunim edhe me policinë, unë e kam cekur edhe atëherë, edhe sot po e them, në bashkëpunim me policinë dhe njerëzit e institucioneve, pyjet e Deçanit janë shkatërruar. Këtë ia kam thënë edhe ministrit edhe këtu në Parlament, ia kam thënë edhe shumë sinqerisht në bashkëbisedim.

Për hir të qytetarëve të asaj treve, duhet të merren masa më radikale. Nuk është në pyetje Ligji, në pyetje është se nuk funksionojnë ligjet e sigurisë. Rojet e pyjeve në Deçan dhe rrethinë janë hajna të malit dhe nuk e di se si do të mbrohen aty pyjet dhe si do të mbrohet ajo natyrë të cilën e ka dhuruar Zoti.

Ne sot po flasim, me të vërtetë, unë e thashë, këto konkluzione që i ka dhënë Komisioni edhe në bashkëpunim me ata, këto ekzistojnë, të nderuar deputetë. Duhet të merren masat. Këto vetëm ekzistojnë, ndoshta këto janë sa për sy e faqe që ne sot ta kemi një seancë ose të themi që po bëjmë, po debatojmë diçka. Unë thashë edhe një herë, atje nuk ka më çka të mbrohet, nuk ka pyje, pyjet janë të shkatërruara totalisht. E kam thënë edhe këtu, pyjet janë djegur qëllimisht, në atë vend ku janë djegur ka dalë tenderi, ndërsa janë prerë edhe pjesët e tjera. Për këtë mundet ministri që të formojë Komision hetimor, nuk është e keqe edhe t'i kthehet mbrapa se kush i ka bërë ato dhe t'i qesë para aktit të kryer dhe ata ta marrin dënimin e merituar.

Ne emër të Grupit Parlamentar, ne i mbështesim këto propozime të Komisionit edhe pse, po them, këto ekzistojnë, ekziston ligji, në ligj ceken të gjitha, ekziston Plani i Ministrisë për mbrojtjen e atyre pyjeve, por ne kërkojmë që të merren masat, të forcohet ligji, të forcohen institucionet që duhet të vihen në mbrojtjen e tyre sepse, po ndërlihem edhe me çështjen paraprake, derisa shkatërrohet një trevë e tërë, nuk po reagon as Ombudspersoni, as instancat e tjera, sepse nuk po prehet, se po të prehet ndonjë, vetëm një degë e një peme të prehet afër zonës së mbrojtur të Manastirit, edhe në OKB do të debatohet. Ndërsa ne, për atë çka e kemi jetike, çka sot në Komunën e Deçanit mungon edhe ujë, që është për t'u çuditur, kjo ndodhë nga prerja ilegale e pyjeve dhe shkatërrimi i saj treve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Riza Smaka, me kartelën e deputetit Ibrahim Gashi.

RIZA SMAKA: Siç tha kolegu i nderuar, Xhavit Haliti, mendoj se nuk ka nevojë për komente plotësuese. Mjerisht, nuk është fjala vetëm për Deçanin e rrethinën, por se për krejt Kosovën kudo që ka pyje, ato shkatërrohen pamëshirshëm në mënyrë më vandale, tepër të dëmshme për ekokulturën.

Unë e kam pas ngritur një pyetje kuvendore dhe mjerisht nuk kam pas marrë kurrfarë përgjigje, do të thotë neglizhencë ndaj pyetjes kuvendore të deputetit, që do të thotë

ekzekutivi nuk e përfillë vullnetin e popullit. Nuk është në rregull absolutisht dhe nuk mund të kalojë, si me thënë, e pagjykuar, e pandëshkuar.

Ju lutem, druri si dru, krijon oksigjenin që është burim vital për jetë, prodhon ujë, rezervon ujë, një ah deri në 80 litra, po e zëmë, hormoqi që quhet, dru halor, mbi 120 litra, e tjera, e tjera. Kur po priten këto, që po priten sistematikisht, pa kurrfarë kontrolli, në mënyrën më vandale, natyrisht, përpos tjerash, po shterin gurrat, burimet e ujërave, edhe erozioni. Edhe në Dukagjin shprehet shterja e ujërave si pasojë e prerjes së drurëve nëpër bjeshkët e Kosovës.

Unë kam pasur rast ta di këtë fakt. Në vendet e përparuara, po e zëmë, druri që është pranë shtëpie, që është pronë private 100%, nuk mund të pritët pa lejen e autoritetit dhe duhet ta pritët sipas rregullave të prerjes, duhet të mbillet fidani në vend aty dhe, kur të nxënë fidani, mund të largojë atë trupin prej aty.

Ju lutem, Kryetar i nderuar dhe kolegë shumë të respektuar, na duhet të vejmë polici pyjore, polici pyjore, në ligj, polici pyjore, që do të thotë, polic, po e zëmë, po qe se do isha, do duhej të kisha një edukacion për pyllin, për rëndësinë e pyllit. Përderisa nuk e bëjmë këtë, e kjo mendoj se është çështje shumë e ngutshme, duhet me një dokument juridik të autorizojmë, te obligojmë policinë tonë civile publike që të ketë autorizime dhe obligime për të ndërmarrë masa kundër uzurpatorëve, abuzuesve, plaçkitësve të pyjeve tona.

Unë kam pasur rast t'i shoh vetë policët, tre policë ishin, datën e ditën e di etj. Ejt. Katër kamionë me trupa nga 10 -12 kubikë, dhe ju them, pse bre nuk ndërmorët masa? – “Nuk është punë e jona”, thanë, kurse unë isha civil, nuk kisha autorizim.

Zotëri Kryetar, këtë çështje mendoj se duhet ta marrim si tepër serioze dhe ta radhisim në agjendën e punës tonë e t'i bëjmë disa dokumente që i kemi. Ekziston Ligji për pyjet, është një Ligj mjaft i mirë, natyrisht nuk është më i miri, mirëpo po qe se ai Ligj duhet të përfillej, nuk do të shkakttoheshin këto pasoja.

Tash shtrohet pyetja, pse nuk zbatohet Ligji? Do të duhej të ndërmerreshin masa, ju lutem Abinicio, prej më të parit që është i obliguar deri te abuzatori dhe uzurpatori. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Sipas radhës, Grupi Parlamentar i AAK-së. Fjalën e ka Ibrahim Selmanaj.

IBRAHIM SELMANAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Po flasim për një temë të ndjeshme që janë pyjet dhe ka rastisur që Komisioni Parlamentar me insistimin që ka pasur Kuvendi Komunal i Deçanit, të bëjë një vizitë edhe ta shohim drejtpërsëdrejti se çka ka ndodhur dhe çka zhvillohet në atë trevë.

Realisht, në kontestin e përgjithshëm në Deçan janë përafërsht 19.000 hektarë pyje, që në përgjithësi janë 4% të pyjeve të Kosovës. Prerja e drurit në Deçan bëhet përafërsht 20% të masës së paraparë brenda vitit për shfrytëzim. Në këtë rast, i kam thënë edhe një herë kur ishte Ligji për pyjet, që e kthyem mbrapa, e kam lutur ministrin që me një udhëzim administrativ të ndërmarrë masa dhe të mos ketë më prerje të drurit.

Arsyeja është se me parashikimet që parashihen, qoftë nga autoriteti pyjor, qoftë nga Ministria për Bujqësi dhe Pylltari, brenda një viti janë të paraparë përafshisht 90.000 m³ dru të prehen dhe të shfrytëzohen në Kosovë. Kjo jep hapësirë me letra, që të prehet edhe sasi tjetër e pakontrolluar dhe një mundësi e keqbërësve, e keqpërdoruesve që ta dëmtojnë pyllin në sasi më të madhe.

Në këtë rast, përpos rekomandimeve që dalin nga kuvendi komunal, në pajtueshmëri të plotë edhe me komisionin parlamentar, unë shohë edhe një zhvillim negativ që bëhet tash në këtë mes, që është regjionalizimi.

Nëse flasim për Kaçanikun që ka hapësirë më të madhe të pyjeve, atëherë unë mendoj se emetime nuk duhet të shkojmë. Këtë radhë kemi një përparësi, sepse kemi ministrin që drejtpërdrejtë duhet të menaxhojë. Deri tash dihet se si kanë qenë Ministria për Bujqësi dhe Pylltari, për fat të keq, nuk e kemi pasur një stabilitet dhe nuk kemi pasur edhe dorë efikase në punë.

Problemi tjetër janë gjykatat, të cilat nuk marrin masa adekuate për keqbërësit dhe keqpërdoruesit dhe, prapë, çështje tjetër janë rojet e pyjeve, të cilat nuk kanë siguri.

Nëse i shohim komunat të cilat kanë përparësi me drurin teknik, me dru të lartë teknik, atëherë me regjionalizimin, që është bërë në qendra të mëdha, do të ishte një autoritet më shumë sikur Drejtoria Qendrore të zhvendosej pikërisht në zonat ku hapësirat janë më të mëdha me dru teknik. Në radhë të parë, rojet e pyjeve, që unë nuk them se janë hajna, por rojet e pyjeve i nënshtrohen një rreziku permanent dhe në vazhdimësi janë të rrezikuara. I vetmi autoritet që e ka trajtuar çështjen seriozisht në mbrojtje të pyjeve, është Policia e Kosovës. Masat të cilat do të jenë efikase, është që së paku për 5 vite të ndërpritet shfrytëzimi i drurit teknik dhe me një plan stabil, me një plan të qëndrueshëm, Ministria e Bujqësisë dhe e Pylltarisë në bashkëpunim me autoritetin pyjor, duhet ta bëjë pastrimin e pyjeve edhe atë në formën më të mirë, duke i shfrytëzuar të gjitha hapësirat edhe papunësinë e cila është mjaft e lartë në Kosovë, dhe në të njëjtën kohë t'ju krijohet edhe një mundësi më e lehtë qytetarëve përmes drurit të kontrolluar, përmes pastrimit të pyjeve, përmes drurit të thatë, që edhe ta shfrytëzojnë me çmim më të përshtatshëm, me çmim më të favorshëm dhe, në të njëjtën kohë, edhe një mundësi tjetër, që me ato mjete të cilat grumbullohen, të bëhet ripyllëzimi, sepse dëmin më të madh vitin e kaluar e ka shkaktuar zjarri dhe këtu është problemi më i madh që do të ballafaqohemi në vitet në vijim.

Prapë po e përsëris, duhet të ndërmarrim masa adekuate, sepse është e mundur të □vokimi□et shfrytëzimi i drurit dhe nuk duhet harruar edhe një fakt tjetër se në Kosovë ka import shumë të lartë të drurit, që vjen edhe nga Mali i Zi, edhe nga Bosnja, dhe nuk kemi pse t'u frikohemi zhvillimeve dhe afaristëve tanë të cilët merren me përpunimin e drurit.

Thjeshtë, zoti ministër, duhet ta kuptoni dhe ta merrni shumë seriozisht këtë çështje, jo vetëm Deçani, por të gjitha pyjet e Kosovës, dhe realisht, unë si deputet dhe qytetar nuk jam i kënaqur me punën që e keni bërë si ministër në këtë kontest dhe të jeni shumë të sigurt se do ta keni mbështetjen tonë në të gjitha ato mese ku mund të veprojmë. Prapë po e them me përgjegjësi të plotë, edhe politike, edhe profesionale, sepse kemi mjaft ekspertë, të cilët duhet t'i fusim në punë me një plan konkret. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit, deputet Selmanaj!
Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka kërkuar deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Më në fund, po diskutojmë për një çështje shumë të rëndësishme për qytetarët e Kosovës, për mbrojtjen e pyjeve të vendit tonë që janë të garantuara edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në nenin 122, paragrafi 2, që këtë kategori të pasurive nacionale të vendit, e radhitë në atë të rëndësisë së veçantë ekonomike dhe ekologjike dhe që gëzon mbrojtjen e tyre të veçantë, do të thotë, në pajtim me ligjet në fuqi.

Por, si është gjendja aktuale në pyjet e Kosovës? A po përkujdeset dikush për këto pasuri kombëtare të vendit tonë? Çfarë po bën Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe mekanizmat institucional kompetent të kësaj fushe? A ka strategji Qeveria dhe Ministria që t'i shpëtojë pyjet e Kosovës nga shkatërrimi masiv, degradimi dhe papërgjegjësitë e keqbërësve, duke filluar nga institucionet qendrore kompetente dhe strukturave të tjera që po vazhdojnë të bëjnë gjenocid ekologjik me vetëdije në pyjet, natyrën dhe resurset natyrore me rëndësi të veçantë nacionale.

Gjendja aktuale në pyjet e Kosovës është më tepër se shqetësuese, me tendencë të eskalimit në katastrofë ekologjike dhe që, fatkeqësisht, këto trende po vazhdojnë me dijen dhe pëlqimin e atyre që Ligji dhe Kushtetuta i obligojnë që t'i mbrojnë ato.

Grupi Parlamentar i LDD-së ka shqyrtuar me vëmendje rekomandimin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, i cili konstaton shkatërrimin dhe degradimin e pyjeve në regjionin e Rrafshit të Dukagjinit, me theks të veçantë në Komunën e Deçanit. Për ne si Grup Parlamentar, por edhe për qytetarët e Kosovës, kjo gjendje është e papranueshme dhe vazhdon të mbetet brengë heshtja e vazhdueshme e institucioneve kompetente që nënkupton miratimin dhe vazhdimin e degradimit dhe të prerjeve ilegale të pyjeve të Kosovës nga ana e keqbërësve.

Pasojat e këtyre veprimeve, apo më mirë thënë, të mosveprimeve të institucioneve kompetente që keqbërësit të ndalohen, do të lë pasoja të mëdha për breza të ri të Kosovës, të cilëve po iu shkatërrohet pa të drejtë, në mënyrë të pamëshirshme pasuria kombëtare dhe mjedisi jetësor.

Zoti ministër i Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural, Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ju jeni biolog me profesion dhe e dini mirë se sa vite duhet të kalojnë që të rritet një dru për përpunim teknik. Duhet të kalojnë vite, sigurisht. Po, shkatërrimi i sipërfaqeve të tëra të pyjeve, shkatërron ekosisteme të tëra dhe ju i dini mirë pasojat për mjedisin jetësor.

Përderisa vendet bashkëkohore objektivat e tyre kryesore i orientojnë në ruajtjen e natyrës dhe të ambientit jetësor, fatkeqësisht te ne po ndodhë e kundërta. Qeveria e juaj e ka marrë mandatin që 10 muaj dhe gjendja në pyjet e Kosovës po keqësohet dita ditës. Edhe në programin tuaj qeveritar, pyjeve ju keni kushtuar vëmendje minore. Ja se çka shkruan në atë program: “Përmirësimi i menaxhimit të burimeve natyrore përmes pyllëzimit për herë të parë në tokat bujqësore me vlerë të ulët të prodhimit bujqësor,

përmirësimet në biodiversitetin, pyjet ekzistuese, dhe zbatimi i skemave të mbrojtjes të natyra 2000”. Tre rreshta abstrakt pa kurrfarë kuptimi dhe pa asnjë masë preventive për mbrojtjen e pyjeve.

Shkatërrimi i pasurive kombëtare, të pyjeve të vendit tonë, në të cilat ndodhen vendet më të bukura turistike të Kosovës, siç janë: Bjeshkët e Deçanit, Bjeshkët e Rugovës dhe Bjeshkët e Istogut, është i pafalshëm dhe është i dënueshëm.

Sipas një studimi të ekspertëve vendor dhe SID-as suedeze, organizatë kjo që ka ndihmuar shumë në këtë aspekt, në pyjet publike përafërsisht planifikohen diku rreth 543.013 m³, nga të cilat dru teknikë 236.825 m³, dru për djegëse 306.187 m³. Nëse druri teknik llogaritet 30 euro për m³, dhe ai i djegies vetëm 10 euro për m³, atëherë buxhetit të Kosovës do i vinin të hyra rreth 10.166.000 euro, por fatkeqësisht në vit, sipas informatave të ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtar, inkasohen vetëm 1.2 milion euro. Këto shifra flasin shumë dhe hapin shumë dilema për drejtësinë kosovare, sigurisht. Por, sipas këtij studimi, prerjet ilegale të pyjeve publike janë llogaritur në 549.833 m³. Kur këto llogariten me çmime minimale dhe nga ato që u thanë më lartë, Buxheti i Kosovës i humbë rreth 20 milionë euro në vit dhe kjo sigurisht që nuk do koment, por njëherësh tregon edhe fitimet marramendëse të keqbërësve.

Vetëm një shembull. Pas një fushate të prerjes së pyjeve në malet më të mira që i ka Komuna e Istogut, këta keqbërës organizojnë një piknik në ato vende ku e kishin shkatërruar atë ekosistem dhe, që të jetë tmerri më i madh, në atë drekë marrin pjesë krerët më të lartë të shtetit, bashkë me përfaqësuesit e Pushtetit Komunal të Istogut dhe pjesëtarë të Policisë së Kosovës. Këtu është një zinxhir i shkatërrimit masiv dhe i përfitimeve marramendëse të keqbërësve të lidhur me pushtetin, të nderuar kolegë dhe të nderuar anëtar të Kabinetit qeveritar. Mund ta vërtetoni, po të vini ta pini një kafe në Istog dhe të shihni se nga 30 kamionë brenda natës, përcjellë nga veturat e policisë, e presin pyllin dhe e dërgojnë në vende të caktuara dhe, lëre që dëmtohet buxheti, po tragjedia më e madhe është që po ua shkatërrojnë mjedisin jetësor brezave, brezave të ri dhe brezave që vijnë dhe kjo është e pafalshme.

Ne si Grup Parlamentar përkrahim rekomandimet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim, Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe duhen masa preventive emergjente, sepse edhe ashtu jemi shumë vonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet Rugova!

Në emër të Grupit “7+”, fjalën e ka kërkuar deputeti dhe anëtari i Kryesisë, Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala vam gospodine predsjedavajući!

Dozvolite da pozdravim i iministre i kolege poslanike, i mislim da je zahtevom Komisije za poljoprivredu u minut do dvanaest pokrenut još jedan problem koji pogadja ne samo interese gradjana, nego narušava i biološku ravnotežu, kao što smo govorili nedavno i u slučaju Prevalac.

Šume su, gospodo, pluća naroda. U zemljama koje imaju tradiciju zaštite ambijenta i prirodnih bogadstava, nekontrolisana seća šuma spada u najveća kriminalna dela koja su pod udarom zakona. Takodje, prilikom odredjivanja redovnog čišćenja šuma, strogo i veoma stručno se vodi računa kako se seku i koja se stabla seku. U njima se najprije

zasade nova stabla, a kada se zato donese dokaz, tek onda se dozvoli seća, odnosno čišćenje.

Znamo koje su posledice i već su kolege govorili o posledicama nekontrolisane seće šuma. Bujice, stihije, promena klime, narušavanje hidrografije i tako dalje, da ne nabrajam. Stručnjaci znaju, gospodo, tačno koliko jedan hektar šuma u transpiraciji može da potroši takozvane, jel da, prašine koja se stvara radom ili u industriji, i tako dalje.

Mi ovde o tome slabo vodimo računa. Nedavno smo, gospodo, u prizrenskom kraju imali veoma masovan protest jednog sela, koje se zove Nebregoste, i o čemu sam ja upoznao i gospodina ministra Poljoprivrede, a potom i gospodina generalnog direktora Šuma Kosova, pa smo jednom prilikom zajedno posetili područje seće šume, i na moju opasku da i sami milicioneri, policija, dakle o čemu su i kolege govirili, često učestvuju u tom nelegalnom prevoženju nekontrolisano seće drveta, meni je direktor nacionalnog, odnosno Šumskog gazdinstva Prizrena rekao: „Pa znate šta, i milicioneri imaju pravo i policija da učestvuju u tenderisanju, pa i vi kao poslanik imate pravo, niko vam ne može to zabraniti“. Zimislite, koji su to izgovori, ili ja bih rekao koji su im argumenti na primedbe da treba voditi računa o seći šuma. Što je najgore, najviše šume seku na Kosovu oni koji trba da je čuvaju. To vam je od prilike kao da ostavite zeca da čuva kupus. Zamislite, koju situaciju imamo, i umesto da se mi ovde, gospodo, bavimo problemima kako da zaštitimo, recimo velike gradove, kao što Priština ili Prizren, pošumljavanjem, stvaranjem novih parkova i tako dalje, mi se bavimo evo posledicama koje imamo veoma izražene, posebno nakon rata na Kosovu.

S toga, gospodo, još jednom mi u Parlamentarnoj grupi „7+“ podržavamo inicijativu Komisije za poljoprivredu i učinimo sve da se na institucionalan način donesu neka zakonska akta, podzakonska akta o trenutnoj zabrani seća šuma, a da u tome, u njihovoj zaštiti učestvuju i meštani pojedinih sela, jer se sećom šuma veoma često seće i njihova privatna imovina. U to ime, evo, dakle, naša Parlamentarna grupa još jednom zahvaljuje inicijataivi Komisije za poljoprivredu i apeluje na ministra za Poljoprivredu da vrlo ozbiljno uzmemo u obzir sva ova dešavanja negativna, koja nisu samo u Dečanima, nego i na drugim prostorima Kosova. Hvala ljepa!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të grupit SLS, shefi i Grupit nuk është këtu, nuk është paraqitur askush. Kalojmë tek diskutuesit, deputetët që janë paraqitur për diskutim.

Fjalën e ka deputeti Eset Cakolli, le të përgatitet deputetja Sanije Alijaj.

ESET CAKOLLI: I nderuari kryesues!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Pyjet me Ligjin 2003/3 janë resurse kombëtare dhe ato duhet të menaxhohen në atë mënyrë që to ofrojnë rendimente me vlerë dhe në të njëjtën kohë të ruhet biodiversiteti për të mirën e gjeneratave të tanishme dhe të gjeneratave të ardhshme.

Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim, Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, pas pranimit të ankesave dhe të shqetësimeve të shumta lidhur me gjendjen e rëndë të pyjeve në përgjithësi në Kosovë, e në veçanti në Komunën e Deçanit, vendosi që të shkojë në terren dhe të njoftohet për së afërmi me këto çështje të ngritura.

Vizita e Komisionit Parlamentar në Komunën e Deçanit është realizuar më 14.07.2008 dhe pas takimit me strukturat udhëheqëse të Kuvendit Komunal të Deçanit, përfaqësuesit e Shërbimit Policor dhe të Trupave Mbrojtëse të regjionit të Pejës dhe të Deçanit, Komisioni parlamentar, për fat të keq, ka konstatuar se gjendja e pyjeve në këtë komunë është shumë e rëndë dhe me tendencë të degradimit masiv, si rezultat i prerjeve ilegale të pyjeve, do të thotë se atje është një gjendje e cila nuk bën të lejohet të vazhdohet më tutje.

Komuna e Deçanit ka një sipërfaqe me pyje mbi 17.000 hektarë dhe me një rritje të madhe vjetore të masës drunore dhe kjo ka një rëndësi të veçantë në zhvillimin ekonomik të kësaj komune por, për fat të keq, këto pyje viteve të fundit i janë ekspozuar një eksploatimi jo të mirë, si nga ana e prerësve ilegal, po ashtu edhe nga një menaxhim joprofesional, ku tani gjendja e këtyre pyjeve është duke shkuar drejt një degradimi në Komunën e Deçanit. Mirëpo, këto degradime të pyjeve, viteve të fundit po ndodhin edhe në tërë territorin e Kosovës. Me këtë rast dua të përmendi edhe Komunën e Ferizajit, pyjet e Jezercit. Nëse vazhdon prerja me këtë dinamikë, shumë shpejt nuk do të ketë më nevojë për menaxhim, sepse nuk do të ketë çka të menaxhohet më atje.

Sipas Ligjit 2003/3, nenit 7, pika 1, 2, 3, është paraparë se kush menaxhon me pyjet e Kosovës. Gjatë diskutimeve të të pranishmëve që u shfaqën shqetësimet nga më të ndryshmet, që kanë ndikuar dhe po ndikojnë edhe sot në dëmtimet e pamëshirshme në pyjet e Komunës së Deçanit, unë dëshiroj t'i ceku vetëm disa prej tyre që pata rastin t'i dëgjoj atje.

Agjencioni i Pyjeve nuk ka një plan afatgjatë për menaxhim të pyjeve të Kosovës, që është e paraparë me nenin 17 të Ligjit për pyjet. Do të thotë, moszbatim i Ligjit për pyjet e Kosovës, të Ligjit 2003/3, mosndëshkim adekuat i personave që bëjnë prerjet ilegale të pyjeve nga ana e gjykatave, do të thotë, nuk zbatohet si duhet Ligji, neni nr. 36.

Përfaqësuesit e Agjencionit të Pyjeve nuk marrin pjesë në seancat gjyqësore me fletëparaqitjet e dokumentuara për keqbërësit apo prerësit ilegal të pyjeve.

Përfaqësuesit e Komunës së Deçanit i njoftuan anëtarët e Komisionit edhe për përpjekjet e tyre të vazhdueshme për ta penguar këtë dukuri jo të mirë dhe kishin hartuar një strategji me propozime konkrete për ta përmirësuar situatën në terren, që unë personalisht mendoj se janë propozime të drejta dhe të zbatueshme, mirëpo kërkohet nga të gjitha institucionet relevante t'i mbështesin për implementimin e këtyre propozimeve. Por, megjithatë, Komisioni Parlamentar, në bazë të informatave të marra në terren, del me rekomandimet konkrete me qëllim të pengimit të dëmtimit të pyjeve, jo vetëm në Komunën e Deçanit, por edhe në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Këto rekomandime i kanë marrë, mendoj edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës, prandaj edhe unë si anëtar i Komisionit dhe në emër të Partisë Aleanca Kosova e Re, i përkrahim Rekomandimet e Komisionit Parlamentar. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet Cakolli! Fjalën e ka deputetja Sanije Alijaj, le të përgatitet deputetja Elheme Hetemi.

SAANIJE ALIJAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar ministra,
Të respektuar deputetë,

Vizitën e komisionit funksional në mjediset e caktuara e kuptoj si pjesë të detyrave dhe të përgjegjësisë që i ka.

Rekomandimet e ofruara nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me gjendjen e pyjeve në Kosovë, e veçanërisht në pyjet e Deçanit, janë zëri i arsyes për të ndërmarrë masat për ndaljen e hovit të kësaj dukurie që shkatërron pyjet e Kosovës.

Konsideroj se një pjesë të përgjegjësisë për gjendjen e krijuar në pyjet e Kosovës, e mban ish Ministria e Mjedisit dhe ajo e Bujqësisë, të cilat krijojnë situata kundërtshënës për kompetenca gjatë miratimit të Ligjit për mbrojtjen, ruajtjen dhe zhvillim të pyjeve në Kosovë.

Këto kundërtshënës, jo vetëm që ngadalësojnë miratimin e ligjeve, por përveç kësaj ngadalësojnë edhe formimin e mekanizmave përkatës që mbikëqyrin ruajtjen e kësaj pasurie kombëtare, si në nivelin lokal, ashtu edhe në atë qendror.

Këtij problemi, Komisioni funksional për Bujqësi, edhe atëherë, edhe tani, është dashur me kohë t'i qaset, të bëjë monitorimin e ligjeve përkatës për mbrojtjen e pyjeve. Por, edhe pse me vonesë, i përshëndes këto rekomandime që shumica prej tyre janë edhe në ligje, sepse konsideroj se deri diku do t'i ndalet hovi këtij krimi të organizuar edhe masiv.

Shteti i ri i Kosovës, përkatësisht institucionet e tij, kanë katër funksione kryesore në këtë drejtim: rregullator, mbikëqyrës, përfaqësim në pronë dhe mbështetje.

Funksioni rregullator përfshin bërjen e politikave dhe miratimin e ligjeve, përfshin këtu edhe mbështetjen në zbatim.

- Funksioni mbikëqyrës përfshin krijimin e sistemeve që sigurojnë implementimin e ligjeve.

- Funksioni i pronësisë përfshin menaxhimin e pyjeve në pronësi të shtetit, dhe

- Funksioni mbështetës përfshin aktivitetet financiare të ndërmarra nga institucionet e shtetit për zhvillimin dhe mbrojtjen e pyjeve.

Fatkeqësisht, asnjëra nga këto funksione nuk janë zbatuar në masën e duhur, prandaj prerja e pyjeve bëhet në mënyrë të pakontrolluar nga qytetarët e pandershëm. Prandaj, zoti ministër i Bujqësisë, të keni këto funksione prioritet shumë urgjent të punës suaj.

Me këtë rast, propozoj të themelohet fondi i pyjeve, i cili administron fondet e fituara nga shitja e lëndës drusore në tokat pyjore, në pronësi shtetërore. Fondet të përdoren për mbështetjen e ripërtëritjes dhe zhvillimin e pyjeve, kërkimeve shkencore dhe edukimin e qytetarëve si dhe krijimin e shërbimit të kontrollit të pronarëve privat të pyjeve. Me këtë rast, prioritet t'i jepet edhe zhvillimit të turizmit malor.

Qeveria, përkatësisht Ministria për Bujqësi, ajo e Mjedisit dhe e Energjetikës, të hulumtojnë mundësinë e realizimit të ngrohjes alternative, të hartojnë planin strategjik të realizimit të sistemit të ngrohjes qendrore me lëndën e parë të thëngjillit që e kemi

pasur kombëtare, se përndryshe vështirë është të pengohet dëmtimi i pyjeve kur kjo realisht çdo ditë jetësohet para syve tanë.

Këtë fakt po e theksoj. Derisa Rusia e shtrinë sistemin e gazit pothuaj në pjesën më të madhe të Evropës, derisa për sistemet tjera të cilat jetësohen edhe në Kosovë, nuk lënë asgjë afaristët që kanë interesat e tyre personale, në radhë të parë, pse Qeveria e Kosovës nuk harton strategjinë e ngrohjes alternative.

Në fund, propozoj që Ligji për pyjet të riprocedohet në Kuvendin e Kosovës, dhe një pjesë e kompetencave t'i kalohen komunave, sepse ato në radhë të parë e kanë përgjegjësi dhe detyrë që të mbrojnë pyllin, por edhe ta pyllëzojnë pyllin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete Alijaj. Fjalën e ka deputetja Elheme Hetemi, le të përgatitet deputeti Hydajet Hyseni – Kaloshi.

ELHEME HETEMI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

U tha shumë çka lidhur me rëndësinë e fondit pyjor të Kosovës, pasojat nga degradimi, humbja në Buxhetin e Kosovës, e shumë çka nga deputetët të nderuar të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa për gjëra konkrete, se si të përmirësohet kjo situatë e krijuar, u tha shumë pak.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural ndodhet para një sfide shumë të madhe dhe mendoj se, si e vetme, nuk mund të dalë prej kësaj situatë.

Zoti Ministër, si baza më e fuqishme për të dalë prej një situatë të krijuar, unë mendoj se Ligji duhet të ndryshohet dhe të plotësohet. Prandaj, kërkoj edhe mbështetjen e juaj, deputetë të nderuar, sepse Ligji ka mangësi të mëdha.

Fondi pyjor i Kosovës, si pasuri kombëtare, nuk mund t'i besohet të administrohet nga një agjencion pyjor i Kosovës, si i vetëm. Fondi pyjor i Kosovës nuk mund të menaxhohet dhe të kontrollohet nga një bord dhe të gjitha këto janë të parapara me Ligjin që është në fuqi.

Fondi pyjor i Kosovës nuk mund të këshillohet apo Ministria, Agjencioni nuk mund të këshillohet nga një bord, ashtu siç është paraparë në Ligjin për pyjet, që është në fuqi.

Unë mendoj se rolin e administrimit të Fondit pyjor të Kosovës duhet ta ketë Qeveria e Kosovës, përkatësisht në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural. Unë mendoj se një pjesë e kompetencave, deri në masën sa nuk do të ndikonte në shkatërrimin dhe në degradimin e pyjeve ose në një formë tjetër do të ndikonte në mbrojtjen e Fondit pyjor të Kosovës, t'u kalohen komunave.

E thashë se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të jetë e pafuqishme të eliminojë barrierat që janë krijuar prej pasluftës. Unë mendoj se kërkohet një bashkëpunim i ndërsjellë ose bashkëpunim i përcaktuar me ndryshimet dhe plotësimet që do të bëhen në Ligj. Mendoj se këtu duhet të jetë e inkorporuar Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Ambientit të Planifikimit Hapësinor, komunat si institucione komunale dhe ajo çka është më e fuqishmja dhe preventiva më e mirë,

□vokim ose □vokimi me qytetarët e Kosovës, bashkëpunimi dhe mirëkuptimi i qytetarëve, sepse Fondi pyjor i Kosovës është pasuri e të gjithëve dhe garanton një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe për gjeneratat që vijnë.

U fol për krimin e organizuar dhe këtu mendoj se organet e Drejtësisë kanë një rol të fuqishëm dhe duhet të gjithë të jenë më serioz dhe të jenë më emergjent dhe rastet e shqyrtuara, shumë ankesa kemi edhe prej Agjencionit pyjor të Kosovës, Ministrisë të Bujqësisë, se organet e Drejtësisë nuk i marrin seriozisht ose nuk i shqyrtojnë një numër të madh të lëndëve.

Masat ndëshkuese edhe të atyre lëndëve që shqyrtohen, janë qesharake sa që nuk garantojnë mbrojtje të Fondit pyjor, ose nuk e marrin si serioze një çështje kaq të rëndësishme. Unë mendoj se të gjitha këto duhet të jenë të organizuara mirë, të menaxhuara mirë dhe të veprojnë me seriozitetin më të madh, në mënyrë që të përmirësojmë një gjendje kaq delikate dhe kaq të rëndësishme, siç është Fondi pyjor i Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete Hetemi! Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni, le të përgatitet deputetja Gjylnaze Sylja.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar zonja e zotërinj deputetë,

Duke ju përshëndetur, më lejoni që të përshëndes nismën dhe hapat e propozuar për një çështje shumë të ndjeshme dhe pajtohem shumë të ngutshme. Prandaj, mbështes edhe Rekomandimin e propozuar, por kam dy vërejtje, njëra formale, më shumë si sugjerim, por nuk po më duket në rregull që akti i Kuvendit të ketë një konstatim dhe një rekomandim dhe nuk di pastaj si të quhet, është konstatim, rekomandim, apo çka?

Ajo që është konsideruar si konstatim, praktikisht është hyrja, preambula e një akti dhe mendoj do të duhej të ishte ashtu. Ka rëndësi që edhe të standardizohet forma e akteve të Kuvendit. Edhe me Rregulloren, Kuvendi nuk nxjerr konstatime, së paku, dhe e dyta është pak më përmbajtësore. Në këtë pjesën që është quajtur konstatim, thuhet tekstualisht: “Gjendja është tejte e rëndë duke shkuar drejt një degradimi masiv, e tjera, si rezultat i prerjeve ilegale”, kurse në Rekomandimin, nën pikën 1, kërkohet që me vendim Qeveria të ndërpresë përkohësisht të gjitha aktivitetet legale. Si mund të interpretohet kjo, do të thotë, prerjet janë ilegale, kurse duhet të ndërpriten aktivitetet legale. Është e kuptueshme që këto aktivitete legale po keqpërdoren dhe po kthehen në diçka ilegale. Prandaj, propozoj që të thuhet edhe në pjesën e parë edhe në pjesën e dytë aktivitetet, nëse kjo duhet të jetë shprehja që është zgjedhur “legale” dhe ato “ilegale” edhe ato që janë kuazi legale, por janë abuzive, duhet të ndërpriten, por jo gjithçka duhet të ndërpritet dhe sidomos ato që janë ilegale duhet të ndërpritet.

Nëse më lejoni, zotëri ministër, duke e përshëndetur punën që bëni, në bazë të asaj që unë di, ka kthesa pozitive në Ministrinë tuaj dhe unë dua t'i lavdëroj dhe dua t'i mbështesë angazhimet tua. Natyrisht, për disa muaj nuk mund të ndërrohet gjendja në këtë fushë. Fenomenet për të cilat po flasim, janë fenomene që janë shtresuar në mandatin e mëparshëm dhe do kohë që të rregullohet.

Sugjerimi im është konform edhe e asaj që thanë të tjerët, që të mos lokalizohet vëmendja vetëm në një zonë të Kosovës. Fenomeni është serioz dhe është në gjithë

Kosovën. Ju sugjeroj që edhe ju të merrni rrugën, ta zëmë, dhe të shkoni andej kah Mareci, ta zëmë, rrugën Prishtinë-Gjilan, dhe këtë pjesën nga Aratana, Prishtinë-Artanë, Prishtinë-Dardanë, të shikoni Gollakun, Karadakun dhe do të shihni se është vërtet një gjendje alarmuese.

Mendoj që pos masave afatgjata, siç është kjo e Ligjit, se nuk ju merr kohë, mendoj duhet marrë masa urgjente, ndoshta edhe në bashkëpunim me ministritë e tjera, si me Ministrinë e Ambientit, të Rendit, etj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputetit Hyseni! Fjalën ia kalojmë deputetes Gjylnaze Sylaj, le të përgatitet deputetja Safete Hadergjonaj.

GJYLNAZE SYLAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Roli dhe rëndësia e pyjeve është e madhe, sepse pyjet e Kosovës janë resurse dhe pasuri kombëtare të rëndësishme për mbijetesën e njerëzve në Kosovë. Pra, janë burim i rëndësishëm i jetës, i ushqimit, ndihmojnë dhe mbrojnë dheun nga erozioni, mbrojnë nga vërshimet, bëjnë balancën e oksigjenit atmosferik, zbukurojnë ambientin natyror, por kanë rëndësi edhe për ekonominë, për prodhimet farmaceutike, prodhimin e letrës. Kjo, pra, qartë demonstroi vlerën ekonomike dhe mjedisore të pyjeve, prandaj debatin e sotëm, gjegjësisht shqyrtimin e Rekomandimit lidhur me gjendjen krijuar në pyjet e Kosovës, e mirëpres.

Unë, me shumë kujdes i kam shqyrtuar të gjitha rekomandimet e Komisionit dhe mendoj se fokusi qendror që ka të bëjë, është menaxhimi i pyjeve. Pra, problemi i prerjes së pyjeve është pasojë e keqmenaxhimit. Prandaj, besoj se pyjet e menaxhuara mirë, janë pjesë e zgjidhjes së qëndrueshme të këtij problemi. Edhe pse Komisioni është koncentruar kryesisht në pjesën e Deçanit, gjegjësisht në pyjet e Deçanit, e njëjta situatë është edhe në Rugovë, por edhe në Burim dhe në pjesët e tjera në Kosovë. Prandaj, mendoj se është dashur që Komisioni ta ketë një qasje gjithëpërfshirëse, të ketë një pasqyrë më të qartë në gjithë Kosovën, për arsye se edhe zgjidhja e cila do të propozohet, do të ishte zgjidhje gjithëpërfshirëse për tërë Kosovën dhe më e qëndrueshme.

Në bazë të Ligjit për pyjet, është e qartë se Agjencioni për Pyjet është mekanizmi ekzekutiv dhe përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e pyjeve, prandaj një rekomandim duhet të ishte funksionalizimi i plotë dhe përmbushja e detyrave që dalin nga ky Ligj i Agjencionit për Pyje, dhe këto do të ishin në mënyrë prioritare.

Një, është inventarizim i pyjeve publike dhe private dhe, dy, hartimi i planeve menaxhuese afatgjatë dhe i planeve pyjore operationale, si dhe hartimi i planit për ripërtëritjen e pyllit. Përveç që vazhdimisht ngjan shkatërrimi i pyjeve, jo vetëm në sektorin publik, por e njëjta gjë ngjan edhe në sektorin privat, është me rëndësi që të bëhet edhe ripyllëzimi.

Gjithashtu, Qeveria duhet të përpilojë regjistrin për lëshimin e licencave për prerjen e drunjve për transport të trungjeve, për përpunimin e produkteve drunore dhe kontrollin i licencave të lëshuara në pajtim me ligjin.

Njëri nga deputetët tha se duhet të ketë bashkëpunim edhe me sektorët e tjerë dhe, unë, plotësisht pajtohem se duhet të ketë një qasje multisektoriale, bashkëpunim me gjyqësinë, organet e rendit dhe Agjencionin e Pronës.

Konsideroj se Qeveria duhet që sa më shpejt të sjellë një raport të gjithëmbarshtëm për gjendjen e pyjeve në Kosovë, ashtu që edhe përmirësimi dhe veprimet të cilat do të merren, të çojnë kah përmirësimi. Mos të harrojmë që ne deputetët dhe të gjithë e kemi obligim të mendojmë edhe për gjeneratat e ardhshme që edhe ata të mund të disponojnë me resurse të cilat ne i gëzojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit deputete Sylja!. Fjalën e ka deputetja Safete Hadrqjonaj, le të përgatitet deputeti Shkumbin Demaliaj.

SAFETE HARERGJONAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,

Çdo nismë në drejtim të mbrojtjes së pyjeve konsideroj si shumë pozitive, nisur nga fakti se mbrojtja e pyjeve ka rëndësi si në aspektin ekonomik politik, por edhe atë ekologjik. Prandaj, me të drejtë, në Ligjin për pyjet, pyjet janë konsideruar si resurse kombëtare dhe ruajtja e tyre do të thotë ruajtje e biodiversitetit më të mirë të gjeneratave të tashme, por edhe të gjeneratave të ardhshme.

Këtë debat për gjendjen e pyjeve në Kosovë e vlerësoj si të dobishëm edhe pse po bëhet, ndoshta, për herë të parë, nga fakti se është në procedurë e sipër Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyje, nga fakti se mund të kontribuojmë që këto ndryshime vërtet ta pasurojnë Ligjin. Por, është vështirë që debati të jetë konstruktiv, bazuar në materialin që na është ofruar.

Ne kemi vetëm një procesverbal të një vizite që i është bërë komunës së Deçanit, pa asnjë të dhënë tjetër se çfarë ka ndodhur e po ndodh vërtet në pyjet e Kosovës, e në veçanti në regionin e Deçanit, që ka një sipërfaqe pyjore prej 16. 693 hektarësh.

A ka pasur shkelje ligji, sa janë dëmet, a kanë pasur këto dëme me masa përkatëse ndaj dëmtuesve, a është bërë përpjekje për shpëputjen e rrjetit të organizuar të keqbërësve institucional nga lartë - poshtë dhe nga poshtë - lartë, a është bërë ndonjë vlerësim për dëmet e shkaktuara nga prerja e pyjeve.

Pothuajse në të gjitha komunat e Kosovës ka pasur shkatërrime të pyjeve, por në Komunën e Deçanit kjo dukuri e shkatërrimit të pyjeve ka qenë më e theksuara dhe më shqetësuese.

Konsideroj se është shumë mirë që sot e diskutojmë këtë çështje, që me vite i ka shqetësuar qytetarët e Komunës së Deçanit dhe ata në vazhdimësi kanë shprehur revoltën e tyre për përmasat e dëmtimit të pyjeve nga prerësit legal dhe ilegal, për veprimet e pastudiuara mirë nga institucionet, për marrjen me çështje periferike të kompetentëve që ka reflektuar në solidarizimin me shkatërruesit e pyjeve, kuptohet nga organet kompetente, dhe shtimin e kësaj dukurie që rrezikon katastrofë ekologjike. E shtyrë nga shqetësimi i qytetarëve, në mandatin e kaluar kam ngritur këtë çështje në Parlament, që ka vu pak në lëvizje institucionet e atëhershme të drejtim pozitiv.

Ky debat konsideroj se do të kontribuojë në ndalimin e dëmtimeve legale dhe ilegale të drunjve halorë që ka vazhduar në kontinuitet nga grupet e organizuara mirë, që kanë mundur të korruptojnë segmente të caktuara dhe ky debat do t'i sensibilizojë organet kompetente që të shkëpusin zinxhirin e keqpërdoruesve institucional.

Në faqen e fundit të këtij materiali janë dhënë disa rekomandime të nxjerra nga komisioni i formuar në përbërje të ekspertëve të pavarur, përfaqësues të komunës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural, gjykata, Shërbimi Policor i Kosovës, e tjera. Dhe, unë i përkrah plotësisht këto rekomandime dhe mendoj se duhet bërë më shumë në drejtim të realizimit të këtyre rekomandimeve. Njëkohësisht, përkrah edhe rekomandimet të cilat janë dhënë nga Komisioni funksional për Bujqësi Pylltari, Zhvillim Rural.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural është duke bërë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyje. Prandaj, rekomandoj që të organizojë punëtori me ekspertë në nivelin qendror, por edhe në atë lokal, që ndryshimet të shkojnë në favor të menaxhimit më të mirë të pyjeve.

Të rishikohet mundësia e ndryshimit të centralizimit të kompetencave të menaxhimit vetëm nga niveli qendror. Të rishikohet mundësia e ndryshimit të mënyrës së kontrollit nga inspektorët, të ndryshohet pjesa e Ligjit ku lejohet sistemi tenderimit nga çfarëdo operatori ekonomik.

Me qenë se e kemi fjalën, nëse bazohem në material, për Komunën e Deçanit, atëherë unë nuk mund të them se nuk është bërë asgjë në këtë pjesë sa i përket mbrojtjes së pyjeve, por është në naivitete të kërkohet nga ajo gjendje e trashëguar të bëhen mrekullitë.

Ministria mendoj se ka bërë një punë të mirë që është duke hartuar Planin menaxhues 10 vjeçar për Njësinë menaxhuese LLoçan - Deçan dhe që është duke hartuar Planin menaxhues për Njësinë menaxhuese Kozhnje - Roshkodol, Ka bërë një punë të mirë në vendosjen e njësisë policore dhe është deri diku nën kontroll prerja ilegale në grykën e Deçanit, por duhet të bërë më shumë në vënien e një kontrolli edhe në grykën e Lloçanit.

Ndalimi i prerjeve të rregullta të halorëve sipas planit vjetor me vendimin e Qeverisë aktuale dhe dhënien e mundësisë ndërmarrjes “Gjeravica” të bëjë pastrimet fitosanitare, ku nga një vizitë që kam pasur në këtë ndërmarrje, kam vërejtur se kanë realizuar suksesshëm planin diku rreth 60%. Mendoj se ka reflektuar pozitivisht në zvogëlimin e prerjeve ilegale në komunën e Deçanit, por përkrah mendimin që të bëhet një kontroll strikt edhe në këtë ndërmarrje nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Mendoj se Ministria ka bërë një punë të mirë, megjithatë, që ka lejuar të bëhet furnizimi i familjeve me dru të zjarrit për dimër. Është shumë e rëndësishme që Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të shpejtojë në procesin e licencimit të sharrave përpunuese dhe të masës drusore dhe të vë nën kontroll këto punëtori, duke ditur se mbyllja e tregut për masën drusore ilegale do të thotë ndërprerje e prerjeve ilegale.

Në favor të mbrojtjes së pyjeve mendoj se do të jetë edhe incizimi i pronave, ashtu që të definohen pronat private dhe pronat publike, që definimi i këtyre pronave do të kontribuojë në një mënyrë edhe në shfrytëzimin më të mirë të tyre.

Meqenëse perspektiva e Komunës së Deçanit është turizmi, apeloj në nivelin qendror dhe atë lokal që të punohet më shumë në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës rrugore, që të hartohen projekte konkrete të arsyeshme që do të tërheqin investitorët vendorë dhe të jashtëm, të bëhet më shumë në zhvillimin e turizmit rural malor, të ketë një bashkëpunim serioz të nivelit lokal me atë qendror që t'i hapet perspektiva zhvillimit të kësaj komune që është një ndër komunat më të pazhvilluara të Kosovës. Faleminderit, për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është e deputeti Shkumbin Demaliaj, le të përgatitet Berat Luzha.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,
Kolegë deputetë,

Meqenëse jam banor i Komunës së Deçanit, prej nga vjen edhe nisma për rekomandimet që ka bërë Komisioni, që sot ka prurë këtë iniciativë në Kuvend, është tepër e vonshme, është absurde kur në Kuvendin e Kosovës diskutohet për një gjendje të tillë në fillim të dimrit, kur kanë përfunduar të gjitha aktivitetet rreth prerjeve ilegale dhe legale në pyjet e Kosovës. Tash majat e bjeshkëve janë mbushur me borë dhe i shohim prej së largëti.

Ministria në fjalë, përpos mundësisë që ka pasur edhe vitet e kaluara, edhe qeveritë e kaluara, edhe kësaj radhe asgjë nuk ka bërë lidhur me marrjen në mbrojtje të pyjeve dhe të kullosave e të bukurive natyrore, ku për bjeshkën në fjalë që po flitet sot, për Bjeshkët e Deçanit, do të thotë, përpos të gjitha pasurive të tjera, është e pasur edhe me histori nga historia jonë e kaluar e deri në historinë më të re të Luftës së UÇK-së për shkak se atje sot gjithçka shkatërron edhe erozioni, edhe tjerat mundësi që natyra dhe çështjet mbinatyrore mund të rrezikojnë edhe banorët e atjeshëm.

Vegjetacioni në ato pyje është shumë i madh. Për 10 vite nuk merret vesh hiq se çka është shkatërruar dhe çka nuk është shkatërruar, mirëpo marrja në mbrojtje është e domosdoshme.

Decentralizimi, që duhet ta bëjë me ligj Ministria adekuate, është forma më e mirë sepse, duke i shikuar pyjet 100 kilometra larg, nuk mund t'i mbrosh ato. Duhet t'u jepet mekanizmave komunal mundësi më e madhe që të mund të implementojnë ligjin. U fol sot shumë këtu lidhur me mundësitë çka mund të bëjë Ministria e Drejtësisë, Policia e të tjerët. 90% të lëndëve në Komunën e Deçanit, në Gjykatën për Kundërvajtje por edhe në Gjykatën Komunale janë pjesë e angazhimeve që kanë bërë punëtorët, rojet e pyllit dhe mekanizmat e caktuar, Policia e Kosovës. 90% e lëndëve që sot ekzekutohen në Komunën e Deçanit janë për degradimin, shkatërrimin, prerjen ilegale të pyjeve. Kush janë ata? Ministria në fjalë hap tenderë çdo vit dhe ajo mundësi i jepet çdo qytetari të Kosovës, është rregull e konkursit. Mirëpo, tenderët i fitojnë ata që nuk kanë asnjë njohuri se qysh prehet pylli, mirëpo edhe i koordinojnë me kënd duhet ta kryejnë punën bashkë dhe shkatërrohet gjithçka atje.

Prerjet ilegale, janë një numër shumë i vogël i prerësve ilegal që shkatërrojnë pyjet në Komunën e Deçanit, janë familjarë që për ekzistencë e presin pyllin, çka ju ka kushtuar edhe me fatalitet, kemi pasur edhe raste tragjike të vdekjeve shumë të shpeshta, që kanë ndodhur bile me dhjetra në dy vitet e fundit për shkak se, duke u ruajtur nga organet e rendit dhe rojat e pyllit, por edhe nga të tjerët, kanë gjetur basene shumë të rrezikshme, ku kanë shkuar për të prerë dhe gjithçka për ta ka përfunduar me fatalitet.

Rekomandimet e Komisionit. Jemi për secilin rekomandim, mirëpo në radhë të parë një iniciativë që ka qenë nga institucionet e Kosovës për shpalljen “Park nacional” të alpeve shqiptare ka dështuar. Kisha lutur që t’i rikthehet në Kuvend edhe Komisioni ta marrë në shqyrtim këtë çështje, por gjithmonë duke insistuar të mos preket prona private e njerëzve që kanë pasuritë e tyre atje, sepse majat e bjeshkëve, halorët ku janë, nuk janë pronësi private, dihet ku është regjioni privat edhe aktivitetet e tyre të jenë menaxhueshme, sepse e vetmja formë që mund t’i shpëtojë pyjet nga ky shkatërrim është vetëm shpallja “Park nacional”. Ne folëm dhe sot u shty edhe njëherë pika e rendit të ditës për një pjesë, ku nuk ka guxuar askush të merret me atë pjesë. Besojmë se duhet të jetë një përgjegjësi më e madhe e ministrit dhe e stafit të tij për shkak se deri më tash ia kemi dhënë të drejtën të shkatërrohet në mënyrë organizative dhe në mënyrë institucionale u krye ky krim i organizuar. Kemi vendosur një ministër që kurrë nuk ka dalë në punë, punën e kanë kryer aktorë të tjerë, njerëzit nuk kanë ditur çfarë aktiviteti duhet të bëhet, kështu që kjo është përgjegjësi institucionale, nuk është përgjegjësi individuale, mirëpo Komisionit i rekomandoj që ato bjeshkë të shpallen “Park nacional” edhe të mos merrem me elemente a janë hajna, a janë të besueshëm, a s’janë të besueshëm, sepse ne vështirësitë më të mëdha në Kuvend, vështirësitë më të mëdha në Kuvend i kemi me implementimin e ligjeve që i ka nxjerrë ky Kuvend, andaj mos të sjellim rekomandime në Kuvend për t’i implementuar ligjet. Është përgjegjësi e institucioneve, ne na mbetet a është implementuar ligji dhe për kënd duhet të merren masa për mosrespektimin dhe moszbatimin e ligjeve në Kosovë. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Berat Luzha, le të përgatitet deputeti Rasim Selmanaj.

BERAT LUZHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra të pranishëm, dhe deputetë të pranishëm në mbledhje,

Në fillim shpreh kënaqësinë time se që nga funksionimi i Kuvendit të Kosovës, që 7 vjet, për herë të parë është vë në rend të punës për shqyrtim gjendja në pylltari, edhe pse në këtë lëmi të rëndësishme ekonomike dhe mjedisore vazhdimisht ka pasur probleme të mëdha. Problemet janë të trashëguara vite dhe dekada me radhë. Komisioni për Pylltari i Kuvendit, duke qenë i shqetësuar për gjendjen në pyjet tona, më 14 korrik e ka vizituar Komunën e Deçanit, ku gjendja paraqitet më drastike se në komunat e tjera.

Kryetari i Komunës dhe stafi komunal, si dhe përfaqësuesit e policisë e të strukturave komunale, e kanë përshkruar gjendjen në pyjet e kësaj komune si kaotike, si shumë të rëndë, si gjendje e para shkatërrimit, si situatë alarmuese, si shkreterim i pyjeve, si degradim me përmasa të mëdha, si shfrytëzim i pakontrolluar, si dëme shqetësuese, e tjera.

Gjithashtu, zyrtarët komunalë kanë dhënë gishtin mbi menaxhimin e dobët të pyjeve, mbi keqmenaxhimin, mbi korrupsionin, mbi keqpërdorimin e pozitës zyrtare, mbi veprimet e klaneve dhe të mafisë edhe në këtë fushë.

Pyjet e Komunës së Deçanit, me afër 20.000 hektarë, ashtu si edhe pyjet e Rugovës, ato të Burimit, të Kaçanikut, të Ferizajt, e po thuaj të të gjitha komunave të Kosovës, janë sulmuar ashpër edhe sivjet, duke pësuar dëme të konsiderueshme dhe vështirë të riparueshme.

Prerjet ilegale në pyjet e komunës së Deçanit gjatë 2 vjetëve të fundit kanë marrë përmasa të mëdha. Kohëve të fundit sindromi i prerjeve ilegale është intensifikuar edhe në shumicën e komunave të Kosovës, kurse në shumë komuna mund të thuhet se më nuk ekzistojnë pyje të larta.

Krimi i organizuar i prerjes dhe i dëmtimit të pyjeve tashmë sikur ka marrë hov të pandalshëm, derisa organet shtetërore mbeten të pafuqishme kundrejt tij. Kriminelët futen pyjeve duke i masakruar me sharra motorike, me traktorë e me kamionë, por edhe të armatosur me automatikë si gangster të pyllit.

Viteve të fundit kemi rritje të prerjeve ilegale, madje ato janë më të larta se prerjet legale. Vetëm gjatë 5 viteve të fundit, vlerësohet të jenë prerë ilegalisht mbi 42.000 m³ dru, që është 11% e totalit të volumit të drurit të prerë.

Pos prerjeve ilegale, do me thanë, të vjedhjeve, pyjet dëmtohen edhe nga njerëzit të cilët janë të obliguar t'i ruajnë ato. Nga ata të cilët punojnë nëpër institucione, nga vjedhësit me letra, pra dëmet në pyje bëhen edhe nga zyrtarët përmes tenderëve dhe formave të tjera të cilat vetëm ata i dinë.

Nga ana tjetër, kemi funksionimin e sharrave, shumica dërmuese e të cilave nuk janë të licencuara. Kemi veprime të guroreve të shumta, të cilat pamëshirshëm dhe paligjshëm i gërryejnë dhe i gllabërojnë malet. Kemi ndërtimet pa leje, pa ligj e pa kritere edhe nëpër tokat pyjore, duke ua ndërruar atyre destinimin, madje edhe me letra.

Kemi dhënin me qira të pyjeve e të tokave pyjore me kontrata 10 vjeçare, kemi mungesën e theksuar të ripërtëritjes apo të pyllëzimit të sipërfaqeve të zhveshura e të pyjeve të dëmtuara.

Është e vërtetë se mbrojtja e pyjeve është detyrë institucionale mjaft e rëndë dhe e ndjeshme. Metodrat e vjetra të mbrojtjes së pyjeve nuk janë të mjaftueshme dhe nuk po japin efekte të duhura. Para së gjithash, rojet dhe inspektorët pyjorë duhet të furnizohen me mjete pune, me automjete të terrenit, me dylbi, me uniforma, por edhe me armë përkatëse, në mënyrë që të sigurohen sado pak nga hajdutët e armatosur të maleve.

Për mossuksesin e mbrojtjes së pyjeve, rol të madh kanë sigurisht prokurorët dhe gjykatësit, mosefikasiteti dhe neglizhenca të cilëve po kushton. Gjatë vitit, organet kompetente kanë paraqitur mesatarisht nga rreth 8000 fletëparaqitje, mirëpo ato tepër pak janë shqyrtuar dhe ekzekutuar.

Dëmtuesit nuk dënohen, në rastin më të mirë ata gjobiten me shuma simbolike edhe atëherë kur kapen në vepër dhe në vendin e krimit duke prerë apo duke bartur masë drusore të vjedhur. Çka është më keq, dëmtuesve nuk u konfiskohen mjetet e punës, si sharrat, kamionët apo traktorët.

Një fenomen mjaft i shpeshtë dhe me pasoja shumë të rënda është e djegia e pyjeve, fenomen i cili gjithashtu është shqetësues dhe alarmues. Djegiet e pyjeve janë një kapitull tjetër i veçantë në pylltarinë e Kosovës, por edhe të regjionit. Duhet thënë se sivjet, për fat, nuk kishte zjarre masive me përmasa aq të mëdha sikur viteve të tjera, por shënimet zyrtare ende nuk janë dhënë. Derisa vitin e kaluar djegiet e pyjeve, sipas shënimeve zyrtare, kapnin sipërfaqen prej afër 7000 hektarë, të vlerësuar me dëme prej mbi 13 milionë euro, sivjet sipërfaqet e djegura janë shumë të vogla.

Investimet për ruajtjen dhe kultivimin, do me thanë, për ripërtëritjen e pyjeve të bëra nga buxheti dhe nga donatorët, janë bërë vetëm këto 3 – 4 vitet e fundit, por ato nuk kanë qenë aspak të mjaftueshme.

Duke vlerësuar përpjekjet e fundit të Ministrisë, kujtojmë se ato nuk janë të mjaftueshme për përmirësimin e gjendjes së rëndë në pylltari. Ministria dhe Agjencia duhet të marrin masa të cilat do ta përmirësonin gjendjen ekzistuese. Çka duhet bërë? Duhet të hartohet sa më shpejtë një ligj i ri për pylltari. Ligji ekzistues është shumë i dobët dhe me pasoja për pyjet. Ky ligj i ka hequr kompetencat e komunave mbi pyjet dhe i ka lënë ekonomitë pyjore, si ndërmarrje të specializuara, jashtë ligjit. Komisioni shumë herë, qe 4 – 5 vite ka kërkuar nga Ministria të hartojë një ligj të ri apo të bëjë plotësim - ndryshimin e ligjit ekzistues, por deri tash nuk ka ardhur. Prandaj, kërkojmë një përgjigje që të bëhet ndryshimi apo hartimi i një ligji të ri ose Komisioni ta marrë përsipër bërjen e Ligjit për pyjet. Duhet të krijohet një task-forcë apo e një njësie të specializuar për mbrojtjen e pyjeve, së paku përkohësisht, për disa vjet të ardhme. Duhet të shikohet mundësia për ta formuar policinë pyjore, duhet koordinohen veprimet të strukturave shtetërore, si të Departamentit të Pylltarisë, të Agjencisë së Pyjeve, të Policisë, të Gjyqësisë, të Prokurorisë, të organeve komunale, e tjera. Duhet të organizohen dhe të funksionalizohen më mirë Agjencia pyjore dhe Inspektorati i pyjeve, duhet të mbikëqyren veprimtaria e sharrave dhe e përpunuesve të drurit.

Në fund, kujtoj se duhet të përkrahen rekomandimet e Komisionit për Pylltari. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Po ia japim fjalën deputetit Rasim Selmanaj, po e bëjmë një pauzë dhe e vazhdojmë punën pastaj në orën 12,30. A jeni dakord?

Urdhëro, deputeti Rasim Selmanaj!

RASIM SELMANAJ: I nderuari Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pas përfundimit të luftës dhe deri më sot, fatkeqësisht, nga institucionet e Kosovës ka pasur menaxhim joracional dhe dëmtim masiv të pyjeve, madje pa kurrfarë kriteri.

Në regjionin e Deçanit, si pasojë e politikave të gabuara dhe të keqmenaxhimit, masa drusore e evidentuar kap sasinë 70 mijë m³ në vit, kurse dëmet e paevidentuara janë shumëfish më të mëdha, krejt kjo sipas statistikave të mekanizmave kompetent. Kjo ka bërë që të zvogëlohet tej mase fondi pyjor, i cili do të ndikojë për një kohë të gjatë në përtëritjen e pyjeve të kësaj zone.

Edhe pse ligji për menaxhimin e pyjeve të Kosovës është aprovuar tash 5 vjet e gjysmë, pra në mars të viti 2003, ai fatkeqësisht nuk është implementuar asnjëherë deri më tani, duke u hapur udhë shkatërrueseve të pyjeve. Koha po dëshmon se ky ligj nuk është bërë në konsultim me ekspertët. Sipas burimeve mirë të informuara, në këtë ligj nuk janë futur sugjerimet e ekspertëve madje ato janë injoruar tërësisht.

Kjo situatë e rëndë në pyjet e Kosovës dhe kjo papërgjegjësi e institucioneve në raport me to tregon domosdoshmërinë e ndërhyrjes rrënjësore në ligjin përkatës. Shumë ekspertë e thonë dhe mendojnë se duhet shfrytëzuar përvojat e shteteve tjera në

tranzicion, me kushte përafërsisht të njëjta me tonat, që ta ripunojnë ligjin për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve.

Shembulli i menaxhimit të mirë të pyjeve nga regjioni janë: Sllovenia, Kroacia dhe Bosnja, mund t'i marrim përvojat e tyre, pse jo, ato nuk janë larg Kosovës.

Këtu do të propozoja ndryshimet në disa detaje, veçanërisht në pjesët e ligjit që kanë të bëjnë me silvikulturën, mbrojtjen e pyjeve dhe shfrytëzimin e tyre.

Meqë jam deputet nga ajo zonë e Deçanit, kam informata të besueshme se tash e disa javë në pyjet e Deçanit atje po ndodh një pastrim i vërtetë i pyjeve, kuptohet po flas për javët që lamë pas. Sidomos ky përmirësim vërehet pas vizitës së Komisionit parlamentar për Bujqësi dhe Mjedis dhe në mënyrë të veçantë pas një bashkëpunimi tepër të ngushtë të qeverisë komunale dhe të Ekonomisë pyjore. Pra, vërehen ndryshme pozitive.

Ata që deri dje konsideroheshin si dëmtues të pyjeve, sot punojnë vetëm në pastrimin e tyre. Kjo formë e menaxhimit, sidomos të halorëve në regjionet e pyjeve të Deçanit është treguar e suksesshme për arsye se janë zvogëluar dukshëm prerjet ilegale, sidomos në pjesët ku ka pasur invazion në dëmtimin e pyjeve, sepse të gjithë të interesuarit për punë në pyll, të cilët kanë pasur fuqi punëtore dhe teknologji, janë angazhuar dhe të njëjtin në mënyrë të disiplinuar dhe po thuaj se nën kontrollin e plotë të shërbimit profesionist të Ekonomisë pyjore dhe të ekspertëve të tjerë të APK-së dhe të Departamentit, i kryejnë punët dhe krijojnë të ardhura për familjet e tyre, pa pasur nevojë që në forma jo të rregullta e ilegale t'i kryejnë ato.

Është përmirësuar infrastruktura, sidomos kur është fjala për rrugët, të cilat kanë qenë të pakalueshme, urat e dëmtuara e që kanë qenë pengesë për qasje në pyje, sidomos për ekoturizëm. Situata ekzistuese e krijuar në javët që i lamë pas, megjithatë tregon se duhet gjetur mënyrë emergjente forma të reja për menaxhimin dhe të njëjtat forma duhet futur në ligj, duke e bërë një decentralizim të menaxhimit me pyje. Gjithashtu, do të duhej të formoheshin ndërmarrje publike analoge me ato të pyjeve në regjion, si në Kroaci, Slloveni, Maqedoni dhe në vende të tjera.

Shpresoj, se me këto konstatime, që nuk janë vetëm të miat, por edhe të ekspertëve, do të duhej të pajtoheshin edhe strukturat qeverisëse të nivelit qendror dhe ato të nivelit lokal, me qëllimin dhe interesin tonë të përbashkët për mbrojtjen dhe shpëtimin e pyjeve, të pasurisë sonë kombëtare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Tani i kemi 15 minuta pushim, pastaj vazhdojmë me diskutimet, sipas renditjes së paraqitur.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Para se të fillojmë debatin, shpresoj që po ju jap një lajm të mirë.

Shfrytëzoj rastin që në emrin tim, në emrin tuaj dhe të qytetarëve që i përfaqësojmë, që sot emisarit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Kosovën, presidentit të Finlandës, zotit Marti Ahtisari, t'ia urojmë Çmimin Nobel për paqe, duke i dëshiruar...

(duartrokitje)

...suksese të reja e shëndet atij dhe familjes së tij. Na gëzon fakti se çmimi u dha më shumë se për çdo gjë tjetër, edhe për përfundimin e suksesshëm që arriti për paqe, për procesin politik, për paqe dhe për pavarësinë e Republikës së Kosovës. Konsideroj se kjo është një fitore e shtetit të Kosovës për forcimin e njohjes ndërkombëtare të saj. Ju faleminderit për vëmendje!

(duartrokitje)

Vazhdojmë me rendin e ditës. Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli, le të përgatitet deputeti Mark Krasniqi.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Fatkeqësisht, çështja e pyjeve në vendin tonë nuk është trajtuar asnjëherë seriozisht dhe kjo flet më së mirë për përgjegjësinë apo, më mirë të them, për papërgjegjësinë tonë që kemi për këtë pasuri. Kosova dikur ka qenë mjaft e pasur me pyje të cilat dy decenie të fundit janë shkatërruar pamëshirshëm, madje edhe me ndihmën e atyre të cilët paguhen për t'i ruajtur ato.

I gjithë diskutimi dhe përqendrimi i këtij debati është përqendruar në pyjet e pjesës perëndimore të Kosovës, duke anashkaluar thuajse nuk janë pasuri e këtij vendi pyjet të cilat janë në shkatërrim nga prerjet ilegale, si për shembull, në rajonin e Llapit, të Gollakut e të Karadakut, të cilat i janë nënshtruar një shkatërrimi masiv.

S'duket, veprimi i institucioneve nuk shtrihet në këto pjesë ose ato llogariten si të huaja. Shpeshherë lexojmë se Inspeksioni ka konfiskuar dru të prera dhe kjo paraqitet si sukses, thua se pyjet ruhen në qytet, e jo aty ku janë. Është koha e fundit që institucionet të ndërmarrin veprime konkrete për ruajtjen e pyjeve e jo të merren me pasoja të tyre. Pyjet në Kosovë janë duke u shkatërruar në mënyrën masive dhe veprimi ynë është baras me zero. Raporti i Komisionit, edhe pse i kufizuar dhe i pjesshëm, megjithatë ofron rekomandime të cilat janë të mirëseardhura, por kam drojën se do të mbesin vetëm në letër për shkak të mungesës së politikave, të strategjive dhe të mekanizmave, jo vetëm për mbrojtje, por edhe për zhvillim të kësaj pasurie.

Jam shumë i bindur se edhe derisa ne po debatojmë për këtë pasuri, pyjet gjithandej Kosovës vazhdojnë të shkatërrohen. Krim ndaj një populli nuk është vetëm vrasja e tij, por edhe vrasja e ambientit, madje kjo paraqet krim të shumëfishtë me pasoja edhe për tashmen, edhe për të ardhmen.

Është më se e domosdoshme që të rishqyrtohet Ligji për pyjet dhe roli që po luan Agjencioni për Pyjet, që herë-herë ka arsyetuar këtë gjendje që ekziston sot me pyjet e Kosovës. Ndaj shqetësimin me shumicën e kolegëve që, nëse s'do të ketë veprim konkret e të menjëhershëm, atëherë s'do të kemi se çka të mbrojmë.

Madje, për fund, konsideroj se sa i përket gjendjes së pyjeve në Kosovë, mund të shpallet gjendja alarmante dhe e jashtëzakonshme. Konsideroj se edhe veprimet që duhet të jenë të ardhmen, duhet të jenë veprime që i dedikohen një gjendjeje të jashtëzakonshme në pyjet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Fjalën e ka deputeti Mark Krasniqi, le të përgatitet deputetja Vezira Emrush.

MARK KRASNIQI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ju përshëndes përzemërsisht Juve, ministrat dhe gjithë deputetët,

E dimë qysh më parë dhe gjithkush e di se pyjet janë një pasuri shumë e madhe natyrore që e ka, çdo vend jo, po ata që e kanë, duhet ta çmojnë, edhe e çmojnë dhe e kultivojnë. Madje, shtetet e përparuara me traditë të madhe të gjatë shtetërore dhe një kulturë të lartë, sigurisht të përgjithshme, ndaj këtyre pasurive dhe ndaj natyrës, në përgjithësi, kanë një kult, një kult të posaçëm ndaj tyre, kështu që edhe pronat private nuk mund t'i dëmtojnë kush në këto shtete, po them, jo te ne, se te ne bëhet gjithçka, jo gjithçka, po këtu rastësisht për pyjet e kemi fjalën. Shtetet e përparuara i kultivojnë këto dhe i mbrojnë, të cilat kanë, gjithashtu, pasuri të mëdha natyrore. Nuk e shfrytëzojnë pasurinë nëntokësore të veten, po e ruajnë, në përmasa të mëdha, kuptohet, por e blejnë në vende të tjera, e ruajnë për gjeneratat e ardhshme pasurinë që e kanë nën tokë. Pasuritë nëntokësore nuk kanë nevojë për mbrojtje, sepse e mbrojnë vetveten, edhe një mbrojtje e posaçme është me ligj e me të tjera, por pyjet mbitokësore, do me thënë, pasuritë mbitokësore, siç janë pyjet edhe bimët e tjera dhe toka pjellore, ato duhet të ruhen patjetër.

Ne e kemi një pasuri të madhe të pyjeve, jo vetëm në Bjeshkët e Nemuna. Të Nemuna, më falni, se pastaj ju tregoj, se nuk janë të Nemuna, por edhe në zonën fushore, sidomos në Rrafshin e Dukagjinit, shkojmë prej Prishtine deri në Pejë, shkojmë nëpër pyje gati deri në Klinë, ashtu edhe nga Prizreni nëse shkojmë, duhet deri në Suharekë të shkojmë nëpër pyje dhe gjithkund në vise të tjera kemi pyje të mëdha. Këto sipërfaqe të gjera me pyje, këto pyje janë krejtësisht të degraduara, këto të rrafshit që i përmenda, sepse fshatari ynë, katundari ynë nuk ka tjetër mundësi të ngrohet, ta kalojë dimrin ose të përgatit ushqimin, përveç me dru. Në vendet e zhvilluara, që i kemi parë prej aeroplanit, në qoftë se e shikojmë Zvicrën ose Gjermaninë, duket se i gjithë shteti është në pyll. Pse? Sepse i ruajnë me shekuj. Ata nuk kanë nevojë për dru, as katundari, as askush, sepse e kanë energjinë elektrike dhe ziejnë me te dhe ngrohen me te. Te ne mungon kjo edhe ne s'kemi çka të bëjmë ndryshe, vetëm me pyje të kalohet dimri ose të mbahet kuzhina e katundarit.

Mirëpo, këto pyje që i kemi ne në rrafsh, nuk janë as për industri, as për ngrohje, as për shfrytëzimin familjar. Janë shumë, shumë të varfra, janë shumë të holla, bile edhe e kanë emrin dushkajë, një krahinë e madhe është aty, një vis i madh në Rrafshin e Dukagjinit që quhet Dushkajë. Dushkajë. do me thanë s'ka pyje aty, megjithëse janë...

Dëmtimi i pyjeve, përveç këtyre që u përmendën këtu shumë herë, shëndeti, turizmi dhe të tjera, është një dëm shumë i madh. Erozioni, ku nuk ka pyje, reshjet atmosferike e zhveshin terrenin, sidomos terrenin që ka pjerrtësi, këto janë malet dhe ne do t'i kemi një ditë vetëm gurët ose shkëmbinjtë, asgjë tjetër, madje as barë as kullota në ato vende.

Kam dëgjuar, s'kam lexuar, por kam dëgjuar se në Gjermani, në kohën e nazizmit, bile, 1 milion punëtorë kanë qenë të angazhuar vetëm për mbjelljen e pyjeve dhe për ruajtjen e tyre, 1 milionë punëtorë. Prandaj, sot i keni këto pyje, jo vetëm në Gjermani, por edhe kudo në vende të tjera.

Ruajtja e pyjeve është një detyrë e madhe. Ne duhet ta edukojmë popullin, duhet ta edukojmë rininë shkollore, sidomos prej shkollës fillore deri në fakultet, për ruajtjen dhe

kultivimin e pyjeve, si një pasuri shumë të madhe popullore, të mos them shtetërore. Mirëpo, pyjet mund t'i ruaj vetëm rojtari, që është i aftë. Unë mendoj që duhet të krijohet, të formohet një polici e posaçme pyjore, ndoshta ekziston diku, por te ne nuk ma merr mendja. Ajo polici duhet të ketë autorizime. Policia e sodit, sot që e kemi policinë, kurrfarë autorizimesh nuk ka. Vinë policët, vetëm thonë ne kemi detyrë ta incizojmë këtë vend edhe t'ia japim prokurorit... Sa për incizim, e kemi fotografën, vjen më mirë dhe e fotografon, e shkon.

Prandaj, duhet, po them, një formacion i posaçëm policor, i cili ka, duhet të ketë ingerenca shumë të mëdha për t'i mbrojtur pyjet tona edhe kjo duhet të favorizohet bile, ky report, si të themi, i policisë.

Thashë se diku është krijuar edhe tradita, nuk thashë, por po e them, tradita ndaj pyjeve, tradita e kultivimit, madje njëfarë, si të them, vendi i shenjtë, vend që duhet të respektohet. Ne, edhe në traditën tonë popullore e kemi se kur shkon, për shembull, fshatari, rugovasi, t'i marrim, me sëpatë, me sakicë në krah në pyll, lisat thonë: "ishalla s'e ka me mua", do të thotë, "ishalla s'më pret mua". Prandaj, ekziston njëfarë nderimi i pyjeve, por duhet ajo të zgjerohet dhe të praktikohet në mënyrën e ruajtjes në mënyrë të organizuar.

U përmend këtu edhe emri i Bjeshkëve të Nemuna. Edhe njëherë e kemi pasur moti, ndoshta, në këtë Parlament, se katundari nuk di çka është Bjeshka e Nemun. Kurrë nuk e dëgjon t'i një katundar tonë, megjithëse e ka katundin rrëzë asaj bjeshke, të thotë: "këto janë Bjeshkët e Nemuna". S'ka Bjeshkë të Nemuna, bile këto bjeshkë që po i nënim ne kështu, pa nevojë, janë shumë të bekuara, se rrallë janë viset malore që e kanë këtë përparësi, ujë kanë mjaft, pyje kanë mjaft. Prandaj, është shumë e nevojshme t'ua ndërrojmë emrin. Këto e kanë emrin e vet, këto janë Bjeshkë Alpine. Bjeshkë Alpine, ky është një sistem, se njëherë e kanë kundërshtuar këtu këtë emër, gjëja se Alpinet janë në vende të tjera. Janë alpine në shumë vende, janë Alpet zvicerane, janë Alpet e Austrisë, e tjera, e tjera. Ne i kemi Alpet tona prej Liqenit të Shkodrës deri në Mitrovicë. Këtu është një sistem alpik, një sistem për shtrirjen e tyre, për ndërtimin gjeologjik të tyre dhe për pasuritë e tyre nëntokësore. Prandaj, e kanë marrë këtë emër, edhe në hartat e vjetra këtë emër e kemi -Alpet Shqiptare, jo Bjeshkët e Nemuna. Këto janë dhënë shumë vonë, kur s'kanë mundur të kalojnë ushtritë me armatim atje dhe i kanë varrosur aty në Bellopojë, afër Pejës.

Kështu, kisha për të thënë, ashtu sa për relaksim. Isha në Nju Jork një herë dhe një rugovas më ftoi për një natë atje. Jashtë Nju Jorkut e kishte një shtëpi dhe një oborr shumë të madh, pyje rreth e rreth, por midis oborrit e kishte një guri të madh, sa kjo selia e Kryetarit tonë, ndoshta edhe më të madh. Unë e pyeta, pse s'e heq këtë guri prej oborrit, e ai më tha: "Po, kam dashur ta heq, por ka ardhur policia dhe më ka thënë se këtë nuk guxon ta prekësh, se ky është pasuri e natyrës dhe e ka vendin e vet, shtëpia jote e ka vendin atje, guri këtu". Desha të them se duhet ne të përpiqemi që ta krijojmë një qëndrim krejt ndryshe ndaj pyjeve, se ky që e kemi sot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Fjalën e ka deputetja Vezira Emrush, le të përgatitet deputeti Naim Maloku.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala puno!

Pozdravljam Predsedništvo i cenjene kolege,

Danas mi ispred sebe imamo preporuku Komisije za poljoprivredu, koja praktično dolazi za mene sa velikim zakašnjenjem od punih 8. godina. Ovde na Kosovu se nalazimo u situaciji gde se na vandalan način na terenu vrši sistematsko uništavanje šuma i ostalih prirodnih bogastava posle rata. Znamo da je od 28. do 30. maja ove godine održana Svetska konferencija za očuvanje prirode i prirodnog bogatstva u Bonu. Na ovoj konferenciji bilo je prisutno 5.200 delegata, 120 ministara iz 190 zemalja. Kada se svet danas brine o sačuvanju globalne prirode i prirodnih bogatstva i kada sve danas izdvaja negde oko 30 milijardi eura za očuvanje i nastavljajanje prirodne vrste, mi na Kosovu uništavamo sve što nam je majka priroda podarila, a isto bogatstvo znamo da nam je jedini ivor za naš privredni razvoj.

Veliku posledicu vandalizma, kao što je masovna seča šuma u opštinama Dečane i Rugovi, potpomaže i sam Nacrt zakona o šumama, koji samo zadovoljava formu zakonodavstva, koji praktično nema nikakvu funkciju na terenu, a kao takav nema i implementaciju, i ako je usvojen pre punih 5 godina.

On kao mehanizam je centralizovan i sem Agencije za šume i Borda agencije, nema drugi instrument za sprovođenje na terenu. Sumnjam da se centralizacija praktično u zakonima na Kosovu i na svim nivoima ministarstava vrši svesno od strane pojedinih subjekata.

Mora se decentralizovati Zakon o šumama, mora se primeniti nadležnost da se spusti na opštine i opštinske jedinice, kao što su sela, koja su praktično ranije bila mesne zajednice opština, a istovremeno su bili i vlasnici nacionalnog bogatstva na ime svojih posedovnih listova gde je bila identifikovana svaka parcela i šuma na Kosovu, svaki seoski atar.

Imovina se najbolje čuva od strane onih kojima praktično geografski pripada. Mora Vlada Kosova da izdvoji potreban fond za obnavljanje i razvoj šuma u vidu raznih akcija pošumljavanja, da jedno stablo poraste, znamo daje potrebno 50 godina. Znači, moraju se decentralizacijom osnovati preko potrebna javna preduzeća, kao što su bila Šumska gazdinstva, koja će praktično menadžirati sećom i gajenjem šuma i koja će koordinirati sa opštinskom inspekcijom i policijom u slučaju prekršaja zakona o zaštiti šuma na terenu.

Radi definisanja šumske mafije, ova preduzeća su jako potrebna na Kosovu, gde isto javno preduzeće mora da ima i šumsku policiju, to jest svoje šumare. Fond šuma ćemo sačuvati tako što ćemo na terenu imati identifikovana licencirana pravna i fizička lica, koja će imati zakonsko pravo na korišćenje šuma izdato od strane ministarstva. Mora se hitno od strane Vlade i ministarstva napraviti akcioni plan, koji će staviti pod kontrolu dalje uništavanje šuma, tako sa posebnim zakonskim merama.

Veliki vandalizam uništavanja šuma, postoji takodje i na Šar planini, i Koritniku, te moramo ovu pojavu što hitnije da saniramo i sprečimo. Nikome na Kosovu ne koristi šumska mafija, koja se za sada ponaša neodgovorno, skrivajući se iza sumnjivih odobrenja i licenci koje poseduju i koja su izdata od strane ličnosti kosovskih nadležnih institucija, i koji su samo karika judi, koji se neosnovano bogate, uništavajući nacionalno bogatstvo buduće generacije na Kosovu.

Bogatstvo buduće generacije je u našim rukama. Vlada Kosova mora da obilazi zemlje u regiji kako bi sačuvala svoj integritet i svoje prirodno bogatstvo koje je karika za opstanak i ostanak budućih generacija. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Naim Maloku, le të përgatitet deputeti Gani Geci

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!

I nderuar, zotëri ministër,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të përpiqem që, duke i mbështetur Rekomandimet e komisionit parlamentar funksional dhe parafolësit e mi në vërejtjet që i patën dhe kontributet e tyre, të mundohem edhe unë të jap një kontribut në këtë debat.

Propozoj që rekomandimeve t'u shtohen edhe këto rekomandime:

Nën një, që të gjitha lëndët drusore, pra qoftë për djegie, qoftë druri teknik, të lirohen nga doganat, TVSH-ja dhe taksat e tjera me qëllim që të bie çmimi dhe qytetari i Kosovës të ketë më tepër leverdi të blejë drurin nga importi se sa ta presë pyllin e vet.

Tjetër, nën dy, Qeveria e Kosovës të mbikëqyrë efektin e lirimit nga doganat dhe taksat e drurit nga importi në çmimin e këtyre artikujve në treg. Pse e them këtë?

Të nderuar deputetë,

Kur rritet çmimi i naftës në treg, brenda një ore rritet çmimi i derivateve të naftës në pikat e karburantit ku furnizohemi të gjithë ne. Kur bie çmimi i naftës, siç ka rënë 50% për një muaj, kjo nuk shihet në çmimet e distribuimit të derivateve të naftës me pakicë, sepse është jashtë kontrollit të Qeverisë. Pra, duhet që të kontrollohet heqja e këtyre tarifave nga këto produkte dhe të kontrollohet reflektimi në çmimin e tregut të këtyre artikujve. Heqja e këtyre taksave edhe nga druri industrial, do të kishte efekte shumë pozitive, sepse do ta bënte Kosovën joshëse për investime të huaja dhe vendore në industrinë e përpunimit të drurit.

Të nderuar deputetë,

Propozoj që një rekomandim të jetë për Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë që të hartojë programin e edukimit që do të përfshinte prej sistemit parashkollor, shkollën fillore, të mesme dhe të gjitha fakultet dhe të gjitha vitet që të kenë lëndën - mbrojtja e natyrës. Duhet ta pranojmë se ne kemi shumë probleme me vetëdijen e përgjithshme qytetare se sa e rëndësishme është mbrojtja e natyrës dhe e pyjeve dhe ky implementim i këtij programi edukativo - arsimor për të gjitha këto nivele të edukimit, të fillojë në vitin e ardhshëm shkollor.

Është e paimagjinueshme, të nderuar deputetë, që në një shoqëri që ka vetëdije të lartë, të ngritur sa i përket mbrojtjes së natyrës, një qytetar ta presë një dru dhe mos të lajmërohet brenda një afati shumë të shkurtër nga qytetari tjetër që e sheh një veprim të tillë. Ne kemi probleme si shoqëri në këtë drejtim.

Të nderuar deputetë,

Rekomandimi tjetër imi është që Ministria e Drejtësisë, pra, të rekomandojë dhe të kërkojë nga të gjitha gjykatat që lëndët, të cilat kanë të bëjnë me dëmtimin e pyjeve, të kenë prioritet në shqyrtimin e tyre nëpër gjykata dhe gjokat të jenë ashtu qysh janë të përcaktuara me Ligjin aktual, pra në shkallën më të lartë dhe vijën më të lartë.

Dëmtimin e pyjeve, të nderuar deputetë, e bëjnë jo ata që janë të varfër dhe e kanë atje një sëpatë ose një kali të lodhur, por individët që kanë mjete teknike me vlera qindra mijëra eurosh. Ata e bëjnë dëmtimin dhe shkatërrimin e pyjeve në Kosovë.

Rekomandimi tjetër është që, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të sjellë para Kuvendit të Kosovës planin për pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura dhe të atyre të dëmtuara të pyjeve në Kosovë për vitin e ardhshëm dhe ai plan duhet të jetë ambicioz. Të kërkohet edhe ndihma, edhe donacione, sepse nuk janë të pakta ato shtete që do të ndihmonin në qoftë se ne kemi projekte dhe programe konkrete për mbrojtjen e natyrës dhe pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura dhe të atyre të dëmtuara të pyjeve.

Një rekomandim tjetër, zoti kryesues. Më lejoni të propozoj që pas këtij debati që ishte shumë përmbajtësor, sipas mendimit tim, dhe nuk kishte dallime në vija pozitive – opozitive, por ishim të një mendimi dhe të gjithë u munduam të japim kontribut, komisioni funksional të shqyrtojë krejt debatin, t'i plotësojë rekomandimet dhe për seancën e ardhshme t'i sjellë për votim në Kuvend, sepse jam i bindur se duke e dëgjuar këtë debat që është zhvilluar këtu, nuk do të ketë asnjë votë kundër. Ju faleminderit, zoti kryesues!

XHAVIT HALITI: Ju faleminderit, zoti Maloku! Për fjalë është paraqitur deputeti Geci, le të përgatitet deputeti Ramosaj.

GANI GECI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër, (veç një ministër na paska mbetur këtu).

Në bazë të statistikave të ekspertëve vendorë dhe të atyre ndërkombëtarë, shtetet perëndimore e dinë se sa për qind pyje kanë në sektorin privat dhe sa për qind pyje kanë në sektorin shtetëror. Ta zëmë, Sllovenia i ka 30% pyje në sektorin shtetëror dhe 70% në atë privat; Sllovakia i ka 60% në sektorin shtetëror dhe 40% në sektorin privat; Letonija i ka 80% në sektorin shtetëror dhe 20% në atë privat, ndërsa Britania e Madhe i ka 40% në sektorin shtetëror dhe 60% në sektorin privat. Ndërkaq, ne në Kosovë ende nuk e dimë se sa për qind të pyjeve bëjnë pjesë në sektorin privat dhe sa për qind të pyjeve bëjnë pjesë në sektorin shtetëror.

Sa më tepër që ne i ruajmë pyjet, i ruajmë mushkëritë e qytetarëve të shtetit tonë, sepse pyjet janë mushkëritë e qytetarëve të atij shteti.

Unë do të flas vetëm për prerjen legale dhe formën e prerjes legale dhe ilegale të pyjeve në Kosovë. Ta zëmë, në vitin 2007, ka pasur djegie masive të pyjeve, edhe pse temperaturat kanë qenë shumë më të vogla se në vitin 2008. Afër 50% kemi pasur rënie të djegieve të pyjeve në vitin 2008. Kjo na jep për të kuptuar se pyjet në Kosovë digjen t'u prerë në vitin tjetër, digjen qëllimisht. Nëse pyjet në Kosovë digjen qëllimisht, atëherë jep për të kuptuar se janë të sinkronizuara dhe të dirigjuara nga dikush që të digjen, që në vitet që vinë ato të prehen.

Nga statistikat, gjithashtu, del se në Kosovë, në të dy sektorët, në sektorin privat dhe atë shtetëror, janë planifikuar rreth 220.000 m³ që të prehen, ta zëmë, për këtë vit, ndërsa harxhimet e kosovarëve me dru për djegie janë rreth 1.5 milion m³. Ju lutem, nëse 1.2 milion m³ prehen ilegalisht, çka do të thotë kjo për buxhetin e Republikës së Kosovës.

Buxheti i Republikës së Kosovës, në këtë drejtim ka humbje marramendëse miliona euro nga kjo fushë, e cila duhet t'i thithë mjetet për prerje legale.

Unë po flas, gjithmonë duke u thirrur në statistika, që i ka bërë Riinvest me një firmë suedeze, sepse në Kosovë, sipas këtyre statistikave, del se rreth 1.3 milion m³ rriten dru të reja në vit. Qeveria e Kosovës nuk ka asnjë plan që në të ardhmen prerjet e pyjeve të të dy sektorëve të bëhen në formën legale dhe të bëhet prerje e kontrolluar e pyjeve, siç bëjnë të gjitha shtetet në botë, qoftë për dru për nxehje, sepse të gjithë e dimë se në Kosovë nuk ka tjetër lloj të nxehjes, sepse rrymë nuk kemi dhe dimrit nuk ka askush që mund të nxehet nëpër fshatra ... dhe ata të paktën me rrymë, të gjithë nxehen me dru dhe me rrymë kur po nxehen po e vjedhin edhe rrymën. Do të thotë, ky problem duhet të zgjidhet, sepse nxehja në Kosovë po kushton dhe dikush po e di që kjo kushton dhe harxhohen këto mjete dhe në këtë kushtim po vjedhin. Kush po vjedhin – ata që kanë mundësi për të vjedhur. Normalisht, fshatarët nuk mund të vjedhin aq shumë pyje të Kosovës, sepse ata i përdorin për nxehje familjare, ndërsa këto prerjet në formën legale, këto djegiet në formën ilegale dhe prerje madje edhe në formë ilegale i shkaktojnë dëm marramendës buxhetit të Republikës së Kosovës. Pra, nëse ne i harmonizojmë harxhimet me rritjen e pyjeve që kemi 1.500.000 m³ harxhime dhe afërsisht 1.300.000 m³ kemi rritje të pyjeve në vit, atëherë kërkoj nga ministri dhe Qeveria që të sjellin një plan, të shkojnë me statistika të sakta dhe të bëjmë prerjen e kontrolluar të pyjeve dhe të mos humb buxheti i Republikës së Kosovës nga kjo zeje, sepse siç ka fitim në atë pjesën e derivateve të naftës që po bëhet atje në Mitrovicë, i njëjti fitim dhe i njëjti korrupsion po bëhet në prerjen e pyjeve në Republikën e Kosovës. Kjo është ajo në të cilën unë desha të fokusohem. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Geci. Deputeti Ramosaj, le të përgatitet deputetja Pantina.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit zoti kryesues!

Përsëritës ministrit,

Përsëritës të gjithë kolegët deputetë,

Vërtet, unë pata përgatitur të them diçka për këtë çështje që, në fakt, është çështje shumë e rëndësishme, por shumica e atyre çka pata ndërmend t'i them, i thanë kolegët e nderuar dhe më erdhi mirë që një çështje e tillë është, vërtet, jemi të homogjenizuar në këtë proces ta ndalim këtë gjë të shëmtuar. Mirëpo, dy çështje nuk u prekën. Çështja e parë është se duhet të dallohen, nuk janë pyjet e Bjeshkëve të Nemuna, respektivisht pyjet e Deçanit të njëjta me pyjet e regjioneve tjera në Kosovë. Dallojnë edhe për nga tipi, por dallojnë edhe për nga veçantitë se janë pyje industriale, shumica prej tyre dhe tipi i halorëve është shumë i veçantë në krahasim me pyjet e vendeve të tjera. Andaj, kjo na shtyn që të kemi qasje shumë më të veçantë në krahasim me vendet e tjera, me regjionet e tjera, po mendoj, në Kosovë. Jo të pretendojmë që mos të ruhen edhe regjionet e tjera, por të kemi shprehje më të theksuar sepse, vërtet, në qoftë se shkatërrohen këto pyje, kemi shkatërruar një pasuri shumë të veçantë të Republikës së Kosovës. Kjo është një çështje që edhe ekspertët e kësaj fushe na kanë treguar, na kanë sugjeruar dhe e kemi lexuar. Andaj, shpreh edhe njëherë indinjatë të thellë për keqbërjen në këtë pjesë të Kosovës.

Edhe një çështje tjetër që dua ta theksoj. U fol këtu për prerje ilegale, u fol për shkelje ligjore, gjithçka. Nuk u theksua se krimi në pyjet e Deçanit është krim i organizuar, ajo çka është e rëndësishme të potencohet dhe mendoj se edhe në rekomandimet që do të dalin në fund të këtij debati, duhet të theksohet kjo. Ka indikacione të mëdha se pyjet e Bjeshkëve të Nemuna gllabërohen sot duke bashkëpunuar persona të caktuar me autorizime të caktuara dhe bile institucionet që duhet të jenë vetë bartëse të mbrojtjes së pyjeve, janë të lëshuara

në këto aktivitete kriminale. Këtu më vjen keq, se ne kemi institucione në ndërtim e sipër, por ka indikacione se edhe pjesëtarë të SHPK-së, edhe pjesëtarët apo institucioni i gjykatës, qoftë në nivel komunal, qoftë në nivel më të lartë, dhe Agjencioni i Pyjeve kanë koordinime me të gjithë të ashtuquajturit "akordantë" të cilët, vërtet, në emër të veprimtarisë bisnisore në atë fushë sot e keqpërdorin atë.

U tha këtu që të shpallet projekti apo Bjeshkët e Nemuna si park nacional. Parqet nacionale ne mund t'i shpallim, por mund të bëjmë dhe ligje të mira. Këtu problemi është se nuk është duke u respektuar edhe ky ligj që ekziston, edhe këto rregullore. Më shumë janë ruajtur pyjet menjëherë pas luftës në Kosovë, domethënë viti 1999 e deri në vitin 2004-2005 se sot, sepse atëherë edhe policia ndërkombëtare edhe trupat e KFOR-it kanë marrë pjesë në mbrojtjen e pyjeve të Kosovës dhe gllabërimi i kësaj pjese, kësaj pasurie natyrore të Kosovës sot është aq i koordinuar sa që vë në pikëpyetje jo vetëm zbatimin e ligjit, por vë në pikëpyetje se a është fjala për një krim të organizuar, të organizuar mirë, apo është fjala për diçka tjetër.

Andaj, është momenti i fundit që këto rekomandime që do t'i nxjerrim, t'i marrë Qeveria dhe t'i zbatojë përmes mekanizmave të vet, në çfarë forme i zbaton, ajo është çështje e Qeverisë, por situata është vërtet shumë, shumë emergjente sa i përket kësaj çështje, sepse rrezikohemi edhe për ujë, rrezikohemi edhe për ajër dhe rrezikohemi edhe për një pasuri shumë të veçantë të Republikës së Kosovës. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Pantina, le të përgatitet deputeti Tali.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë dhe të gjithë të pranishëm,

Pyjet tona, jo vetëm pyjet e Deçanit, por në përgjithësi po shkatërrohen tmerrësisht. Ky shkatërrim po ndodh para syve tanë dhe ne edhe pse i kemi institucionet përkatëse, kemi ligjin, nuk jemi në gjendje t'i mbrojmë. Për shkatërrimin e pyjeve të Deçanit, anëtarët e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor kemi pasur rastin të bindemi me rastin e vizitës së regjionit të Deçanit dhe unë i përkrah të gjitha rekomandimet që janë dhënë nga ky komision.

Mirëpo, desha të jap një theksim të veçantë, një element që mund të përfshihet, ndoshta, në ligjin që duhet të hartohet për ta ndihmuar mbrojtjen e pyjeve. U pa edhe nga diskutimet se është më se e domosdoshme që urgjentisht të ndërmerren masa për mbrojtjen e pyjeve. Pyjet duhet t'i mbrojmë nga keqpërdoruesit, sidomos ata të organizuar, të cilët në mënyrë ilegale përfitojnë shumë në dëm të ambientit tonë. Është fakt, përgjegjësia më e madhe për mbrojtjen e pyjeve i takon Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, por edhe Agjencionit të Pyjeve. Mirëpo, duhet të jemi real, duke ditur se sa është i thellë problemi i keqpërdorimit të pyjeve, mendoj se Ministria e cekur duhet të veprojë në bashkëpunim të ngushtë dhe të ketë përkrahje të fortë nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, nga organet e drejtësisë, si dhe nga ana e qytetarëve për të luftuar këtë dukuri negative në mesin tonë. Ministria në fjalë duhet urgjentisht të hartojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit ekzistues për pyjet, në mënyrë që të kemi një ligj më funksional dhe më efikas për mbrojtjen e pyjeve meqenëse ligji aktual është treguar si jo efikas. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zoti Tali. Le të përgatitet deputeti Avdiu.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar të pranishëm, fillimisht ngase nuk mora pjesë në ato urimet e mëngjesit, do të doja ta uroja Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Qeverinë për punën e mirë të bërë në lobim, për bindjen e Malit të Zi dhe të Maqedonisë që të na njohin. Mendoj se kjo veç ua mbyll gojën të gjithë atyre kritikuesve të cilët e kanë kritikuar punën e mrekullueshme të Ministrisë së Punëve të Jashtme (duke qeshur me një dozë ironie).

Nuk desha ta marrë fjalën, por më sfidoi këtu edhe një ide, ideja e parkut nacional. A jemi duke folur për Prevallën, apo jo?

Domethënë, nuk po flasim për Prevallën, por unë, sinqerisht, e kam një libër shumë të mirë që e kam marrë nga profesori Ludvig Kromer, është libër i cili shumë mirë i shpjegon parqet nacionale, është libër i ri, po mendoj, dhe e kam studiuar Ligjin e vitit 1986, nëse ne kosovarët nuk mund ta respektojmë një ligj të vitit 1986 që, megjithatë, ka qenë bashkëkohor për kohën, por standardet kanë qenë tjera krahasuar me tani për shkak të rritjes së vetëdijes ndaj ambientit, andaj të shpallim tash në vitin 2008 një park nacional me standarde të tashme, të cilat na imponon koha, mendoj se veç do ta qesim veten në siklet edhe një herë sepse s'mund t'i respektojmë ne ato standarde. Pastaj, do të na dalin probleme atje me kompetencat e nivelit komunal dhe të nivelit qendror, e pse jo edhe të atyre figurave lokale që do të ndërtojnë, e tjera, e tjera. Problemi mbi të gjitha është se, (hallin e kam) se jetojmë në Evropë, megjithatë, dhe veç merreni me mend të vijë ndonjë entuziast, ndonjë ambientalist nga Evropa, të vijë për të shikuar parkun nacional dhe në zonën e dytë, atje, apo në zonën e parë, i sheh snobët rural, snobët provincial kah pjekin pite. Tmerrohet. Unë mendoj se, nëse nuk mund të sillemi si evropian, nëse nuk mund t'i respektojmë rregullat për çka kemi dëshmuar deri më tani, që mos t'i shtimë therë vetes, domethënë, edhe këtij Parkun Nacional të Sharrit t'ia heqim titullin e parkut nacional, ta bëjmë ashtu allakosovarçe, aq më pak që edhe Deçanin ta shpallim park nacional për shkak se nuk jemi në gjendje të respektojmë, po them, një numër të madh të standardeve. Unë po e lexoja librin, ishin aty do hapësira të posaçme për ruajtjen e ekosistemit, për ruajtjen e specieve të caktuara, e tjera, e tjera. Kishte, merreni me mend, edhe hapësira në parqe nacionale që nuk lejohet të hecësh me këpuca të rënda, domethënë duhet t'i kesh ato farë të lehta për të mos e dëmtuar ambientin. Atë ne s'mund ta respektojmë dhe nëse s'mund ta respektojmë zonën e dytë, të mos ndërtojmë shtëpi, kështu, pa fije turpit dhe të mundohemi ta prolongojmë pa nevojë një çështje shumë të rëndësishme, po them civilizuese për kohën, në shekullin 21, andaj të mos japim ide të cilat nuk mund t'i respektojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Të faleminderit! Ju lutem, dua t'ua tërheq vërejtjen, janë paraqitur 3 veta që kanë diskutuar një herë. Dy herë në debat nuk bën të diskutohet. Fjalën e ka deputeti Ramadan Avdiu. Edhe për replikë, në qoftë se paraqiteni, vetëm kur t'u përmendet emri. Kam për të replikuar me të gjithë këta që kanë folur dhe është problem i madh, se s'na premtan koha. Faleminderit! Zoti Avdiu, e keni fjalën!

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë të respektuar deputetë,

Vërtet, tash pas gjithë këtij debati konstruktiv, është e tepërt të them se pyjet janë pasuri e madhe, pyjet janë pasuri e jona kombëtare që u tha këtu. Do të përpiqem në maksimum që të mos i përsëris ato çka u thanë deri më tash. Unë i përkrah fuqimisht të gjitha rekomandimet e Komisionit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Do të sugjeroja që në rekomandimin e katërt, në vend që të përforcohen rojet e pyjeve, të insistohet që të formohet një njësi e veçantë policore, e cila do të jetë polici pyjore. Do të dëshiroja, po

ashtu, të vlerësoj edhe angazhimin e Ministrisë për Mbrojtjen dhe sanimin e pasojave në menaxhimin e deritashëm të pyjeve në Republikën tonë, sepse është shumë evidente që ka një shkatërrim në masë të pyjeve dhe ky asgjësim sistematik i pyjeve të Kosovës po ndikon edhe në shkatërrimin e biodiversitetit në vendin tonë.

Është më se e domosdoshme dhe besoj se pas këtij debati konstruktiv Ministria gjegjësisht gjithë Qeveria do t'i qasen shumë seriozisht rishikimit të ligjit për pyjet në Republikën e Kosovës në mënyrë që përfundimisht të futemi në rrugën e menaxhimit, të ruajtjes dhe të regjenerimit të kësaj pasurie të madhe kombëtare që e kemi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritje të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të mundohem vetëm shkurtimisht, pa i përsëritur ato që i thanë kolegët, por të ngre disa çështje që konsideroj i ndihmojnë edhe Raportit me rekomandimet që kanë ardhur. Çështja e parë është mendoj që në rekomandime ka qenë dashur të përfshihet edhe përgjegjësia e menaxhmentit apo të them direkt e njerëzve të cilët menaxhojnë me Agjencionin e Pyjeve në Kosovë. Vlen të përmendet se para vetit kemi disa raporte që i kemi marrë në forma të ndryshme dhe konsiderojmë se edhe në Deçan, ndoshta, çështja ka filluar të përmirësohet dhe kjo është si rezultat i asaj që iu ka dhënë mundësia disa kompanive të pastrojnë pyllin dhe kjo ka ndikuar, ndoshta, pozitivisht për shkak të lehtësimit të punës së njerëzve të cilët edhe janë inkuadruar për punuar, por edhe në masa tjera kanë krijuar situatë që ta pastrojnë pyllin dhe të sigurojnë edhe këtë lëndë djegëse të cilën e përdorim shumë në Kosovë. Vlen të përmendet fakti tjetër që nga ajo që kemi parë në raporte deri tash Agjencioni ka bërë vetëm inspektim të rregullt të prerjes së maleve dhe mendoj që Komisioni, me gjithë respektin që kam për punën që e kanë bërë, është mirë të rekomandojë për të pasur edhe inspektim të jashtëzakonshëm të prerjes së pyllit. Pra, inspektimi ka qenë një herë në vit dhe është mirë tani ta kemi një inspektim të jashtëzakonshëm, duke marrë parasysh që tani, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për vetëqeverisjen lokale prapë menaxhimi i pyjeve do të kalojë në komunat e Kosovës.

Një çështjet tjetër me interes është nga ajo që kemi mund me marrë edhe prej gjykatave, shihet se gjykata komunale në Pejë edhe Gjykata për Kundërvajtje janë munduar të jenë efikase sa i përket lëndëve që iu kanë ardhur. Mirëpo, vlen të përmendet një fakt, nga një raport që kemi, diku janë bërë 317 fletëparaqitje që janë edhe për Gjykatën për Kundërvajtje, domethënë kemi fletëparaqitje edhe penale edhe për kundërvajtje, nga raporti që kemi marrë dhe nuk përputhet me lëndët të cilat janë shqyrtuar. Diku janë shqyrtuar në Gjykatën Komunale 69 lëndë, 51 janë shqyrtuar dhe kanë mbetur një pjesë e vogël dhe në Gjykatën për Kundërvajtje janë shqyrtuar 200 lëndë dhe kanë mbetur 20 lëndë pa u shqyrtua, që nuk përputhet me fletëparaqitjet që janë bërë. Pra, këtu është mirë që të bëhet një inspektim pse janë flakur aq shumë lëndë, diku janë edhe nga 60 – 70 lëndë që janë flakur nga Prokuroria Publike.

Një çështje tjetër, më intereson fakti, me gjithë angazhimin që kanë treguar rojet komplet edhe policia, si organizëm që ka ndihmuar këtë proces dhe KFOR-i, në shumtën e rasteve më befason fakti që në pyjet e Strelcit, domethënë, rojet e pyllit kanë bërë vetëm një fletëparaqitje për 6 muaj e parë të këtij viti. Me plot përgjegjësi po them- athua kanë qenë në nivel të detyrës për të bërë vetëm një fletëparaqitje për 6 muaj? Është shumë e vërtetë që, ndoshta, nuk ka pyje, nëse nuk ka pyje, atëherë i kanë prerë, konstatohet ajo gjendja

tjetër faktike. Dhe krejt në fund, për të mos e përsëritur, është mirë që në rekomandim të konstatohet gjendja reale që është me pyjet në Kosovë. Nuk është vetëm Deçani i shkatërruar sa i përket prerjeve, por në të gjitha malet kudo në Kosovë dhe kjo nuk vjen si pasojë që e përmendën edhe kolegët, që pyjet po shkatërrohen, ndoshta, nga qytetarët për nevoja, por si pasojë që në Kosovë sot iu kanë dhënë tenderët njerëzve të cilët punojnë me shitore të ndryshme, ku shesin çokollata dhe smoki dhe nuk kanë asnjë përgjegjësi as nuk e kanë në kompetencë atë përgjegjësinë që duhet të ruhen malet dhe marrin tenderë pa qenë fare të licencuar dhe kjo dukuri ka ndodhë së paku deri tash. Shpresoj që ministri tani do të marrë hapa konkret për ndalimin e kësaj dukurie negative dhe t'iu jepet mundësia që së paku ato kompani të cilat janë të licencuara dhe marrin si obligim që jo vetëm ta prejnë malin, por edhe ta ruajnë dhe ta pyllëzojnë.

Unë edhe një herë i mbështes rekomandimet dhe kisha dashur që Komisioni vetëm të ketë parasysh që në këto rekomandime ta fusë edhe përgjegjësinë e menaxhmentit dhe njëkohësisht kërkoj që të bëhet edhe një inspektim i jashtëzakonshëm, ngase nga ajo që kemi parë deri tash nuk ka pasur. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli, lë të i fundit Hajdin Abazi.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

I mbështes rekomandimet e komisionit funksional dhe për atë që u diskutua deri më tash, pajtohem plotësisht. Ndërkaq, unë desha ta tërheq vëmendjen, mendoj, te shembujt joadekuat personal të vet zyrtarëve të Kosovës. E kam fjalën, një prej shembujve shumë konkret është prerja e pyjeve për vitin e ri. Dikush mund të thotë, pak janë ato, një bredh për vitin e ri. Mirëpo, në shembullin, ta zëmë, të Komunës së Prishtinës, veprojnë shumë qytetarë në Kosovë dhe veprojnë për vit, kështu që bredhi, që është me kursim në Kosovë, vijmë në një situatë që, në fakt, për çdo vit pritet nga një mal. Kështu që, unë do të apeloja te këta zyrtarë, konkretisht duke u nisur prej Komunës së Prishtinës, nëse veç e ka marrë traditë për ta prerë, ta vendosë nga një bredh të vitit të ri në qendër të Prishtinës, ka bagerë mjaft, shkon e shkul një dhe e mbjell njëherë për gjithmonë dhe s'ka nevojë përvjet ta japë nga një shembull shumë të keq që po transmetohet edhe në televizion, edhe urdhëroni merrni ju veturën dhe kaloni në atë kohë prej Prishtine deri në Han të Elezit ose në cilindo drejtim, keni për të parë varg nëpër pompa, kanë prerë diku kesi bredha dhe i kanë vendosur aty për vit të ri. Domethënë, ky është një shembull, duke u nisur prej zyrtarëve më të lartë të Kosovës, nuk donë për të folur për dëmtim të pyjeve, bë me gisht në njërin anë, e është njëri prej atyre që i dëmton pyjet. Domethënë, duhet të nisemi me një shikim, kisha për të thënë, të ri për pyjet. Pyjet janë tonat dhe nuk bën në këtë formë të trajtohen prej askujt. Është ai sofizmi: “T’ia heqësh një qime njeriut, a bëhet tullac, jo, po dy jo, po njëqind jo, kur mbërrini diku me mijëra- u pa që, në fakt, u bë i tillë, mbet tullac”. Kështu është edhe puna e këtyre që mendojnë se t’ia heqësh një dru Kosovës, t’ia heqësh një bredh, kurrëgjë nuk është, e në fakt në këtë mënyrë po bëhen dëme. Unë ju falënderoj për vëmendje!

KRYESUSI: Faleminderit, zoti Xhemajli! Unë i kërkoj falje deputetes Nurishahe Hulaj. Hajdin, tash pra, meqë e kam kaluar gabimisht, e merr fjalën deputetja Hulaj. Faleminderit!

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë do të përdor një qasje të rëndësishme për mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi në Kosovë, duke ditur se ekziston një strategji: “Shkollat promovuese të shëndetit” e përgjegjëse për këtë strategji për zbatueshmëri janë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Shëndetësisë. Strategjia ekziston për periudhën 2008-2017, nuk e di a është nënshkruar, por është shumë e rëndësishme që do të ndihmonte nëse zbatohet për mbrojtjen e mjedisit. Përmes kësaj strategjie, nëse përkrahet me grande qeveritare përmes ministrive përkatëse, mund të zhvillohen aktivitete të shumta promovuese për mbrojtjen e mjedisit dhe përmes kësaj t’i jepen informata komunitetit se cilat janë pasojat e shkatërrimit të mjedisit dhe si ne mund ta mbrojmë atë, e në rastin konkret, pyjet dhe zonat e gjelbra. Qytetarët kanë nevojë për informata shitesë. Nuk kam dëshirë t’i quajmë hajdutë dhe hajna, por kam dëshirë që t’i përkrahim dhe t’u japim informata, qoftë përmes broshurave, qoftë përmes takimeve me ta dhe t’i ndërrojmë informatat dhe t’i japim këshilla se si ta mbrojnë mjedisin. Sigurisht se edhe ata do t’i përkrahin aktivitetet e zhvilluara nga grupet e zonave përkatëse. Kush mund të jenë grupet e zonave përkatëse që do t’i quaja edhe fokus grupe? Mund të jenë: prindi, nxënësi, përfaqësuesi i shëndetit publik, arsimtari dhe deputeti. Pra, të ndihmojmë përmes organeve qeveritare, përkatësisht ministrive përkatëse e kryesisht përmes strategjisë së cekur, të nxitim këtë formë të veprimt, sepse është e karakterit modern ndërkombëtar dhe me këtë ne ngrejmë më tej vetëdijesimin në komunitetin me qëllim të mbrojtjes së mjedisit në Kosovë e në veçanti pyjet e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Abazi, le të përgatitet deputeti Gjini.

HAJDIN ABAZI: I nderuar, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Jemi duke debatuar për një çështje shumë të ndjeshme dhe që në një mënyrë ose në një tjetër të gjithë ne jemi dëshmitarë të një dëmtimi pothuajse publik që po bëhet, publik në kuptimin që po bëhet pothuajse në mënyrë të hapur dhe sikur po tregohemi të pafuqishëm për ta ndalur këtë të keqe të cilën më pas do ta kemi bukur vështirë ta përmirësojmë. Një parafolës më herët tha se po prehen pishat dhe nuk duhet të prehen. Në të vërtetë, jo vetëm pishat, por të gjithë drunjtë mund të prehen, por kjo duhet të bëhet në mënyrë të kontrolluar ashtu që atyre drunjëve që iu afrohet mosha për, si të themi për t’u plakur, do të thotë që nuk do të mund të kenë më potencial për t’u gjeneruar ata duhet të priten, të mbillen fidanë të rinj që kështu të vazhdohet gjenerimi i pyllit, përkatësisht gjenerimi i atyre lëndëve të cilat kanë aftësi që t’i kryejnë funksionet e veta edhe kimike kundrejt që luajnë rolin e mushkërive për pastrimin e ajrit në Kosovë. Do të thotë këtu ne sikur na mungon dhe këtu nuk po flasim për këtë lloj kujdesi që duhet të shoqëria jonë ta tregojë ndaj pyjeve, por po flasim për dëmtime enorme që po bëhen. Pra, këtu me të drejtë u tha nga kolegët nuk është fjala për individë të thjeshtë të cilët të themi me një kali apo me një gomar shkojnë dhe përpiqen të mbijetojnë, por është fjala për kompani ilegale të drurit që me tonelata i dëmtojnë pyjet tona. Këtu shteti ynë duhet të tregojë forcë për t’i ndalur këto, sepse kjo është një e mirë e të gjithë neve, një e mirë që duhet ta ruajmë për shkaqet që u thanë këtu edhe më herët.

Prandaj, nëse sot kolegët kanë pasur mundësi t’i shfletojnë gazetatat ditore, e kanë parë një lajm ku thuhet se kontrabandistët e drunjëve kanë rrahur një polic. Çfarë do të thotë, ata dalin në mënyrë të organizuar, kurse nëse janë një ose dy policë nuk do të mund të jenë efektiv, por çfarë do të mund të bëjë një roje e pyllit që është një i vetëm ose dy? Këtu edhe shteti ynë duhet të organizohet dhe të marrë masa të mirëfillta që edhe me forcë t’i ndalojë

ata, sepse gjuhën e ligjit këta kontrabandistë nuk e njohin, gjuhën e moralit, jo, gjuhën e drejtësisë, jo dhe as gjuhën e nderit apo të fytyrës, si të themi kështu popullorçe jo, atëherë është vetëm forca policore që mund t'i ndalë duke zbatuar ligjin, kështu që unë propozoj që rekomandimi i fundit që u tha edhe nga dikush tjetër këtu, rekomandimi 4, do të thotë, të obligohet dhe të përfshihet në kuadër të ligjit që në aksionet e tilla të jenë jo një e dy policë, por të jetë një njësit i policisë që del në mbrojtje të rojeve të pyllit dhe në mbrojtje të pyjeve. Në anën tjetër, absolutisht, ka nevojë që ligji të rishikohet dhe të amendohet me amendamente, që do ta shtojnë efikasitetin, do t'i japim mundësi dhe kompetenca më të mëdha edhe Agjencisë të Pyjeve, por edhe Ministrisë dhe policisë që t'i marrë në mbrojtje. Besoj që pas këtij debati në Parlament do të merren parasysh këto dhe vërtet do të veprohet me urgjencë që kjo e keqe të ndalet derisa nuk është bërë vonë, derisa nuk është shndërruar vendi ynë, ndoshta, në një shkretinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Do të flas shumë shkurt për dy çështje, të cilat u përmendën në njëfarë forme, por jo të strukturuar. Para pak më shumë se një viti ka qenë në Kuvendin e Kosovës, do të thotë në legjislaturën e kaluar, Propozim ligji për parqet nacionale, i cili ka pasur për qëllim që edhe Bjeshkët e Nemuna ose Bjeshkët Veriore të Kosovës të shpallen park nacional përpos parkut Nacional Malet e Sharrit. Kuvendi e ka refuzuar këtë ligj dhe një prej arsyeve kryesore ka një lobim serioz nga Agjencioni Pyjor i Kosovës, agjencion i cili, kur e dëgjon dikush emrin mendon se është i themeluar për t'i mbrojtur pyjet. Çka ka ndodhu? Në realitet është se Agjencioni për pyje të Kosovës është shndërruar në agjencion për tenderim për prerjen e pyjeve. Më vjen mirë që është ministri i Bujqësisë këtu dhe e lus që të ketë kujdes në këtë çështje për shkak se kjo është arsyeja ose njëra prej arsyeve kryesore pse nuk ka kaluar ai projektligj i cili ende sot gjendet i draftuar në Ministrinë e Mjedisit? Mendoj, po ashtu, se ministri i Mjedisit ka qenë dashur të jetë këtu kur flasim për pyjet e Kosovës. Do të thotë kjo është një çështje dhe kur bëjmë rekomandime është në rregull që t'i shohim detajet, ta shohim tenderimin dhe mendoj se Komisioni për Bujqësi e ka bërë një punë të mirë që i është rrekur kësaj pune, mirëpo duhet të ketë edhe planifikim pak më strategjik e planifikimi strategjik është mbrojtja afatgjate me ligj e njëres prej pasurive më të mëdha të Kosovës, u tha shumë herë këtu, që është ndër pasuritë më të mëdha dhe më të vlefshme të Kosovës. Kur flasim për pasurinë më të vlefshme, atëherë duhet të ketë edhe forma ligjore shumë të vlefshme për ta mbrojtur. Çështja tjetër, në raport, e cila mendoj duhet të përmirësohet, është çështja e fjalës- "posaçërisht në Deçan". Nuk mund të thuhet "posaçërisht" për shkak se atëherë vetëm ka komplikim në mënyrën se si e kuptojmë ne, si duhet të vendosen prioritetet nga Qeveria, kur thuhet "posaçërisht" dhe është gati njëfarë oksimoroni të thuhet "posaçërisht në Deçan" kur Komisioni i njëjtë para disa dite na ka treguar gjendjen katastrofave sa i përket prerjes së pyjeve në Malet e Sharrit. Do të thotë tash Malet e Sharrit janë katastrofë, ndërsa Deçani është prioritet. Duhet të jetë një gjë e plotë, duhet të vlejë për tërë Kosovën. Edhe një herë po kërkoj që Komisioni t'i rekomandojë Qeverisë që ta sjellë Ligjin për parqet nacionale, prapë në Kuvend. Ka qenë një temë e cila kërkoj nga Ministria e Bujqësisë që ta shohë dhe mundësisht ta përmirësojë. Në atë kohë Ministria e Mjedisit ka kërkuar rreth 60.000 hektarë park nacional, ndërsa Agjencia e Pyjeve ka ngulur këmbë që të jenë 30.000 hektarë, do të thotë i kanë kërkuar diku 30.000 hektarë- pa mbrojtje në formën e Parkut Nacional. Kjo ka qenë dilema. Do të ishte mirë që të na silllet përpara dhe Kuvendi edhe një herë të merret me këtë temë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Lulzim Zeneli, kryetar i Komisionit.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, kryesues!

Është inkurajuese që të gjitha diskutimet ishin në një frymë...

KRYESUESI: Lulzim, më fal, a ka mundësi vetëm një ndërhyrje? Ministri e ka kërkuar fjalën. Sipas Rregullores, i fundit je ti. Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar deputetë,

Rëndësinë e pyjeve, besoj që mjaft mirë e kemi shpjeguar dhe do të ishte më mirë t'iu shpjegojmë ata që janë duke u rritur, ndërkaq, problemet që janë evidente dhe janë shumë të rënda të evitohen, atëherë bisedojmë edhe si të zgjidhen.

Gjendjen në pyje dhe në tërë Ministrinë e kam marrë në gjendje kaotike, mund të them. Prerja e pyjeve ka vazhduar që në luftë, pas luftës e deri tani kur po flasim. Unë si ministër tamam një vit nuk është që jam dhe ne tani po i konstatojmë pasojat, të cilat janë bërë para 8 vjetëve dhe më tutje. Me pyjet gjithëherë ka pasur probleme edhe në pushtetin e kaluar, ka qenë sfidë e madhe për ruajtjen e tyre, po masat atëherë kanë qenë më të rrepta, ndërkaq ato tani nuk i kemi. Dua t'ju tregoj para jush se vetëm këtë vit, prej janari deri në shtator, kemi 4.200 fletëparaqitje për kundërvajtje dhe 2.000 fletëparaqitje për vepra penale. Të gjitha këto janë të ngritura nga rojet e pyjeve që janë pranë Ministrisë. 410 fletëparaqitje ka ngritur policia. Sikur të gjitha këto të ekzekutoheshin dhe të bëhej një vetëdijesim i dhunshëm ndaj atyre keqbërësve të cilët unë mundem lirisht të them duke pasur parasysh edhe zjarret e vitit të kaluar, mund të përdorim edhe termin terror, në qoftë se digjen edhe mijëra hektarë për një qëllim të dikujt që të prehen- planifikimi bëhet një vit përpara- ai është terrorizëm, në qoftë se kallen fusha të tëra të pyjeve. Unë personalisht si ministër, bashkë me ministrin e Punëve të Brendshme e kemi vizituar komunën e Deçanit dhe ministri i Ambientit. Jemi takuar me kryetarin e komunës, kemi vizituar një pjesë të pyjeve dhe unë e kam parë gjendjen reale atje -edhe si pasojë e prerjeve edhe si pasojë e zjarreve. Në atë takim ka marrë pjesë edhe gjenerali i policisë, kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e KFOR-it, 3 ministra, policët e regjionit, komandantët e stacioneve policore të Deçanit dhe regjionit të Pejës në përgjithësi. T'ju them të vërtetën shumë jam befasuar kur kam dëgjuar prej policëve që jemi të kërcuar prej prerësve ilegalë të pyjeve. Atëherë mund të gjykojmë shumë lehtë si deputetë, si ministra dhe si qytetarë cila qenka gjendja e vërtetë? Qenka një organizim shumë i fuqishëm i keqbërësve të cilëve deri tash nuk ka pasur mundësi shteti t'u bëjë asgjë. Një hallkë shumë e dobët e këtij funksionimi të pushtetit janë gjykatat. Në qoftë se përmenden për çdo vit një numër kaq i madh i lëndëve dhe në rast se për çdo vit mesatarja e zgjidhjes së tyre sillet deri në 20% dhe gjobat që shqiptohen janë qesharake, atëherë kemi të bëjmë me një kurajim të atyre keqbërësve, nuk jemi këtu të bëjmë me vetëdijesim të dhunshëm. Po përsëris, ata duhet të vetëdijesohen dhunshëm dhe me ta nuk duhet diskutuar në forma tjera.

Preventiva, rojet e pyllit kanë qenë deri në këtë vit kontratë në vepër dhe dihet përgjegjësia e një punëtori kur është në kontratë në vepër, ata punëtorë edhe unë si ministër nuk e di kush i ka sjell në vitet e kaluara? Sigurisht se këtë vit Parlamenti ka votuar që të gjithë ata të shndërrohen në punëtorë të rregullt. Pra, do të respektohet institucioni i konkursit dhe të gjithë ata të cilët kanë qenë të implikuar në një mënyrë apo në tjetrën në organizim ose në mesin e këtyre që kanë organizuar krimin në pyje ata, unë ju garantoj që nuk do të jenë në vendet e tyre të punës. Jo vetëm ata, por deri te ata që janë më përgjegjës, përgjegjësit më të lartë. Vetëm ju kisha lutur përmes mekanizmave dhe njerëzve që i dini denoncimet të

jenë të argumentuara dhe të bazuara në fakte. Me ta pardon nuk do të ketë. Unë do të marr vendime dhe ata do të shkojnë në shpi.

Sa i përket planeve menaxhuese. Kosovës për ta bërë një planifikim afatgjatë menaxhues të pyjeve i duhen rreth 15 milionë euro. Dhe deri tani me plane menaxhuese janë mbuluar 10.000 hektarë me pyje në Deçan, Kaçanik dhe në Ferizaj. Përderisa është duke vazhduar hartimi i këtyre planeve në rajonin e Pejës, Prizrenit dhe Gjilanit, financimi bëhet nga buxheti i Kosovës dhe Qeveria norvegjeze dhe janë në planifikim duke u hartuar këto plane edhe për 13.000 hektarë tjerë.

Kosova i ka 60% të pyjeve pronë publike, ose 280.000 hektarë, një deputet pyeti, mu duket se ishte si shqetësim, a dihet sa janë dhe 180.000 hektarë ose 40% janë pronë private. Dëmet më të mëdha bëhen në pronën publike, sepse kuptohet aty interesat janë të gjithëve për të përfutur sa më shumë, ndërkaq, rreziku për t'i mbrojtur ata që janë përgjegjës është shumë i madh. Unë publikisht dua të falënderoj deputetin Naim Maloku, vërtet ka qenë shumë korrekt në diskutimin e tij. Asnjëherë as edhe unë si ministër edhe si qytetar i Kosovës edhe si një njeri që e njoh mirë pylltarinë dhe rëndësinë e pyjeve dhe të gjitha ato, pyjet nuk i dëmtojnë ata njerëz që shkojnë për të marrë një sasi shumë të vogël për ngrohje ose për të blerë bukë, ka edhe raste të tilla, pyjet janë duke i dëmtuar biznesmenët, që merren me atë veprimtari.

Rekomandimet që janë nga Komisioni për Bujqësi, pylltari dhe Zhvillim Rural e Ambient janë të qëlluara. Unë si ministër këtë vit prerjet e rregullta në regjionin e Pejës, jo veç në komunën e Deçanit, por në regjionin e Pejës ku janë pyjet më të pasura me dru për industrinë e drurit i kemi ndaluar. Ka vetëm pastrime edhe ato pastrime me vendim të Qeverisë i kanë ekonomitë pyjore, ish -ekonomitë pyjore të komunës së Deçanit, të Pejës dhe të Istogut. Aty gjithçka që prehet dru teknik që prehet e rregullt aty është ilegale. Ato raste domethënë duhet të denoncohen, aty ka vetëm pastrime. Për herë të parë është bërë licencimi sivjet i kompanive për të pasur qasje në pyje dhe i sharrave. Ka filluar për herë të parë me udhëzim administrativ të cilin e kam nënshkruar unë. Asnjëherë nuk ka pasur licencim në të kaluarën dhe ne vërtet është një diskutim shumë i frytshëm për mendimin tim, por është shumë i vonuar, sepse 8 vjet unë s'kam qenë as ministër as deputet, por s'kam dëgjuar kurrë një debat të tillë që është diskutuar sot në këtë Parlament. Unë ju garantoj me të gjitha kompetencat që i kemi, bashkë me institucionet tjera të shtetit, me policinë e cila është duke na ndihmuar, por vazhdimisht tentojmë të kontaktojmë edhe me gjykatat që të ndihmojnë edhe ato, sepse në qoftë se nuk jemi si sistem i organeve ne nuk mund këtë dukuri ta luftojmë deri në çrrënjosje.

Ishte propozimi i deputetit Maloku të lirohen nga dogana dhe TVSH të gjitha produktet e lëndës së parë për industrinë e drurit. Vërtet është një propozim shumë i qëlluar, sepse në rast se kjo ndodh do të ruhej pylli që kemi ne....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti ministër, përmbylle edhe një minutë e ke.

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: Me vendimin për ndalimin e prerjeve të rregullta në regjionin e Pejës unë e kam pasur një vërejtje prej përfaqësuesit të USAID-it, te i cili janë ankuar kompanitë që merren me përpunimin e drurit dhe vërtet pozita jonë është dhe nuk dimë se çfarë të bëjmë, domethënë në këtë rast ne kemi ndaluar për një regjion edhe përkundër rekomandimeve se nuk duhet me ndodh kjo, sepse duhet ato kompani dhe ato industri të

drurit duhet të punojnë se janë tonat. Sa i përket pyllëzimeve për këtë vit ne kemi të planifikuar 500 hektarë të pyllëzohen me pyje, por ato të mirëmbahen pastaj është shumë vështirë, sepse nuk kemi kushte...

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Fjalën e ka deputeti Zeneli, kryetar i Komisionit për pylltari.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, kryesues!

Lirisht mund të them se kjo tema e dytë të propozuar apo rekomandimet e dyta, të propozuara për sot nga ana e Komisionit gjetën një qasje më të pranueshme, duke pasur parasysh se edhe kjo problematikë nuk ka inkompatibilitet të strukturave të ndryshme, qoftë institucionale në përmasa sa ka pasur ajo e para, do të thotë rekomandimet e temës së parë, prandaj edhe kemi një qasje më të pranueshme. Lirisht mund të them se me këtë logjikë të veprimit institucional, por edhe parlamentar, nëse vazhdojmë me këtë logjikë të veprimit dhe me këtë mentalitet të veprimit, atëherë Kosova nuk do ta ndryshojë imazhin e vet në raport me mbrojtjen e mjedisit edhe për dekada të tëra. Pse po e themi këtë? Për arsye se veç një shembull konkret në vitin 1960 ka qenë mentaliteti veprues shumë më dinamik dhe ka qenë shumë më domethënës dhe më i përkushtuar se sa sot që është. Në vitin 1960, malet e Rubullit, afër Maleve të Sharrit, afër Prevallës janë shndërrua në zonë të mbrojtur edhe me konventë ndërkombëtare, sipas Unionit për Konservimin e Natyrës në vitin 1960, ndërsa, sot, në vitin 2008, ne nuk po gjejmë kurajë t'i mbrojmë zonat tona të mbrojtura me ligj dhe t'i luftojmë shkelësit e ligjit. Prandaj, duke u kthye prapë në temën çfarë sot po e diskutojmë për pyjet konstatojmë e lirisht mund të them në emër të Komisionit se të gjitha debatet kanë qenë në frymën që të mos vonohemi më shumë. Komisioni Parlamentar sa për informatë në korrik i ka kryer punët e veta dhe i ka proceduar në seancën plenare, me procedurë parlamentare këto rekomandime dhe prej korrikut sot- në tetor, po i diskutojmë. Pra, kjo është dinamika e veprimit të punës sonë parlamentare. Nën një.

Dhe, nën dy. Propozoj që pasi e kemi edhe një seancë tjetër të radhës, Komisioni Parlamentar të largohet për 15 minuta dhe duke pasur për bazë propozimin që është dhënë të paraqesë një propozim të ri për miratim, në mënyrë që të mos vonohemi edhe më shumë dhe të mos ndikojë që si rezultat i neglizhencës sonë apo mos punës tonë, të kemi edhe të vazhdojë një gjendje çfarë është në terren. Pra, zoti kryesues, propozoj që t'i jepet hapësirë-kohë Komisionit Parlamentar, që të largohet për 15 minuta në një takim të veçantë dhe në bazë të shqetësimeve dhe ato propozimeve që u ngritën sot këtu të propozojë rekomandimet plotësuese. Ju faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani unë desha ta kemi parasysh se ka pasur shumë propozime dhe shumica kanë qenë konstruktive dhe asnjë s'ka qenë destruktive mund ta quajmë, pasi e thashë gabimisht " shumica". Nuk ka pasur kush qëllim të keq dhe gjithçka që është diskutuar është diskutuar në interes të ruajtjes së pyjeve. Nuk e di a mund t'i inkomporoj Komisioni për 15 minuta rekomandimet që janë dhënë? Unë kisha menduar që rekomandimet e reja, duke përfshirë edhe propozimet t'i lëmë që t'i votojmë në seancën e ardhshme më të kompletuar. Në qoftë se jeni dakord, në qoftë se s'jeni dakord unë nuk kam asgjë kundër. Mendoj që është më e pranueshme që në seancën e ardhshme të futen gjatë javës së ardhshme rekomandimet dhe të miratohen. Gjithashtu do t'i kisha lutur deputetët që ato që s'janë thënë dhe ato që mendojnë se duhet t'i fusin në kuadër të rekomandimeve, veçanërisht për ta bërë më ekspeditiv një institucion, i cili i ruan pyjet, ky është problemi kryesor dhe një mekanizëm i cili e subvencionon realisht edhe policinë, edhe Forcën e Sigurisë së Kosovës në qoftë se duhet të inkomporohet në ruajtjen e pyjeve në vend të atij 10% të famshëm që e marrin kështu te rampa ta marrin Forcat e Sigurisë, do të thotë policia

për çdo ndërhyrje dhe për çdo rast që mund të bëjnë kapjen e druve dhe lëndëve drusore. Prandaj, po vazhdojmë, a jeni dakord që ta lëmë për seancën e ardhshme, a po doni tash? Zoti kryetar i Komisionit kisha pasur dëshirë ta dëgjojmë fjalën tënde së pari pastaj, sepse po e shoh se është disponimi i tillë për ta lënë për seancën e ardhshme, sepse edhe ju do të jeni më të kompletuar me propozime.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, kryesues!

Meqenëse ka konsensus dhe nuk dëshirojmë tash të prishet kjo atmosferë e punës, prandaj propozoj që edhe unë në emër të Komisionit që të shtyhet kjo për seancën e ardhshme.

KRYESUESI: Do të thotë, në javën e ardhshme të votojmë për këtë. A jeni dakord?

Do të thotë, janë shumica që në seancën e ardhshme të miratohen rekomandimet e sotme së bashku me ato të Komisionit.

Po vazhdojmë punën me:

- **Shqyrtimin e Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të Trupave të Mbrojtjes së Kosovës.**

Duhet t'ju sqaroj që sipas marrëveshjes me Kryetarin dhe sipas të drejtës dhe Rregullores, ne do të ishte mirë që ta procedojmë dhe miratojmë këtë sot për të mos e lënë për një seancë tjetër të veçantë për të ardhur, ta zëmë të hënën dhe ta llogarisim si seancë të veçantë pas pushimit të drekës dhe të vijmë ta miratojmë ligjin në lexim të dytë, ndërsa Komisioni ad-hoc ta shqyrtojë.

Pra, në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin e ndërlidhur me të sipas procedurës së veçantë, datë 15 shkurt 2008, janë plotësuar kushtet për lexim të parë të Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të Trupave të Mbrojtjes së Kosovës.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zotin Mujota që, në emër të Qeverisë, para deputetëve, ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: I nderuari zoti kryesues,

I nderuari ministër,

Të nderuar deputetë,

Me siguri është njëri prej ligjeve që ka zgjuar kërshërinë më të madhe të njerëzve që presin trajtimin e dinjitetshëm nga ky ligj, por edhe të gjitha institucionet e vendit dhe ndërkombëtare për të pasur një ligj sa më solid dhe më cilësor që nënkupton shpërbërjen e dinjitetshme të Trupës Mbrojtëse të Kosovës. Prandaj, sot kam mundësinë që në emër të Ministrisë së Forcës së Sigurisë të paraqes disa aspekte lidhur me Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Me këtë projektligj, përkatësisht ligj pas miratimit, kemi mundësinë që ta jetësojmë dhe ta lehtësojmë procesin e shpërbërjes së dinjitetshme të Trupës Mbrojtëse të Kosovës dhe njëkohësisht ta lehtësojmë procesin e krijimit të Forcës së Sigurisë.

Ky projektligj është njëri prej ligjeve që parasheh Pakoja e Presidentit Ahtisari dhe është në harmoni të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për shpërbërjen e Trupës Mbrojtëse të Kosovës.

Projektligji në fjalë e rregullon të drejtën për pension të gjithë pjesëtarëve aktivë të Trupës Mbrojtëse të Kosovës, të cilët nuk do të përfshihen në Forcën e Sigurisë së Kosovës, si dhe të drejtën e trashëgimtarëve të pensionit, bashkë me përfitime të tjera sipas ligjit.

Zoti kryesues, më lejoni që me pak fjali t'i shkoqis disa elemente të cilat mendoj se meritojnë vëmendjen tonë të përbashkët.

Baza ligjore e Projektligjit është në Kushtetutën e Republikës së Kosovës në nenin n 65 paragrafi 1; në ligjin për shpërbërjen e Trupës Mbrojtëse të Kosovës, në nenet 1, 6 dhe 8 dhe në bazë të Planit Gjithëpërfshirës të pakos së Ahtisarit.

Ligji përmban gjithsej 4 kapituj, me 30 nene, si dhe dispozitat përfundimtare dhe kalimtare.

Siç e përcakton vetë titulli, ky projektligj e rregullon të drejtën për pension të pjesëtarëve aktivë të Trupës Mbrojtëse të Kosovës dhe trashëgimtarëve të tyre në nenin 1.

Përfitues të pensionit janë të gjithë pjesëtarët aktivë të Trupës Mbrojtëse të Kosovës, që nuk përfshihen në Forcën e Sigurisë së Kosovës e të cilët kanë shërbyer në këtë Trupë për pesë vjet, para hyrjes në fuqi të Ligjit, neni 7 pika d).

Pensionet, nga ky projektligj, i përfitojnë tri kategori.

Pensionin e parakohshëm mund ta gëzojnë pjesëtarët e Trupës Mbrojtëse të Kosovës kur të kenë arritur moshën prej 45 vjeç – neni 8.

Pensionin e përgjithshëm mund ta gëzojnë pjesëtarët e Trupës Mbrojtëse të Kosovës kur të kenë arritur moshën 50 vjeç – neni 8.

Pensionin e trashëgimtarëve, përkatësisht pensionin e bashkëshortit dhe pensionin i fëmijëve trashëgimtarë, në rast të vdekjes së përfituesit të pensionit, e rregullon neni 14.

Shuma e pensioneve është sipas këtyre kategorive:

- Pensionin e parakohshëm, përfituesit do ta marrin në lartësinë 50% të pagës mesatare që kanë marrë në 3 vjetët e fundit në shërbim në Trupën Mbrojtëse të Kosovës, rregullohet me nenin 10.
- Pensionin e përgjithshëm, përfituesit do ta marrin në lartësinë 70% të pagës mesatare që kanë marrë në 3 vjetët e fundit në shërbim në Trupën Mbrojtëse të Kosovës, rregullohet me nenin 10.
- Pensionin e trashëgimtarëve, gjegjësisht të bashkëshortit ose bashkëshortes përfitues, do ta realizojnë në lartësinë 60% të pensionit që ka marrë pensionisti para vdekjes, rregullohet me nenin 16.
- Pensioni i fëmijëve trashëgimtarë, që e gëzojnë fëmijët pa prindër, në lartësi prej 20% të shumës që ka realizuar pensionisti para vdekjes, rregullohet me nenin 20.

Këtë të drejtë e kanë fëmijët e pensionistit të TMK-së, të cilët janë nën moshën 18 vjeçare, ndërsa ata fëmijë që vijojnë shkollimin, e drejta e marrjes së këtij pensioni u vazhdon deri në përfundim të shkollimit, që është pragu 26 vjeç – neni 19, pika 2.

- Fëmijët me aftësi të kufizuara, e që janë përfitues të këtij pensioni, e gëzojnë të drejtën për pension pa kufizim moshe – rregullohet me nenin 19, pika 3.

Përfitimet tjera qenësore, nga Ligji, do të jenë:

- Përfitim shtesë, sipas këtij projektligji, është e drejta e shfrytëzimit të pensionit edhe në rast se përfituesit e këtij pensioni krijojnë marrëdhënie pune, qoftë në sektorin privat apo publik, neni 21.

Mendoj se është një nen thelbësor që rregullon këtë çështje.

Ligji është i harmonizuar edhe me ligje tjera, siç është Ligji për familjen – 2004/39 të gjendjes civile të bashkëshortëve dhe fëmijëve dhe trajtimi i bashkëshortëve do të bëhet sipas harmonizimit të Ligjit për familjen dhe, natyrisht, edhe me Ligjin për pensionimin e pjesëtarëve të Trupës Mbrojtëse të Kosovës.

Një element tjetër që duhet ta kemi parasysh, të nderuar deputetë, është ajo se, pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të këtij projektligji, Ministria e Punës është ajo që administron me pensionet, përmes Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës, që e rregullon neni 25.

Dhe, natyrisht, para se të përmbyll ekspozenë për Ligjin, dua të falënderoj të gjithë ata që kontribuuan që Ligji të ndryshojë në cilësi në dy muajt e fundit, që mendojmë se ka disa prej gjërave që e rregullojnë në mënyrë solide çështjen e kësaj kategorie. Këtu bën pjesë Grupi gjithëpërfshirës punues për Ligjin; Grupi politik strategjik; këshilltarët vendor e ndërkombëtar pranë Ministrisë së Forcës së Sigurisë dhe, natyrisht, mirëpresim edhe komentet e grupeve parlamentare dhe komentet, përkatësisht amendamentet e mundshme nga Komisioni ad-hoc që më pas të mund ta aprovojmë Ligjin si tërësi. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Sipas radhës, ftoj përfaqësuesin e Komisionit ad-hoc, zotin Ramadan Gashi, anëtar i Komisionit, që të paraqes raportin preliminar.

RAMADAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni ad-hoc, në pajtim me vendimin e Kuvendit të Kosovës, datë 15 shkurt 2008, për shqyrtimin e Projektligjit sipas procedurës së veçantë nga Propozimi gjithëpërfshirës i Marti Ahtisarit për zgjidhjen e statusit të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2008, shqyrtoi Projektligjin për pensionet e pensioneve të pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, të propozuar nga Qeveria dhe Kuvendit i paraqet këtë raport preliminar:

1. Projektligji për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës bën pjesë në listën e ligjeve nga Pakoja e Ahtisarit, sipas strategjisë legislative të Qeverisë së Kosovës.

2. Projektligji për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës është hartuar mbi bazën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjin për shpërbërjen e TMK-ës, prandaj i njëjti plotëson kushtet formale-juridike për procedim.
3. Teksti i Projektligjit ka përputhshmëri në mes të versioneve në të tri gjuhët zyrtare.
4. Deklarata buxhetore për vlerësimin e plotë të ndikimit financiar të këtij projektligji në buxhetin e Kosovës do të jepet në afatin 60 ditor nga miratimi i Projektligjit, siç është paraparë me vendimin e Kuvendit të Kosovës, datë 15 shkurt 2008, dhe
5. I rekomandohet Kuvendit që ta miratojë në parim Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Gashi. Sipas radhës, mundësinë për deklaram e kanë kryetarët e grupeve parlamentare. Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zotin Ramë Buja të marrë fjalën.

RAMË BUJA: Zoti kryesues,

Të nderuar ministra që jeni prezentë,

Kolegë deputetë,

Besoj se ndaj me ju mendimin që kemi pasur brengë se ne do ta bëjmë një projektligj që nesër do të bëhet ligj që të mos jetë fyes për Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Edhe kur kemi biseduar ndonjëherë me ministrin, kjo ka qenë brenga kryesore dhe unë konsideroj se, me leximin dhe shqyrtimin që ia kemi bërë këtij ligji, si Grup Parlamentar dhe personalisht unë, konsideroj se është një ligj i mirë dhe që nuk krijon ndjenjën e fyerjes për këtë kategori të njerëzve që gjithmonë na ka sjell ndjenjën e krenarisë, andaj unë uroj që ky projektligj, brenda seancës që do ta bëjmë të dytë sot besoj, të bëhet ligj dhe të implementohet sa më parë që është e mundshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-ës, duke pasur parasysh procedurat e miratimit të këtij ligji, duke u mbështetur në faktin se anëtarë të këtij Grupi Parlamentar kanë marrë pjesë në punët e Komisionit ad-hoc, e mbështet në tërësi Projektligjin dhe rekomandimet e Komisionit ad-hoc dhe si të tillë do ta votojmë. Po ashtu, mbështesim propozimin që sa më shpejtë të bëhet edhe leximi i dytë pas një pauze, në një seancë të re. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, zoti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështet këtë projektligj me qëllimet më të mira që pas një pauze, sikur që u tha këtu edhe nga shefat e grupeve tjera parlamentare, të kalojë edhe në leximin e dytë, për shkak se Komisioni ad-hoc e ka shqyrtuar dje këtë projektligj dhe ka ofruar të gjitha rekomandimet që kanë të bëjnë me të. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Njësoj, pa dëshiruar që t'i përsëris kolegët e mi, edhe Grupi ynë Parlamentar e mbështet kalimin e këtij ligji në lexim të parë dhe mbajtjen e seancës për lexim të dytë sa më shpejt që të jetë e mundur. Dje kemi pasur takim të Grupit të Komisionit ad-hoc dhe janë marrë shumë përgjigje në lidhje me shumë pyetje të cilat i kemi pasur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, zoti!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar Projektligjin për pensionimin e parakohshëm të Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Ne kemi një vërejtje të vogël sepse mendojmë që këtë ligj nuk është dashur ta sponsorizojë Ministria e Mbrojtjes, sepse Trupat Mbrojtëse të Kosovës kanë qenë organizatë civile dhe këtë ligj është dashur ta sponsorizojë, në procedurë është fjala, Ministria e Mirëqenies Sociale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS nuk është paraqitur askush. Në emër të Grupit Parlamentar "7+", zoti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala! I pored toga što smo tražili odlaganja ove tačke dnevnog reda, mi se pridružujemo ostalim grupama i podržavamo ovaj način da se danas znači završi i sa prvim i sa drugim čitanjem. Razlog što smo tražili odlaganje je bio taj što naš član nije tu i nije učestvovao u grupi ad-hoc u izradi, ne izradi nego usvajanju. Ipak čemo podržati! Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj se nuk ka propozime tjera.

Në sallë janë 67 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

"Për", kanë votuar 58 deputetë, 1 është "kundër" dhe asnjë abstenim. A ka ndokush që është pa kartelë? Atëherë, me Ibrahim Gashin, që voton "për", bëjnë 59 vota.

Atëherë, konstatoj se me 59 vota "për" miratohet në parim – në lexim të parë Shqyrtimi i Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Ju njoftoj shkurt, do ta marrim një pauzë dhe konstatoj se seanca e sotme, mori fund. Punën e vazhdojmë në orën 16, në seancë të re, për ta miratuar në leximin e dytë Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Faleminderit!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve

